

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XX, viti 2004

Faqe

Reforma ligjore dhe procesi i Integritimit:

Ligji i ri “Mbi kthimin dhe Kompensimin e pronave ish-pronareve” - një hap përpara drejt standardeve europiane	Juliana LATIFI	4
Konkurrenca shqiptare dhe sfida europiane	Shpati HOXHA	16
Mbrojtja e konkurrencës së lirë - një nga kushtet kryesore për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit	Besnik MAHO	36

E Drejta Kushtetuese:

Përligjja politike dhe filozofike e “Diskriminimit pozitiv” dhe e kuotave në përfaqësimin e grave në politikë dhe vendimmarrje	Henri ÇILI	49
--	------------	----

E Drejta Parlamentare:

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe nevoja për përmirësime të rëndësishme	Dr. Ylli BUFI	54
Kundër neorealizmit juridik. Për një debat mbi interpretimin e ligjit	Otto PFERSMANN	73

Nga punimet e Kuvendit:

Nga punimet e Kuvendit për periudhën maj 2004	Alma KONDAKÇIU	99
Informacion mbi legjislationin e miratuar	Filip LAKO	106

Përmbledhje në anglisht:

Information on laws passed by Assembly		121
--	--	-----

TABLE OF CONTENTS:

20th issue, year 2004

	Page
<hr/>	
Legal reform and the process of Integration:	
New law “On Restitution and Compensation of properties to former owners”-a step ahead to European standards	
Juliana LATIFI	4
Competition in Albania and the European challenge	
Shpati HOXHA	16
Protection of free competition - one of the main conditions for the implementation of the Stabilization and Association Agreement	
Besnik MAHO	36
<hr/>	
Constitutional Law:	
Political and philosophical justification of “positive discrimination” and of quotas on women participation in politics and decision-making process	
Henri ÇILI	49
<hr/>	
Parliamentary Law:	
Rules of Procedure of the Assembly of the Republic of Albania and the need for important improvement	
Ylli BUFI	54
For a debate on law interpretation	
Otto PFERSMANN	73
<hr/>	
From the proceedings of the Assembly:	
From the proceedings of the Assembly for the period May 2004	
Alma KONDAKÇIU	99
Information on the approved legislation	
Filip LAKO	106
<hr/>	
Summary in English:	
Information on laws passed by Assembly	121
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Ligji i ri “Mbi kthimin dhe kompensimin e pronave ish - pronarëve” - një hap përpara drejt standardeve europiane

Dr. Juliana Latifi

Pavarësisht se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga dalja e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, problemet në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës vazhdojnë të krijojnë një situatë të mprehtë konflikti në jetën social-ekonomike, politike e juridike shqiptare.

Aderimi i shtetit shqiptar në një sërë konventash ndërkombëtare, hapja e negociatave të marrëveshjes së stabilizim-asociimit, si dhe kontradiktat e shumta të problemeve të pronësisë, diktuan domosdoshmërinë e hartimit të një ligji të ri në lidhje me pronën e marrë ish-pronarëve nga regjimi komunist.

Ndryshimet historike që ndodhen në realitetin shqiptar pas viteve ‘90 sollën miratimin e një sërë ligjesh të rëndësishme dhe midis tyre edhe të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Pas 50 vjetësh shteti u njëjto të drejtën e pronësisë ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre për “pronat e shtetëzuara, të shpronësuara ose të konfiskuara, sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas 29.11.1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër...¹”.

¹ Neni 1 i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”

Dalja e këtij ligji, jo vetëm do të shënonte një çast të rëndësishëm në realitetin shqiptar, por ai do të shoqërohej edhe me lindjen e problemeve të karakterit politik, juridik, ekonomik e social.

Shteti do t'i njihje “të drejtën e pronësisë” ish-pronarëve dhe do të “kthente ose kompensonte” pronën e marrë padrejtësisht nga shteti komunist i asaj kohe.

Në koncept të këtij përcaktimi, të dhënë nga vetë ligji, ekzistonte një kategori personash, të cilët, të prekur nga regjimi i asaj kohe, do të ishin subjekte të tij, të njohur me emërtimin ish-pronarë.

Nga ana tjetër, menjëherë pas viteve '90, ndryshimi i regjimit dhe futja e Shqipërisë drejt ekonomisë së tregut, diktuan nevojën edhe të miratimit të një sërë ligjesh të tjera, të cilat do t'i hapnin rrugë privatizimit masiv të pronës shtetërore.

Një çast me rëndësi në këtë drejtim ishte dalja e ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Në këtë ligj do të gjente sanksionim rregullli se “të gjithë sektorët e ekonomisë janë të lirë të privatizohen dhe të ushtrojnë veprimtari private...²”. Në këtë kuadër, e drejta e privatizimit do t'i takonte çdo personi fizik ose juridik, duke krijuar një kategori subjektesh të emërtuara, në bazë të këtij ligji “pronarë të rinj” të ish-pronës shtetërore.

Tashmë në realitet, prona shtetërore do t'u përkiste dy kategorive: “pronarëve të rinj” dhe “ish-pronarëve”. Këto dy kategori subjektesh do të viheshin përballë njëra-tjetrës, duke krijuar një klimë të mprehtë konflikti.

Nga ana tjetër, lëvizjet e mëdha demografike që ndodhën pas viteve '90, ku popullsia e zonave rurale u zhvendos drejt zonave urbane, sidomos në periferinë e qyteteve të mëdha si Tirana, Durrësi, Vlora etj., do të sillte nga

² Neni 3 i ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”

pikëpamja juridike edhe një “pushtim” të trojeve ose tokave të pazëna, që deri dje kishin qenë pronë shtetërore, dhe të cilat më pas, në zbatim të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, u ishin kthyer ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre nga komisionet e kthimit të pronave.

Në këtë drejtim, konflikti midis ish-pronarëve dhe këtyre personave do të ishte shumë më i mprehtë, duke u mbarsur edhe me të ashtuquajturin “krim të pronës”.

Por, a do t’i jepte zgjidhje problemeve të mësipërme ligji nr. 7698?

Ligji në vetvete përmbante dispozita tepër kontradiktore, që jo vetëm nuk do të mund t’u jepnin një zgjidhje problemeve të mësipërme, por ai do të thellonte konfliktin.

Të diskutueshme ishin problemet në lidhje me pronësinë mbi truallin dhe mbi ndërtesat.

Në këtë aspekt ligji impononte në mënyrë taksative një bashkëpronësi të detyrueshme, midis pronarëve të rinj dhe atyre të vjetër. Bashkëpronësia e detyrueshme u bë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, duke u shfuqizuar si antikushtetuese, përkatësisht nenet 10, 11, 12, 17 të ligjit.

Jo vetëm dispozitat e shfuqizuara si antikushtetuese, por edhe dispozita të tjera të ligjit nr. 9678, krijuan një sërë problemesh.

Si të tillë, mund të përmendim nenin 13 të ligjit, ku flitet për shpenzime në lidhje me ndryshimin e strukturës së banesës. Ky nen u bë burim i mirëfilltë konflikti juridik, ku shumë çështje, aktualisht edhe sot janë gjykuar dhe vazhdojnë të gjykohen³.

³ Neni 13: “Kur në objektin ish-pronë private janë kryer nga shteti ose pronari shpenzime për ndryshime në strukturë, shtesa anësore ose shtesa kati etj, objekti i kthehet ish-pronarit pa kundërshtim, kur vlera e shpenzimeve përbën deri 20 për qind të vlerës së objektit.

Kur në objektin ish-pronë private vlera e shpenzimeve të kryera përbën 20 për qind deri në 50 për qind të vlerës së objektit, ai mund të kalojë në pronësi të ish-pronarit, pasi të jetë shlyer nga ana e tij kundërvlera e mësipërme, mbi 20 për qind, e llogaritur në bazë të gmimeve

Nga ana tjetër, bashkëpronësia e detyrueshme parashikohet jo vetëm midis pronarëve të vjetër dhe atyre të rinj, por ajo shtrihej edhe në bashkëpronësi, midis vetë pronarit dhe shtetit.

Në nenin 20, rregullohet bashkëpronësia midis shtetit dhe pronarëve të vjetër, në lidhje me truallin, ku ishin ndërtuar banesa shtetërore 1 dhe 2 katëshe. Ish-pronari i truallit, mbi të cilin ishin ndërtuar banesa shtetërore 1 dhe 2 katëshe, kishte të drejtën e bashkëpronësisë me shtetin mbi këtë truall, në rastin e banesës 1 katëshe në raportin 1:2, dhe në rastin e banesës 2 katëshe në raportin 1:3. Në të dyja rastet pronari kishte të drejtë të ndërtonte një shtesë kati mbi banesën.

Çështja bëhet edhe më e diskutueshme po të shikoheshin efektet e ligjit në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi truallin. Sipas rregullit të dhënë në nenin 4: “U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre të gjitha pronat që në çastin e daljes së këtij ligji ekzistojnë në formën e trojeve të pazëna ose ndërtesave të pandryshuara..., masa e kthimit ose kompensimit për trojet do të jetë e plotë deri në 10 000 m². Kur prona është nga 10 000 m² deri në 100 000 m², masa e kthimit ose kompensimit do të jetë plus 10 për qind, ndërsa për pronat mbi 100 000 m² plus 1 për qind.”

Në kontekst të këtij neni, sanksionohet kthimi i pronës, por ai ishte i determinuar sipas përcaktimeve të mësipërme.

Nga ana tjetër, kur trojet ishin të zëna me ndërtime të përhershme, (çka nënkupton një send të lidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokën), ligji parashikonte të drejtën e kompensimit me obligacione shtetërore, me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara, por jo më shumë se 5000 m², me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, por jo

të ndërtimit në kohën e rikthimit të pronës. Kur vlera e shpenzimeve të kryera është mbi 50 për qind të vlerës së objektit, objekti mbetet në bashkëpronësi... Mosmarrëveshjet midis palëve zgjidhen në rrugë gjyqësore.

më shumë se 5000 m². Edhe në këtë aspekt, ligji nuk përcaktonte se për çfarë ndërtimesh të përhershme bëhej fjalë, për ato të ngritura nga shteti apo nga persona të tretë, të cilët në mënyrë të kundërligjshme, kishin pushtuar pronën e tjetërkujt pas viteve '90.

Konfliktet që lindin nga vetë dispozitat e ligjit ekzistues vazhdojnë njëra pas tjetrës. Në nenin 21 sanksionohet rregulli: "Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj., ish-pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve...". Në pamjen e parë, ky përkufizim është më se i qartë, ish-pronari gjithmonë ka të drejtë mbi pronën e tij. Por po t'i referohemi në kohë daljes së ligjit, ai i përket vitit 1993 dhe, nga ana tjetër, kemi ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë...", ligj i cili ishte i pari që i hapi rrugë privatizimit të gjithçkaje shtetërore, duke i dhënë mundësi çdo subjekti fizik ose juridik që të privatizonte pronën shtetërore. Në këtë kuadër pronarëve të vjetër, u është hequr nga pikëpamja kohore mundësia e të drejtës së parablerjes edhe objekteve të cituara më sipër (dyqane, magazina, punishte etj., të ndërtuara mbi trojet e ish-pronarëve). Kështu, u krijua përsëri një pikë e fortë përplasjeje interesash.

Të gjitha këto probleme, si dhe të tjera që lindën gjatë zbatimit në praktikë të ligjit nr.9678, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", e bënë atë praktikisht të pazbatueshëm, duke diktuar nevojën për hartimin e një ligji të ri, i cili duhet të mbështetet në Kushtetutën e re të miratuar në nëntor të 1998, si dhe në legjislaacionin ndërkombëtar.

Kushtetuta aktuale, si dhe aderimi i Shqipërisë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut shtojnë përpara shtetit shqiptar detyrimin ligjor që çështja e kthimit dhe e kompensimit të pronave të respektojë standardet ndërkombëtare.

Organizmat ndërkombëtarë, si prania e OSBE-së në Shqipëri, Komisioni i Venecias etj., kanë dhënë një sërë rekomandimesh që ligji, i cili u hartua, të ishte në përputhje me aktet ndërkombëtare, si një hap i rëndësishëm për

përqasjen e legjislacionit shqiptar me atë europian, ku duhet të mbaheshin parasysh këto kritere:

- Vlera e kompensimit
- Metoda e kompensimit
- Kufiri i vlerësimit
- Kthimi i drejtë i pronës, por jo i plotë
- Baraspeshim i drejtë i interesave të ish-pronarëve dhe interesit të përgjithshëm

- Një gjykatë e pavarur

Rekomandimet e ndërkombëtarëve i referohen nenit 41 të Kushtetutës, ku sanksionohet parimi: “E drejta e pronës private është e garantuar... Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë”. Në kontekst të këtij neni, prona private jo vetëm është e garantuar, por shteti është i detyruar, që në lidhje me problemet e pronësisë, të bëjë një rregullim të drejtë të tyre, kundrejt një shpërblimi të drejtë.

Është ky parim kushtetues, i cili i garanton të drejtën e pronësisë çdo individ, duke mos përjashtuar edhe ish-pronarët.

Por ai nuk e vesh shtetin me detyrimin e kthimit të pronës tek ish-pronari, në lidhje me pronat e tyre të marra padrejtësisht nga regjimi komunist. Por është në vullnetin e shtetit që të bëjë një rregullim të drejtë të problemeve të pronësisë, çka nënkupton kthimin ose kompensimin e pronës⁴.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në vitet '90, u ndesh me një gamë të gjerë të problemeve të pronësisë, çka determinoi edhe njësimin e praktikës së saj, duke përcaktuar bazën teorike për privatizimin e pronës shtetërore.

⁴ Në nenin 1 pika a të ligjit të propozuar, sanksionohet: “Ky ligj ka për objekt: rregullimin e drejtë, sipas kritereve të nenit 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet”.

Sipas kësaj praktike, shtetet ish-komuniste, të cilat u përballën me problemet e pronësisë, teorikisht nuk kanë një detyrim kushtetues, për t'i kthyer në natyrë ish-pronarit pronën e shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar. Por ky fakt nuk mund të përjashtojë parimin e kompensimit, me kushtin që kompensimi duhet të jetë i drejtë, pavarësisht se mund të mos jetë i plotë⁵.

Siç e citova, edhe më sipër, ligji i ri, duhet të bazohet në disa parametra:

· **Vlera e kompensimit.**

Në rekomandimet ndërkombëtare, vlera e kompensimit është e lidhur ngushtë me situatën financiare të shtetit, i cili në zbatimin e kësaj vlere duhet të udhëhiqet gjithmonë nga parimi i ndershmërisë dhe i drejtësisë, duke siguruar një trajtim të barabartë për ish-pronarët.

Në ligjin e ri, neni 6, pika 1 sanksionohet: “Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompesohet deri në 60 ha, kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.”

· **Metoda e kompensimit**

Sipas standardeve ndërkombëtare, përcaktimi i saktë i vlerës së kompensimit, kërkon dhe zbatimin e një metode për kompensim.

Në zbatim të nenit 41 të Kushtetutës, në ligjin e ri të propozuar është mbajtur parasysh kriteri, që metoda e kompensimit do të sigurojë kthimin e pronës dhe, kur kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj (Neni 1/b).

Kompensimi do të nënkuptojë një shpërblim të drejtë, sipas vlerës së tregut të pronës në çastin e njohjes së shpërblimit, të kryer në të holla ose sende të tjera të njohura për subjektin e shpronësuar si kthim i pronës së shpronësuar, shtetëzuar, konfiskuar ose marrë padrejtësisht prej shtetit në çdo mënyrë tjetër.

⁵ Opinioni i Komisionit të Venecias.

• **Kufiri i vlerësimit**

Aderimi i Shqipërisë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, dikton një zbatim të vullnetshëm të dispozitave të saj.⁶

Çdo shtet, duke mbajtur parasysh standardet e tij, sidomos ato në fushën sociale dhe ekonomike, zbaton një kufi vlerësimi, kundrejt dispozitave të Konventës Europiane.

Në këtë kuadër, shteti (Qeveria) shqiptar gëzon liri veprimi, se si duhet të veprojnë për të realizuar kthimin ose kompensimin e pronës ish-pronarëve.

Në ligjin e ri shteti jo vetëm i njeh të drejtën e pronësisë *ipso jure* ish-pronarëve, por ai merr përsipër kthimin ose kompensimin e saj (Neni 2).

• **Kthim i drejtë i pronës, por jo i plotë**

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut sanksionon parimin:

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimin e tij. Askush nuk mund të privohet nga zotërimet e veta, përveç në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj, sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (neni 1, Protokollin 1).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parimin: “E drejta e pronës private është e garantuar” (neni 41/1).

Duke iu referuar këtyre dy dokumenteve, asnjëri nuk parashikon një kthim të së drejtës së pronësisë, por ato garantojnë një mbrojtje dhe një respektim të së drejtës së pronësisë.

Nga ana tjetër, praktika e Gjykatës Europiane⁷ ka mbajtur parasysh parimin, që e drejta e pronësisë nga ish-pronarët nuk është ushtruar *de facto* për një kohë relativisht të gjatë dhe në këtë kuadër shteti *de jure* njeh të

⁶ Kushtetuta e RSH, neni 122

⁷ Pakinian v. Bulgaria, App No.29583/96 EcomHR dhe Potocka v.Poloni app No.33776/96 ECtHr

drejtën e pronësisë për këtë kategori subjektësh, por ai realisht nuk mund të realizojë një kthim universal të pronës së marrë.

Në Konventën Europiane mbrohet dhe garantohet vetëm e drejta ekzistuese e pronësisë, çka do të thotë që kjo e drejtë duhet të ekzistojë realisht ose, e thënë ndryshe, ajo duhet të ushtrohet. Në këtë kontekst, shteti, në çastin që ish-pronarin e një si pronar, duhet t'i garantojë atij edhe mbrojtjen e pronës së tij.

Nga ana tjetër, kthimi ose kompensimi i pronës do të jetë gjithnjë i kushtëzuar nga gjendja faktike e pronës ekzistuese, gjendje e cila determinon edhe situatën tjetër, që kthimi mund të mos jetë i plotë, por ai duhet të jetë i drejtë.

Në ligjin e ri, në nenin 8 (Truall), jepet ky rregullim:

1. Në rastin kur trualli u është tjetërsuar personave të tretë dhe mbi të nuk janë ngritur ndërtesa të përhershme dhe të ligjshme, ai u kthehet subjekteve të shpronësuar...

2. Kur mbi truallin e subjektit të shpronësuar, shteti a persona të tretë kanë kryer ndërtime ose investime në përputhje me legjislacionin në fuqi, ato llogariten sipas vlerës së tregut në çastin kur i njihet e drejta e pronësisë...

3. Në rastin e ndërtimeve mbi truall, të bëra para datës 10.8.1991, për të cilat nuk është regjistruar pronësia e truallit, ai që ka në pronësi ndërtesën detyrohet të paguajë vlerën fillestare të truallit...

4. Në rastin e ndërtimeve të ligjshme të bëra në truallin e dhënë nga shteti me qira ose koncesione, pronari i ndërtesës paguan vlerën e truallit mbi të cilën është bërë ndërtesa, sipas çmimeve të tregut.

Në nenin 9 (Banesa) bëhet ky rregullim:

1. Banesa pronë e subjekteve të shpronësuar lirohet nga qiramarrësi brenda një afati 3-vjeçar...

2. Në rastin e banesave të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, banorët e tyre kanë të drejtën e blerjes së truallit... Vlerësimi i truallit bëhet sipas vlerës së tregut në çastin e kryerjes së legalizimit të banesave.

Duke iu referuar këtyre dy dispozitave, shteti u njeh të drejtën e pronësisë ish-pronarëve mbi objektet truall ose banesë, realizon të drejtën e kthimit në përputhje me mundësitë e tij dhe, kur kthimi është i pamundur, atëherë ai (shteti) zbaton të drejtën e kompensimit.

Nga ana tjetër, përfundimisht i jepet një zgjidhje edhe problemit të legalizimit të ndërtimeve të reja të bëra pas vitit 1991, duke krijuar tashmë një stabilitet si nga pikëpamja juridike, ashtu dhe sociale, në ekulibrin që vendoset midis ish-pronarëve dhe pronarëve të rinj në mbrojtje të interesave të tyre.

• **Baraspeshim i drejtë i interesave të ish-pronarëve dhe interesit të përgjithshëm**

Në rekomandimet ndërkombëtare për hartimin e një ligji sa më adekuat, një rëndësi paraqet dhe baraspeshimi i drejtë midis interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe interesave të individit.

Në rast se i referohemi përmbajtjes së nenit 1, të Protokollit 1, si dhe nenit 41 të Kushtetutës, përcaktimi është i saktë: Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij.

Shteti mund të parashikojë shpronësime ose kufizime të së drejtës së pronësisë vetëm për interesa publikë dhe vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

Në këtë kuadër, do të jetë detyrë e shtetit që në zgjidhjen e çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronës të sigurojë një baraspeshim të drejtë ndërmjet zgjidhjes së pretendimeve të pronarëve të mëparshëm dhe interesit të përgjithshëm të shoqërisë.

Në nenin 7 të ligjit të ri, ligjvënësi, duke mbajtur parasysh interesin e përgjithshëm, bën edhe një rregullim të atyre pronave, të cilat nuk mund të kthehen.

Sipas këtij neni, nuk kthehen pronat e paluajtshme që i shërbejnë një interesi publik dhe që:

a) shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti është palë;

b) kanë investime ose përdoren për realizimin e projekteve me shtrirje territoriale ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji ose në investime të tjera në interes publik;

c) shërbejnë për ruajtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës, arsimit publik ose edukimit parashkollor;

ç) janë pasuri e veçantë kulturore ose historike, përcaktuar sipas legjisllacionit në fuqi;

d) janë zënë sipas akteve ligjore.

• **Një Gjykatë e pavarur**

Një pushtet gjyqësor i pavarur është i domosdoshëm për drejtësinë dhe shtetin e së drejtës. E drejta për drejtësi dhe një proces të paanshëm është parimi themelor i njohur dhe i sanksionuar nga tërësia e dokumenteve dhe e instrumenteve ndërkombëtare.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Shtetasve sanksionojnë parimin: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e krijuar në bazë të ligjit”.

Në realizimin e drejtësisë, pavarësia e gjykatës është kërkesë e domosdoshme për ekzistencën e një shoqërie të lirë dhe garanci kryesore për një shtet të së drejtës.

Një shoqëri e lirë, që afirmon parimin e shtetit të së drejtës, nuk mund të qëndrojë e tillë pa garantuar pavarësinë reale të gjykatave.

Pavarësia e gjykatave është kërkesë themelore e ekuilibrit midis lirisë së pushtetit ekzekutiv për të vepruar me frytshmëri në mbrojtje të të drejtave individuale dhe garancive që duhen përcaktuar kundër shpërdorimit të pushtetit

ekzekutiv.

Në çdo shtet demokratik pavarësia e gjyqësorit është shprehje e drejtpërdrejtë e parimit të ligjshmërisë, e detyrës që veprimtaria e organeve të drejtësisë të zhvillohet në bazë të kërkesave të ligjeve, të respektimit dhe zbatimit të tyre.

Gjykatat janë të detyruara që në veprimtarinë e tyre të zbatojnë rregulla të njëjta dhe të barabarta për të gjithë shtetasit, çka i siguron atyre një objektivitet të plotë dhe të gjithanshëm, duke determinuar edhe një zgjidhje të drejtë të çdo çështjeje.

Parimi i pavarësisë së gjykatave dhe nënshtrimi vetëm ndaj kërkesave të ligjit qëndron në themel të të gjithë veprimtarisë së gjyqësorit.

Gjyqtari e merr vendimin në bazë të ligjit, sipas bindjes së tij të brendshme, duke qenë i lirë nga çdo ndikim.

Në përputhje me kërkesat e ligjit, ai është i detyruar që ta zgjidhë çështjen me paanësi, duke u mbështetur në fakte dhe prova konkrete, larg çdo ndikimi të jashtëm, larg presioneve, ndërhyrjeve të padrejta etj.

Në dhënien e drejtësisë, parimi i pavarësisë së gjykatës dhe nënshtrimi i saj vetëm ndaj kërkesave të ligjit, nuk ka kufizim.

Pa dyshim, miratimi i ligjit të ri “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” jo vetëm do të verë në vend një padrejtësi të bërë nga shteti komunist, por ai tashmë do t’u japë zgjidhje të gjitha problemeve të mprehta sociale, ekonomike dhe juridike, të cilat u bënë evidente në realitetin shqiptar në këtë periudhë 10-vjeçare, duke shënuar një hap përpara drejt përqasjes së legjislacionit shqiptar me atë europian, dhe do të jetë si një premisë e domosdoshme e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Konkurrenca shqiptare dhe sfida europiane

*Shpati Hoxha
Zyra Avokatore
Hoxha, Memi & Hoxha*

§ 1. Liberizmi¹ i viteve nëntëdhjetë

Kalimi, gjatë fillimit të viteve nëntëdhjetë, nga ekonomia e centralizuar në një ekonomi tregu, duhet të përfaqësonte një revolucion kulturor më shumë se ekonomik, pasi krahas ndryshimeve ligjore, paraqitej nevoja e një ndryshimi në kulturën tregtare shqiptare, dhe sidomos në fushën e parimeve të përgjegjësisë vetjake, të rrezikut të ndërmarrjes dhe konkurrencës.

Nëse në fusha të tjera prishja e vazhdimësisë me të drejtën të ashtuquajtur socialiste ka qenë graduale, në fushën tregtare u vu re një zhvillim i menjëhershëm dhe traumatik i rregullave të lidhura me sistemin tregtar. Abrogimi në bllok i ligjeve që parashikonin monopolin shtetëror mbi industrinë dhe ushtrimin e veprimtarisë tregtare, pasojë e pranimit të parimeve të demokracisë ekonomike, nxori jashtë loje strukturën ekonomike të krijuar gjatë pesëdhjetëvjeçarit socialist dhe krijoi një *vakuum* legjislativ e institucional në fushën e tregtisë dhe të industrisë.

¹ Në këtë artikull termi “Liberizëm” i referohet konceptit të “laissez-faire economy”, siç u elaborua nga Adam Smith dhe nga ekonomia neoklasike; për më gjërë shih “An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations” A. Smith, 1776; “Principles of Macroeconomics” J.E Stiglitz. W.W. Norton & Company; “Elementi di Economia Politica”, T. Cozzi, S. Zamagni, Il Mulino.

Objektivat parësorë të ligjvënësit shqiptar në periudhën menjëherë pas rrëzimit të sistemit të centralizuar ekonomik qenë:

a) Liberalizimi i ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe parashikimi i mjeteve ligjore të nevojshme².

b) Transferimi i pronësisë shtetërore mbi mjetet e prodhimit në pjesën më të madhe të fushave ekonomike (privatizim material) (Ligji nr. 7512).

c) Transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare me shtetin, në cilësinë e ortakut të vetëm (privatizim i formës) (Ligji nr. 7926).

Parimi i liberalizimit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, parashikuar me ligjin nr. 7476 e më pas me atë nr. 7512 të vitit 1991, dhe që mori shtrirje të gjithanshme, me përjashtim të sektorëve të ashtuquajtur strategjikë,³ të paktën gjatë periudhës fillestare nuk u shoqërua me parashikimin e rregullave të tjera themelore të lojës ekonomike. Kjo për arsye se kompromisi i arritur ndërmjet shoqërisë shqiptare dhe forcave të reja politike: “vota në këmbim të lirisë së plotë ekonomike”, nuk e bënte të lehtë futjen e rregullave limituese të lirisë tregtare, siç janë ato të konkurrencës, pasi çdo kufizim mund të interpretohej si mbetje e sistemit socialist dhe, si e tillë, e papranueshme.

Ky liberizëm, i cili ushqej në mënyrë të tërthortë edhe nga mungesa e plotë gjatë 50 viteve paraardhëse e rregullave mbi konkurrencën, u theksua më tej nga ligjet e para të viteve ‘90, të cilat garantonin ushtrimin e veprimtarisë private, pa parashikuar rregulla mbi marrëdhëniet e ortakërisë, duke i lënë këto në dorë të raporteve të forcës ekonomike të ortakëve.

² Ligji nr. 7476 “Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës e të veprimtarisë private” i marsit të vitit 1991, i shfuqizuar pesë muaj më vonë me ligjin nr. 7512 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë e veprimtarive private të pavarura e privatizimit” dhe më pas nëpërmjet të ashtuquajturve Tri Ligje për Shoqëritë Tregtare (nr. 7632; nr. 7638 të nëntorit 1992 dhe nr. 7667 i janarit 1993).

³ Energjetika, telekomunikacioni, transporti hekurudhor etj.

Qëllimi i këtij artikulli është analiza e zhvillimit të legjislacionit shqiptar mbi konkurrencën, në kuadrin e politikave të përafrimit të legjislacionit vendas me *Acquis Communautaire*, të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare. Citimi i dispozitave të legjislacionit të Bashkimit European nuk përbën një krahasim të mirëfilltë sistemesh juridike, por ka shërbyer si referencë për të pasur një informacion më të gjerë në lidhje me fushën e konkurrencës.

§ 2. Ligji nr. 8044, datë 7.12.1995 “Për konkurrencën”

Në vitin 1995 Shqipëria miratoi një ligj për mbrojtjen e konkurrencës⁴, i cili bazohej në një model të thjeshtuar rregullash të së drejtës *antitrust* të BE-së, me qëllim mbrojtjen e tregut ideal nga shtrembërimet që mund të vijnë nga sjelljet antikompetitive⁵. Veçantia e këtij ligji qëndronte në faktin se në ndryshim nga pjesa më e madhe e ligjeve homologe të shteteve të Europës Perëndimore, krahas rregullave të ashtuquajtura *antitrust*, ai parashikonte edhe një sërë dispozitash në mbrojtje të subjekteve të veçanta (*tregtarë*), nga veprime që konsiderohen në kundërshti me rregullat e korrektësisë profesionale të kësaj kategorie (*konkurrenca e pandershme*).

Kjo kategori veprimesh të paligjshme, edhe pse në shumicën e rasteve dëmton një ose disa grupe tregtarësh, nuk ka potencialin e duhur për të deformuar sjelljen e të gjithë operatorëve të tregut përkatës.⁶

§ 2.1. E drejta antitrust

Ligji nr.8044 i vitit 1995 ishte nisma e parë që shteti shqiptar ndërmerre

⁴ Ligji nr. 8044, i vitit 1995 “Për konkurrencën”

⁵ Marrëveshjet e ndaluara, abuzim i pozitës zotëruese dhe ndalimi i bashkimeve dhe ndarja e ndërmarrjeve në pozitë zotëruese.

⁶ P.sh., neni 48 i ligjit parashikon ndalimin e tërheqjes së punëmarrësve të konkurrentit të drejtpërdrejtë të një tregtari. Një veprim i tillë, edhe pse mund të jetë shumë i dëmshëm për konkurrentin, nuk ka potencialin e duhur për të deformuar sjelljen e tërësisë së operatorëve të atij tregu përkatës.

për të vendosur rregulla mbi konkurrencën. Siç u përmend më lart, ky ligj merr si model të drejtën *antitrust* të Bashkimit Europian, të përmbajtur në Traktatin e Romës të vitit 1958 dhe në dispozitat e mëvonshme të institucioneve europiane⁷.

Dispozitat e para *antitrust* të ligjit në fjalë rregullonin kontrollin e përqendrimeve, duke kufizuar lirinë e kryerjes së veprimeve për bashkimin e ndërmarrjeve nëse këto krijojnë ose forcojnë pozitën zotëruese në treg ose duke parashikuar detyrimin e ndarjes për ndërmarrje që zotëronin një pozitë të tillë në treg⁸.

Kategoria e dytë e veprimeve të ndaluara është ajo e marrëveshjeve të ndaluara, të cilat ligji i quan “ndalimet e kufizimeve të konkurrencës”.

Rastet e fundit që përfshihen në kategorinë e dispozitave *antitrust* të ligjit në fjalë, janë ato të abuzimit të pozitës zotëruese.

§ 2.2. Konkurrenca e pandershme

Pjesa e katërt e ligjit nr. 8044 trajtonte veprimet që bien në kundërshtim me konkurrencën e ndershme ndërmjet tregtarëve. Ligji shqiptar, në ndryshim nga legjislacionet perëndimore, nuk përdorte teknikën legjislative të një dispozite të përgjithshme⁹, por identifikonte rast pas rasti dhe në mënyrë specifike veprimet që janë në kundërshtim me korrektësinë profesionale të tregtarit.

Këto dispozita¹⁰ nuk janë gjë tjetër veçse rastet që doktrina perëndimore, duke u bazuar në dispozitat e Konventës së Unionit të Parisit¹¹ për “Mbrojtjen

⁷ Shih rregulloret e direktivat e BE-së.

⁸ Neni 5 e vijues i ligjit nr. 8044.

⁹ Kjo teknikë është përdorur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (neni 638).

¹⁰ Nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8044.

¹¹ Konventa Unioni i Parisit (CUP) “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” u nënshkrua në vitin 1983 dhe është amenduar për herë të fundit në vitin 1979. Shqipëria është pjesë e kësaj Konvente që prej vitit 1995.

e Pronësisë Industriale”¹² dhe të legjislacioneve perëndimore që i kanë përthithur ato, ka identifikuar si akte në kundërshtim me konkurrencën e ndershme.

Ndër veprimet që parashikohen si akte të konkurrencës së pandershme mund të përmendim: Përfitimin nga emri i mirë i konkurrentit, mashtrimin, çmimet e ulëta, bojkotimin, imitimin dhe marrjen e rezultateve, tërheqjen e nëpunësve, korrupsionin etj.

Mospërfshirja e këtyre veprimeve (*konkurrenca e pandershme*) në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, miratuar së fundmi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nuk krijon një *vakuum* ligjor, pasi këto ndalohen në bazë të dispozitave të përmbajtura në nenin 638 të Kodit Civil.

§ 2.3. Dështimi në mbrojtjen e konkurrencës

Edhe pse jo i mirëbashkërunder dhe me disa mangësi, kuadri ligjor i hartuar në vitin 1995 ofronte mjetet e nevojshme për mbrojtjen e konkurrencës. Së pari, me synim mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e tij nga deformimet që mund të vijnë si pasojë e sjelljeve antikompetitive të operatorëve ekonomikë, ligji krijonte Drejtorinë e Konkurrencës Ekonomike, e cila inkuadrohej në strukturat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit. Së dyti, edhe gjykatat mund të mbronin të drejtat subjektive të tregtarëve nga veprimet antikompetitive.

Ndonëse ligji nr. 8044 “Për konkurrencën” i jepte Drejtorisë së Konkurrencës fuqi e kompetenca mjaft të rëndësishme,¹³ mund të themi se

¹² Shprehja “pronësi industriale” është zëvendësuar gradualisht me “pronësi intelektuale”, pasi në të, sipas marrëveshjes TRIPs (Trade Related Aspects of Intellectual Property Rights; Marrakesh, prill 1994, në kuadrin e OBT-së) përfshihen, gjithashtu, e drejta e autorit, know-how dhe sekretet industriale.

¹³ Shih nenin 59 e vijues të ligjit nr. 8044.

ky ligj nuk përfaqësonte tjetër, veçse dështimin e përçarjeve të Shqipërisë për të mbrojtur në mënyrë efektive tregun e lirë dhe për të siguruar kështu edhe demokracinë ekonomike.¹⁴

E para ndër arsyet e këtij dështimi lidhet me organin kryesor që duhet të garantonte konkurrencën, i cili nuk zotëroi kurrë autonominë e nevojshme për zbatimin e detyrave të parashikuara nga ligji¹⁵. Gjendja në fjalë u shkaktua nga shumë faktorë, ndër të cilët ishte parësore mungesa e vullnetit politik për të zbatuar dispozitat e këtij ligji. Kjo për faktin se më shumë se në mbrojtjen e tregut të lirë, interesat politikë të momentit ishin të përqendruara në miratimin formal të ligjit, për të thithur sa më tepër ndihma nga donatorët e huaj. Së dyti, lidhjet e ngushta të politikës shqiptare me biznesin ndikonin në pavarësinë dhe fushën e veprimit të Drejtorisë së Konkurrencës. Së treti, duke qenë se vetë shteti ishte subjekt i dispozitave të këtij ligji, në rastet kur vepronte si operator ekonomik, dilte në pah problemi i konfliktit të interesave ndërmjet mbrojtjes së konkurrencës dhe mbrojtjes së veprimit të Qeverisë. Së fundmi, dyfishimi i organeve mbrojtëse të të drejtave të lirisë ekonomike (*drejtoria e konkurrencës dhe gjykata*) dhe i procedurave të parashikuara për këtë qëllim mund të ketë sjellë paqartësi dhe konfuzion ndër subjektet që kërkonin mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Më tej, shoqatat tregtare dhe profesionale, të cilat sipas ligjit duhet të hartonin rregullat e konkurrencës, nuk treguan interesin e duhur për të nxitur veprimin e Drejtorisë së Konkurrencës.

¹⁴ Neni 11 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë garanton ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kufizime në këtë liri mund të vendosen vetëm me ligj dhe për arsye të rëndësishme publike.

¹⁵ Në shumë prej vendeve perëndimore autoriteti i mbrojtjes së konkurrencës është organ i pavarur nga qeveria.

§ 3. Ligji i ri për konkurrencën

Nevoja për të integruar ekonominë e vendit në tregun botëror, si pasojë e anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë, si dhe dështimi i ligjit nr. 8044, nxitën Kuvendin, për të miratuar ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ligji i ri, i cili zëvendëson tërësisht ligjin nr. 8044, bazohet, gjithashtu në dispozitat e modelit të Bashkimit Europian. Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ai rregullon në mënyrë ekskluzive rastet e sjelljeve që dëmtojnë tregun në tërësi, duke i lënë me të drejtë Kodit Civil detyrën për të mbrojtur operatorët ekonomikë nga shkeljet e të drejtave të tyre subjektive (*konkurrenca e pandershme*), të cilat nuk kanë potencial të çrregullojnë kompetitivitetin e tregut.

§ 3.1 Pamje e përgjithshme e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003

§ 3.1.1 Marrëveshjet

Ashtu si dhe dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Europian,¹⁶ ligji i ri për mbrojtjen e konkurrencës përfshin në fushën e veprimit të tij çdo tip marrëveshjeje, qoftë ajo formale ose informale (*gentlemen's agreement*), e heshtur ose eksplicite. Gjithashtu, në fushën e veprimit të tij ligji përfshin marrëveshjet e realizuara në dy plane, në atë horizontal dhe vertikal, përfshirë këtu edhe praktikat e bashkërenduara ose vendimet e rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Një ndryshim thelbësor nga ligji i vitit 1995, i cili parashikonte një listë veprimesh që në çdo rast konsiderohen në kundërshtim me parimet e kompetitivitetit në treg (*Black List*),¹⁷ ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 parashikon

¹⁶ Neni 81 (ish-neni 85) i Traktatit të Romës, 1958.

¹⁷ Ligji nr. 8044, me kusht që këto marrëveshje të regjistroheshin pranë Drejtorisë së Konkurrencës, përjashtonte shprehimisht nga zbatimi i dispozitave të nenit 16, si dhe të disa

një sistem të bazuar në parimin e rregullës me përjashtim. Sipas sistemit të ndërtuar nga nenet 4 e vijues të ligjit nr. 9121, çdo marrëveshje që ka objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg¹⁸ është e pavlefshme, përveç rastit kur Autoriteti i Konkurrencës konfirmon shprehimisht¹⁹ pajtueshmërinë e tyre me parimet e kompetitivitetit (*Autorizim për Përjashtim*).

Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve ose grupeve të ndërmarrjeve të cilat veprojnë në të njëjtin nivel të tregut (*marrëveshjet horizontale*), edhe pse mund të përmbajnë një ose disa nga kufizimet e parashikuara në nenin 4, mund të autorizohen si të vlefshme nga Komisioni i Konkurrencës, nëse ato kanë për objekt veçanërisht racionalizimin ose specializimin e veprimtarisë ekonomike, kërkimin dhe zhvillimin teknik etj., dhe kanë për pasojë dhe justifikohen nga eficientia ekonomike²⁰. Edhe pse në pamje të parë duket sikur neni 4

neneve të tjera, marrëveshjet që i referoheshin sektorëve të veçantë të ekonomisë: nenet 51 e vijues të ligjit nr. 8044. Ligji nr. 9121 nuk përmban përjashtime për kategori marrëveshesh, por vetëm mundësinë e përjashtimeve për marrëveshje specifike.

¹⁸ Konsiderohen si veçanërisht të rënda marrëveshjet që (i) caktojnë çmimet e blerjes, shitjes apo kushteve të tjera të kontratës, (ii) ato që kufizojnë apo kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik e investimet; (iii) ndajnë tregjet apo burimet e furnizimit; (iv) zbatojnë kushte të ndryshme tregtare me palë të ndryshme (e ashtuquajtura dhuratë besnikërie); (v) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin e detyrimeve të tjera shtesë, që për nga natyra e tyre nuk i përkasin natyrës së marrëveshjes kryesore (të ashtuquajturat Tying Contracts).

¹⁹ Në rastin e marrëveshjeve që lidhen me pronësinë industriale neni 49 parashikon një rast heshtjeje pranimi. Këto marrëveshje janë të vlefshme nëse Komisioni i Konkurrencës nuk shprehet brenda një periudhe tremujore nga marrja e njoftimit (kërkesës) për përjashtim.

²⁰ Sipas ligjit konsiderohen si ekonomikisht eficiente dhe, për rrjedhojë, mund të autorizohen nga Komisioni marrëveshjet që kanë si objekt apo pasojë a) uljen e kostove, rritjen e rendimentit, nxitjen e prodhimit, nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla ose/dhe të mesme etj. dhe kur b) këto rezultate nuk mund të arrihen ndryshe; c) këto marrëveshje nuk kufizojnë ndjeshëm konkurrencën, si dhe d) konsumatorët apo përdoruesit e fundit të produkteve kanë një përfitim. Këto kushte duhet të jenë të pranishme njëkohësisht që autorizimi të jepet.

parashikon dy grupe kushtesh për autorizimin e marrëveshjeve në fjalë, në të vërtetë vetëm kushtet e pikës 2 kanë rëndësi të veçantë, pasi elementet e kërkuara nga pika 1 e nenit (*racionalizimi, specializimi i veprimtarisë ekonomike, kërkimi dhe zhvillimi teknik etj.*) përputhen me ato të pikës 2a. dhe nuk ofrojnë ndonjë kriter të ri.

Në mënyrë të ngjashme, edhe për rregullimin e rasteve të marrëveshjeve që lidhen mes ndërmarrjeve (*ose grupimeve të ndërmarrjeve*), të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivele të ndryshme të tregut (*marrëveshjet vertikale*), ligjvënësi shqiptar ka zgjedhur strukturën e shpjeguar më lart: atë të pavlefshmërisë së marrëveshjeve antikompetitive, që nuk kanë marrë “Autorizimin për Përjashtim” nga ana e Komisionit të Konkurrencës²¹.

Neni 6 i ligjit merr në shqyrtim një sërë klauzolash (*Gray List*), të cilat edhe pse në vetvete janë potencialisht kufizuese të konkurrencës, në kushte të veçanta mund të konsiderohen si me vlerë pozitive për tregun në përgjithësi dhe, për rrjedhojë, të përjashtohen²² nga ndalimi i përmbajtur në nenin 4.

²¹ Ndalimi i caktimit të çmimeve në të drejtën komunitare përfshin jo vetëm marrëveshjet që bashkërendojnë çmimin në mënyrë të drejtpërdrejtë (lista të përbashkëta çmimesh, marrëveshjet mbi çmimet minimale, ato mbi momentin dhe sasinë e rritjes apo uljes së çmimeve), por edhe ato që e bëjnë këtë në mënyrë të tërthortë (marrëveshje për garantimin e një marzhi të caktuar ose për përcaktimin e skontove). Gjithashtu, konsiderohen të dyshimta marrëveshjet që caktojnë kushte të tjera kontraktore, si ato që përcaktojnë kushtet e ofertës, të komercializimit apo të mënyrave të pagesës. Shih: Vanzetti -Di Cataldo, “Manuale di Diritto Industriale”, botimi i tretë, Giuffrè Editore. Vini re se Rregullorja e re nr. 1/2003 BE, në zbatim të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të Romës, ndryshon sistemin e autorizimeve për përjashtim, duke ndaluar automatikisht marrëveshjet që përfshihen në nenin 81 paragrafi i parë, pa patur nevojë për një vendim të shprehur dhe duke cilësuar ato që hyjnë në rastet e nenit 81, paragrafi i tretë si automatikisht të lejueshme, pa qenë i nevojshëm një autorizim i shprehur për përjashtim.

²² Autorizimet për përjashtim si për marrëveshjet horizontale, ashtu dhe për ato vertikale, janë të kufizuara në kohë, gjithmonë të revokueshme nga ana e Autoritetit dhe mund të përmbajnë kushte apo detyrime specifike në ngarkim të ndërmarrjeve.

Ashtu si dhe për marrëveshjet horizontale, argumenti kryesor që justifikon këto përjashtime është eficienta ekonomike, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 5 të ligjit. Përvoja e gjatë komunitare ka treguar se marrëveshjet vertikale janë më pak të dëmshme se ato horizontale, pasi p.sh., kur seleksionimi i distributorëve kryhet sipas kriterëve objektive teknike ose profesionale, dhe jo thjesht sasiore, edhe pse kemi kufizim të konkurrencës *intra-brand* (ndërmjet distributorëve të të njëjtit prodhues), rritet konkurrenca ndërmjet distributorëve *inter-brand*, (distributorët e produkteve konkurrencte me njëri-tjetrin²³).

Praktika e vazhdueshme e Komisionit Europian në lidhje me përjashtimet nga ndalimet²⁴ e nenit 81 të Traktatit të Romës është prirur drejt mospërjashtimit të marrëveshjeve që caktojnë çmimet. Ky interpretim arsyetohet me faktin se praktikisht është e pamundur që një marrëveshje, e cila cakton çmimin, të përmbushë kushtet e përjashtimit të përmbajtura në nenin 81 të Traktatit të Romës, e në veçanti të sjellë përfitim për konsumatorët. Gjithashtu, justifikimi se palët që caktojnë çmimin dysheme, në mënyrë të tërthortë i garantojnë konsumatorit cilësinë e produktit ose shërbimit, nuk

²³ Shih Rregulloren nr. 2790/1999 për informacion më të gjerë mbi rregullat europiane në lidhje me marrëveshjet vertikale.

²⁴ Legjislacioni i Bashkimit Europian, në zbatim të nenit 81 pika 3 të Traktatit të Romës, përveç përjashtimeve të rasteve specifike, njeh, gjithashtu, edhe përjashtimet për kategori të ndryshme ekonomike, të cilat kanë një rregullim të veçantë për shkak të veçorive të fushës ekonomike në të cilën ndërmarrjet veprojnë. Shembuj të këtyre rregulloreve janë Rregullorja nr. 1534/91 për fushën e sigurimeve; Rregullorja nr. 479/92 për shoqëritë e transportit; Rregullorja nr. 4056/86 për fushën e transportit detar; Rregullorja nr. 1017/68 për fushën e transportit hekurudhor dhe të ujërave të brendshme. Të gjitha këto rregullore janë ndryshuar nga Rregullorja e re nr. 1/2003 për zbatimin e neneve 81 e 82 të Traktatit të Romës; shih gjithashtu nenin 36 të Traktatit të Romës, në lidhje me moszbatimin e dispozitave të konkurrencës për fushën e bujqësisë. Vëreni se ligji shqiptar nr. 9121 nuk i njeh Autoritetit të Konkurrencës të drejtën për të përjashtuar nga ndalimi i nenit 4 kategori marrëveshjesh që i përkasin fushave të caktuara të ekonomisë.

është pranuar nga ana e Komisionit European. Marrëveshjet e caktimit të çmimit janë konsideruar gjithnjë të paligjshme edhe kur përfshihen në marrëveshjet vertikale të distribucionit (*përfshi këtu çmimet dysHEME*), pasi këto kanë si pasojë shmangien e konkurrencës në çmim, brenda tregut të produkteve të së njëjtës markë.

Edhe pse neni 81 i Traktatit të Romës nuk përmban asnjë përcaktim të shprehur në këtë drejtim, Bashkimi European i ka konsideruar gjithnjë si të padëmshme, pra, për rrjedhojë, të paprekshme nga ndalimet e nenit 81, ato marrëveshje të cilat, për shkak të peshës së vogël të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, nuk cenojnë kompetitivitetin e tregut. Kjo teori, e quajtur doktrina *de minimis*, e cila është shprehur që prej viteve '70 nga Komisioni European, ka krijuar disa kufij tregu, nën të cilat marrëveshjet nuk konsiderohen të dëmshme.²⁵

Ligji i ri shqiptar për konkurrencën nuk parashikon asnjë përjashtim të shprehur për marrëveshjet që mund t'i quajmë "*të vogla*". Gjithsesi, në rrugë interpretuese, doktrina *de minimis* mund të zbatohet edhe te ne, por për këtë lind nevoja e përcaktimit të caqeve minimale nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Përcaktimi i kufijve do të kishte rëndësi të ndjeshme për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit, pasi do të kufizonte mjaft trafikun e kërkesave për përjashtime, duke i dhënë mundësi Autoritetit të përqendrohet më shumë në marrëveshjet që realisht mund t'i sjellin dëm tregut.

§ 3.1.2 Kontrolli i përqendrimeve

Traktati themelues i Komunitetit Ekonomik European nuk parashikon rregulla specifike për kontrollin ose ndalimin e veprimeve të përqendrimit të

²⁵ Aktualisht, sipas doktrinës e jurisprudencës së organeve të BE-së, nuk konsiderohen të dëmshme marrëveshjet që lidhen mes ndërmarrjeve që së bashku zotërojnë më pak se 5% të secilit treg kombëtar (marrëveshjet horizontale) dhe 10% të secilit treg kombëtar (marrëveshjet vertikale). Doktrina *de minimis* gjen, gjithashtu, zbatim në Rregulloren e cituar nr. 2790/1999.

ndërmarrjeve, të cilat mund të përcaktohen si veprime që synojnë forcimin ose krijimin e një pozite zotëruese në treg. Heshtja e traktatit në lidhje me këtë çështje është rrjedhojë e faktit se efektet e veprimeve të përqendrimit, për vetë situatën ekonomike të periudhës së pasluftës së dytë botërore, konsideroheshin pozitive për rritjen dhe forcimin e tregut dhe të ekonomisë europiane. Më vonë, me forcimin e ekonomisë dhe të industrisë europiane, veprimet e përqendrimit të ndërmarrjeve nisën të vlerësoheshin si potencialisht të dëmshme për konkurrencën. Këto veprime nisën të ndaloheshin duke u bazuar në interpretimin e zgjeruar të nenit 82 të traktatit (*abuzimi i pozitës zotëruese*). Më tej, Komisioni Europian diktoi rregulla specifike në lidhje me veprimet e përqendrimit të ndërmarrjeve,²⁶ duke u bazuar në vlerësimin se vetë fakti i reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë mund të kishte pasoja negative për strukturën e tregut.

Gjithsesi, në ndryshim nga rasti i *karteleve*,²⁷ përvoja komunitare ka treguar se çështjet e përqendrimeve janë trajtuar më pak rreptësisht, pasi edhe për efekt të ekonomisë së shkallës, në shumë raste ato racionalizojnë sistemin e prodhimit ose të shpërndarjes, duke sjellë kështu efekte pozitive jo vetëm për ndërmarrjet që janë pjesë e këtij veprimi, por edhe për konsumatorët.²⁸

Këto vlerësime mund të vihen re edhe në dispozitat e Rregullores (*nr. 139 të vitit 2004*) të miratuar së fundmi nga Këshilli i Europës. Sipas

²⁶ Rregulloret e BE-së nr. 4046/89 dhe nr. 1310/97. Këto dy rregullore tashmë janë shfuqizuar me efekt nga data 1 maj 2004 nga Rregullorja nr. 139/2004.

²⁷ Krijimi i Karteleve nëpërmjet marrëveshjeve është trajtuar gjithnjë në mënyrë shumë më të rreptë nga Komisioni Europian, pasi ato janë më të dëmshme për tregun, si dhe për faktin se këto marrëveshje për vetë natyrën e tyre, normalisht mbeten të fshehta.

²⁸ Kuptohet lehtë valenca pozitive e bashkimit të disa ndërmarrjeve vendore ekonomikisht të dobëta, të cilat bllokojnë në këtë mënyrë veprimet monopoliste të një operatori të madh global.

parashikimeve të kësaj Rregulloreje janë të ndaluara vetëm veprimet e përqendrimit që potencialisht mund të zhdukjin ose kufizojnë konkurrencën në mënyrë të ndjeshme dhe afatgjatë,²⁹ veçanërisht nëse këto krijojnë ose forcojnë një pozitë zotëruese në treg³⁰. Me fjalë të tjera, për të drejtën europiane jo çdo krijim ose forcim i një pozite zotëruese është i dëmshëm dhe, për rrjedhojë, i ndaluar.

Pasi neni 13 i ligjit parashikon shprehimisht se “Komisioni ndalon përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë ose forcojnë pozitën zotëruese në treg...”, në pamje të parë mund të krijohet mendimi se ligji nr. 9121³¹ nuk përqafton doktrinën e së drejtës europiane dhe të shteteve anëtare të BE-së, në lidhje me vlerësimin se jo çdo pozitë zotëruese në treg ka pasoja negative për kompetitivitetin.

Leximi i gabuar i ligjit, i cili shkaktohet nga një redaktim dhe bashkërendim jo i mirë i dispozitave në fjalë, mund të shmanget nëse nenet 10 deri në 17 i analizojmë në mënyrë të kombinuar me nenet përkatëse procedurale të ligjit (*neni 53 e vijues*). Sipas nenit 56, nëse vërehet se përqendrimi shfaq shenja të krijimit ose forcimit të pozitës zotëruese në treg, atëherë Komisioni i Konkurrencës vendos fillimin e procedurës së thelluar ose autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime. Në bazë të interpretimit të kombinuar të këtyre dy neneve, kuptohet se krijimi ose forcimi i pozitës zotëruese në treg vlerësohet si relativisht i dëmshëm. Ky vlerësim negativ mund të

²⁹ Kriteret e vlerësimit të efekteve antikompetitive të një veprimi përqendrimi në legjislacionin europian janë mjaft të qarta. Ato marrin parasysh pozicionin e ndërmarrjeve në treg, fuqinë e tyre ekonomike dhe financiare, pengesat e mundshme që mund të krijohen për hyrjen në treg, etj. Për më gjerë shih nenin 2 të Rregullores së BE-së nr. 139/2004.

³⁰ Neni 2, paragrafi 2 i Rregullores së BE-së nr. 139 të vitit 2004.

³¹ Ligji nr. 8044 bazohej në një parim diametralisht të kundërt me ligjin e ri nr. 9121, pasi vleresonte si absolutisht të dëmshme çdo pozitë zotëruese në treg, duke parashikuar shprehimisht detyrimin për ndarje të ndërmarrjeve që kishin pozitë zotëruese (neni 5 i ligjit nr. 8044).

tejkalohehtë nëse pas analizimit të strukturës së tregut përkatës, në të cilin kërkohet të realizohet përqendrimi³² dhe pas angazhimit të palëve pjesëmarrëse në përqendrim për marrjen e masave të nevojshme për shmangien e efekteve antikompetitive që sjell ky veprim, Autoriteti bindet se dëmi potencial që mund të rrjedhë në kompetitivitetin e tregut, si pasojë e krijimit ose forcimit të pozitës zotëruese, zvogëlohet me masat e marra përsipër nga palët ose me kushtet e detyrimet e vëna nga vetë Autoriteti³³ (neni 56 dhe 57 i ligjit nr. 9121).

Mospërputhjet e shprehjeve të përdorura nga legjislacioni europian dhe ligji shqiptar nr. 9121 nuk krijojnë probleme mospërputhjeje në lidhje me përqendrimet e ndaluara, pasi praktikisht, si kriteret e përdorura për vlerësimin e pozitës zotëruese, ashtu edhe tërësia e strukturës ligjore të krijuar për autorizimin e përqendrimeve janë tendencialisht të njëjta. Interpretimi se objekti i hetimit (përgjigjja pyetjes nëse “*krijimi ose forcimi i pozitës zotëruese pengon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën*”) për kontrollin e përqendrimeve është i njëjtë si në të drejtën shqiptare, ashtu si dhe në legjislacionin dhe doktrinën europiane gjen mbështetje edhe në nenin 1 të ligjit nr. 9121, i cili shprehimisht parashikon se qëllimi përfundimtar i ligjit është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.³⁴

³² Ky analizim duhet të kryhet duke u bazuar në elementet e përmbajtura në nenin 8 të ligjit nr. 9121, në lidhje me vlerësimin e pozitës zotëruese.

³³ Vlerësimi se synimi i ligjit të ri për konkurrencën në lidhje me kontrollin e përqendrimeve nuk është i njëjtë me atë të ligjit të mëparshëm nr. 8044, (neni 5 i të cilit parashikonte detyrimin e ndarjes për ndërmarrjet që kishin pozitë zotëruese), pohohet nga fakti se ndër kushtet e autorizimit për përqendrim që kanë të bëjnë me ndarjen apo shitjen e një pjese të ndërmarrjes, neni nr. 61 i ligjit nr. 9121 rendit gjithashtu kushte (si ndërprerja e marrëdhënieve kontraktore, detyrime për të vepruar apo mosvepruar), që nuk kanë të bëjnë me madhësinë e një operatori ekonomik, por me sjelljen e tij në treg.

³⁴ Interpretimi tekstual i neneve 13, 56 e 57 për sa i përket ndalimit të krijimit ose forcimit të pozitës zotëruese nëpërmjet përqendrimit, pavarësisht nga efektet që ky veprim ka në kompetitivitetin e tregut, do të ishte diskriminues për ndërmarrjet që marrin pjesë në një

Sipas ligjit nr. 9121, përqendrimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve mund të realizohet në mënyra të ndryshme. Neni 10 i ligjit rendit tri raste të përqendrimit: (i) bashkimi i dy a më shumë ndërmarrjeve³⁵; (ii) fitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i kontrollit të ndërmarrjeve³⁶; (iii) krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët³⁷.

Ndërmarrjet që kryejnë një nga veprimet e mësipërme të përqendrimit dhe a) xhiroja së bashku në tregun ndërkombëtar e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse gjatë vitit të fundit financiar është më shumë se 70 miliardë lekë; ose b) xhiroja së bashku në tregun e brendshëm e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse gjatë vitit të fundit financiar është më shumë se 800 milionë lekë ose c) xhiroja gjatë vitit të fundit financiar në tregun e brendshëm e të

përqendrim, përkundrejt trajtimit të ndërmarrjeve që fitojnë pozitën zotëruese nëpërmjet rritjes së veprimtarisë së tyre, për të cilat ligji i ri, në ndryshim nga ligji i mëparshëm, nuk parashikon detyrimin e ndarjes.

³⁵ Bashkimi i ndërmarrjeve mund të realizohet në disa plane të ndryshme: në atë vertikal dhe horizontal.

³⁶ Normalisht fitimi i kontrollit të një ndërmarrjeje realizohet me zotërimin e më shumë se 50% të kapitalit të saj, apo të fitimit në mënyra të tjera të së drejtës së votës që i përket kësaj kuote pjesëmarrjeje. Gjithsesi, në disa raste, sidomos për shoqërite aksionare, fitimi i kontrollit mund të realizohet edhe me zotërimin e një kuote pjesëmarrjeje më të vogël se 50%. Këto raste në Shqipëri janë ende të rralla, pasi shoqëritë aksionare shqiptare, në mungesë të veprimit efektiv të Bursës së Tiranës dhe të tregut financiar në përgjithësi, ende nuk kanë nisur të përfitojnë nga mundësia e mbledhjes së kapitaleve nga publiku i gjerë dhe, për rrjedhojë, të kontrollojnë shoqërinë me zotërimin e një kuote minorance.

³⁷ Nuk konsiderohet përqendrim fitimi i kontrollit të një ndërmarrjeje nga institucionet financiare, bankare apo të sigurimit me qëllim rishitjen e tyre, nëse këto institucione nuk ushtrojnë të drejtën e votës për kuotën e pjesëmarrjes dhe rishitja e tyre bëhet brenda një viti nga blerja. Gjithashtu, edhe pse konsiderohet si përqendrim, ligji nuk i ndalon këto veprime kur njëra nga ndërmarrjet gjendet në rrezik serioz për falimentim. Sidoqoftë, edhe pse këto përqendrime nuk ndalohen, në ndryshim nga rasti i blerjes së aksioneve për rishitje, veprimi i përqendrimit me një ndërmarrje në falimentim e sipër duhet t'i njoftohet Autoritetit për të marrë autorizimin përkatës.

paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në përqendrim është më shumë se 500 milionë lekë, janë të detyruara të njoftojnë Autoritetin për të marrë autorizimin përkatës.³⁸

Pas marrjes së njoftimit për përqendrimin e planifikuar, Autoriteti nis hetimin paraprak për vlerësimin e rrezikshmërisë së forcimit ose krjimit të pozitës zotëruese (*në bazë të dispozitave të nenit 10 të ligjit*) dhe brenda dy muajsh nga marrja e njoftimit³⁹ vendos autorizimin e përqendrimit, fillimin e hetimit të thelluar ose autorizimin me kushte e detyrime. Autorizimi me kushte e detyrime⁴⁰ mund të jepet nga Autoriteti edhe pas përfundimit të hetimit të thelluar (*i cili zgjat tre muaj*), nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim angazhohen të marrin masat e nevojshme për shmangien e efekteve negative që përqendrimi mund t'i sjellë tregut.

Në çdo moment të procedurës së vlerësimit të përqendrimit, Autoriteti mund të japë një autorizim për përqendrim të përkohshëm në rast se ekzistojnë arsye të rëndësishme, si dëmi që mund të pësojnë ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim ose palë të treta.

Realizimi i përqendrimit (i) pa kryer njoftimin; (ii) përpara se Autoriteti i Konkurrencës të japë autorizimin; ose (iii) kur ndërmarrja nuk përmbush angazhimet e marra si më sipër dhe kushtet e vëna nga Autoriteti për dhënien

³⁸ Rritja e kufirit të xhiros për detyrimin e njoftimit në raport me ligjin e vjetër nr. 8044, përveç se është rrjedhojë e rritjes së ekonomisë shqiptare, tregon edhe një herë vlerësimin më të butë që ligji i bën përqendrimeve, duke u fokusuar në rastet më të rënda, dmth. ato të ndërmarrjeve të mëdha. Gjithsesi, mungesa e publikimit të bilanceve reale të shoqërive shqiptare do të ndikojë në zbatimin e këtyre dispozitave.

³⁹ Ky afat shtyhet me dy javë kur ndërmarrjet, për të siguruar fitimin e autorizimit me kushte e detyrime, angazhohen të marrin masat e nevojshme për të shmangur efektet negative që përqendrimi mund t'i sjellë tregut.

⁴⁰ Autorizimi për përqendrim është gjithnjë i revokueshëm nga Autoriteti, nëse janë dhënë informacione të pasakta apo mashtruese, si dhe kur ndërmarrjet nuk përmbushin kushtet dhe detyrimet që Autoriteti mund të ketë përcaktuar në autorizim.

e autorizimit të përqendrimit, ka si pasojë pavlefshmërinë e veprimeve juridike të kryera për këtë qëllim.

§ 3.1.3 Abuzimi i pozitës zotëruese

Nëse objektivi i ligjvënësimit në dispozitat e kreut III të pjesës së dytë të ligjit nr. 9121 është mbrojtja e tregut nga pasojat antikompetitive që mund të rrjedhin nga zvogëlimi i numrit të operatorëve, kreu i tretë i referohet kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjeve që ligjërisht kanë pozitë zotëruese në treg⁴¹ (*monopoli ligjor*) ose e kanë fituar atë nëpërmjet rritjes ekonomike të veprimtarisë së tyre⁴². Këto kufizime në lirinë e veprimtarisë së një ndërmarrjeje, në realitetin e legjislacioneve perëndimore kanë lindur si pasojë e nevojës për të shmangur sjelljet e padrejta të ndërmarrjeve që zotërojnë kuota të larta të një tregu të caktuar.

Ashtu si dhe legjislacioni evropian, ligji shqiptar nr. 9121 nuk jep një përkufizim të qartë të pozitës zotëruese, por e identifikon atë mbi bazën e një sërë kriteresh vlerësuese. Sidoqoftë, doktrina perëndimore evropiane përcakton se nga pikëpamja ekonomike, një ndërmarrje është në pozitë zotëruese nëse ajo ka një kuotë tregu aq të madhe, sa që sjelljet e saj tregtare janë relativisht të pavarura dhe të pakushtëzuara nga sjelljet e operatorëve të tjerë.⁴³

⁴¹ Një ndërmarrje e tillë është KESH Sh.A. Në këto raste, zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 9121 duhet të bashkërendohet me rregullat specifike të konkurrencës, të parashikuara nga ligji, që rregullon një sektor të veçantë. Ndërmarrje të tjera, që ligjërisht kanë pozitë zotëruese në treg, janë ato ndërmarrje që veprojnë në një treg të caktuar, në të cilin nëpërmjet kufizimit të numrit të licencave, shteti kufizon numrin e operatorëve të pranishëm në treg. Rast i tillë është tregu përkatës i telefonisë celulare.

⁴² Për detyrimin e kontraktimit të ndërmarrjeve në pozitë zotëruese shih nenin 673 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

⁴³ Në bazë të praktikës së saj shumëvjeçare, jurisprudenca evropiane ka dhënë disa parametra tregu të cilët mund të përdoren si tregues të pranisë së një pozite zotëruese. Sipas

Ligji nr. 9121 përmban vetëm dy nene në lidhje me mbrojtjen e tregut nga abuzimi i pozitës zotëruese. I pari, neni 8, përcakton kriteret në bazë të të cilave vlerësohet ekzistenca e pozitës zotëruese. Këto kriteret janë të njëjtat që duhet të përdoren për të vlerësuar pozitën zotëruese në rastin e kontrollit të përqendrimeve. Më tej, neni 9 i ligjit jep rastet e veprimeve që konsiderohen si abuzim i pozitës zotëruese. Nëse studiojmë me kujdes veprimet e ndaluara nga ky nen, vërejmë se me përjashtim të disa rasteve të veçanta, ato përputhen me rastet e marrëveshjeve ose të praktikave të ndaluara (neni 4). Kjo përputhje e thelbit të parashikimeve ligjore nuk është e rastësishme dhe është lehtësisht e kuptueshme nëse vlerësohet nga ana objektive. Kufizimi i prodhimit është i dëmshëm për kompetitivitetin e tregut, pavarësisht nëse kryhet nga një ndërmarrje e vetme në pozitë zotëruese ose nga shumë ndërmarrje, të cilat sipas një marrëveshjeje sillen si një ndërmarrje e vetme dhe kontrollojnë tregun.⁴⁴

Disa raste që mund të veçohen si tipike të abuzimit të pozitës zotëruese janë kundërshtimi i pajustificuar për të tregtuar ose për të dhënë licenca, ose kundërshtimi i lejimit të përdorimit të infrastrukturës ose të rrjetit të ndërmarrjes që ka pozitë zotëruese (*essential facilities*)⁴⁵, ose në fund,

këtyre parametrave, një ndërmarrje është gjithmonë në pozitë zotëruese nëse ajo ka më shumë se 70% të tregut përkatës. Ndërsa zotërimi i një kuote tregu të përfshirë në segmentin nga 40% në 70% mund të jetë simptomë e pozitës zotëruese, nëse janë të pranishme disa elemente të tjera, si p.sh.: (i) diferenca e madhe në kuotën e zotëruar të tregut në krahasim me konkurrentin më të afërt; (ii) ekzistenca e pengesave për hyrjen në treg, si aftësi të konsiderueshme financiare, teknike etj. Për më gjerë shih Vanzetti – Di Cataldo, “Manuale di Diritto Industriale”, Giuffrè Editore.

⁴⁴ Afërsia e rasteve të marrëveshjeve të ndaluara me ato të abuzimit të pozitës zotëruese kthehet në identitet nëse marrim rastin e një ndërmarrjeje me pozitë zotëruese, e cila, në bazë të vendimit të shoqatës së kategorisë ku ajo bën pjesë, cakton çmime padrejtësisht të larta ose të ulëta.

⁴⁵ Parashikimi i të ashtuquajturës doktrinë e *essential facilities* është një tjetër përmirësim i ndjeshëm, në krahasim me ligjin nr. 8044.

caktimi i çmimeve padrejhtësisht tepër të larta ose të ulëta.⁴⁶

Nga këndvështrimi i strukturës ligjore, ndryshimi kryesor ndërmjet këtyre veprimeve është se abuzimi i pozitës zotëruese kurrsesi nuk mund të marrë një përjashtim nga Autoriteti. Kjo për faktin se veprimet arbitrare të një ndërmarrjeje që zotëron pjesën më të madhe të tregut, asnjëherë nuk mund të kenë ndikime pozitive për konkurrencën.

§ 3.2. Aspekte të veçanta të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003

§ 3.2.1. Autoriteti i Konkurrencës

Ligji i ri për mbrojtjen e konkurrencës krijon një autoritet të pavarur nga Qeveria. Kjo zgjedhje politike, e cila është në linjë me statusin e autoriteteve analoge të vendeve të Europës Perëndimore dhe të SHBA-së përbën një ndryshim thelbësor në krahasim me strukturën dhe statusin e Drejtorisë së Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës është person juridik publik dhe përbëhet nga dy organe: Komisioni i Konkurrencës dhe Sekretariati. Komisioni është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe anëtarët e tij emërohen nga Kuvendi.⁴⁷ Sekretariati ka detyra administrative, mbikëqyrëse dhe hetimore.

Ligji i njeh Autoritetit fuqi mjaft të mëdha hetimore në mjediset e ndërmarrjeve dhe, me autorizim të gjykatës kompetente, edhe në banesat e

⁴⁶ Ndryshimi thelbësor në caktimin e çmimeve midis rastit të marrëveshjeve dhe abuzimit të pozitës zotëruese qëndron në faktin se në këtë të fundit ndalohet vetëm caktimi i çmimeve tepër të ulëta (nën koston mesatare të ndryshueshme; sipas doktrinës europiane, keto praktika nuk mund të kenë justifikim tjetër përveç nxjerrjes së konkurrentëve nga tregu), apo i çmimeve tepër të larta (të cilat kanë për qëllim fitimin e lartë apo krijimin ose forcimin e një pozite zotëruese). Shembulli tipik mund të jetë ai i ndërmarrjes që shet lëndën e parë me çmim tepër të lartë, për të krijuar apo forcuar pozitën e saj zotëruese në një treg të ndryshëm, p.sh. në atë të përpunimit të kësaj lënde të parë.

⁴⁷ Komisioni i Konkurrencës përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët: një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës, dy nga Qeveria dhe dy nga vetë Kuvendi. Kuvendi cakton, gjithashtu, Kryetarin e Komisionit, ndërsa zëvendëskryetari zgjidhet nga anëtarët e Komisionit.

drejtuesve të ndërmarrjeve të hetuara ose në mjedise të tjera, ku mund të gjenden prova të rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit hetimor. Autoriteti ka, gjithashtu, të drejtë të sekuestrojë dokumente dhe objekte me vlerën e provës materiale, si dhe të vendosë sanksione. Siç shihet qartë, Autoriteti ka disa fuqi hetuese tipike të organit të prokurorisë, të cilat nuk i gjejmë në organe të tjera (si p.sh., organet tatimore), të cilat kryejnë hetime që nuk i përkasin fushës penale.

Ligji i ri për konkurrencën paraqet përmirësime të ndjeshme në krahasim me ligjin nr. 8044 dhe është më i përafërt me legjislacionin europian. Koha do të tregojë nëse, në ndryshim nga ligji i vjetër, ky ligj do të ketë zbatim praktik, gjë e cila do të varet nga pavarësia e veprimit të Autoritetit.

Mbrojtja e konkurrencës së lirë - një nga kushtet kryesore për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Besnik Maho

Student në Shkollën e Magjistraturës

Gjatë viteve të tranzicionit në vendin tonë ka pasur një sërë hapash dhe përpjekje konkrete nga ana e organeve kryesore të pushtetit shtetëror për miratimin e ligjeve dhe të akteve normative me frymë perëndimore, si dhe të nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare për integrimin sa më të shpejtë në strukturat euro-atlantike, përpjekje të cilat janë kurorëzuar me suksese dhe dështime.

Për sa i takon kuadrit të brendshëm ligjor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si organi kryesor i pushtetit shtetëror dhe njëkohësisht organi i cili përfaqëson drejtpërdrejt sovranitetin e popullit, ka pasur detyrë kryesore reformimin e legjislacionit shqiptar, në frymën dhe standardet e atij europian.

Miratimi i ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” ishte guri i themelit në raport me gjithë legjislacionin që u miratua më pas.

Ndër dispozitat kryesore të këtij ligji do të veçonim nenet 2-4 të tij, të cilat sanksiononin njohjen dhe mbrojtjen e ekonomisë së tregut të lirë, pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Me një rëndësi jo më të vogël ishte miratimi i ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”.

Qëllimi i këtij ligji, ashtu siç shprehet në preambulën e tij, është vendosja e një rendi të ri ekonomik, për të mundësuar kalimin nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem të ri ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë.

Nga interpretimi i neneve 1, 3 dhe 6 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, rezulton si detyrë parësore, sanksionimi dhe mbrojtja e pronës private, privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave, si dhe nxitja dhe mbrojtja e lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Gjithçka duhej kthyer në origjinë dhe kjo kërkonte respektimin e trinomit “Privatizim, sanksionim dhe mbrojtje të pronës private, si dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike”.

Pikërisht, nxitja dhe respektimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike kërkonte respektimin e konkurrencës së lirë dhe të ndershme midis pronarëve të rinj që po krijoheshin nga procesi i privatizimit.

Gjatë viteve 1991-2000 dolën edhe një sërë ligjesh të tjera, të cilët sanksiononin dhe nxisnin procesin e privatizimit, si rrugën e vetme drejt ekonomisë së tregut.

Në paketën e ligjeve, të miratuara gjatë kësaj periudhe, nevojë e domosdoshme bëhej miratimi i një ligji, i cili do të kishte si qëllim kryesor të tij përcaktimin e rregullave të lojës midis sipërmarrjeve vendase dhe të huaja, të cilat po krijoheshin nga procesi i privatizimit intensiv që po kalonte vendi ynë, si dhe mbrojtjen e konkurrencës së ndershme midis tyre.

Miratimi i ligjit nr. 8044, datë 7.12.1995 “Për konkurrencën” ishte hapi i parë për trajtimin, ndonëse jo në mënyrë të plotë, të çështjeve që lidhen me monopolet, pozicionet zotëruese, si dhe me konkurrencën e pandershme.

Ligji “Për konkurrencën” u miratua në kohën kur marrëdhëniet tregtare po ecnin me ritme të kënaqshme, pavarësisht se kishin kaluar disa vite nga futja e vendit tonë në ekonominë e tregut.

Megjithatë, duhet theksuar se që nga dita e miratimit të ligjit “Për konkurrencën” dhe deri në korrikun e vitit 2003, kur Kuvendi i Republikës

së Shqipërisë miratoi ligjin e ri “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ky ligj do të haste vështirësi të mëdha në zbatimin e tij.

Gjatë zbatimit të ligjit “Për konkurrencën” dolën një tërësi problemesh, siç ishin procesi i privatizimit të ndërmarrjeve të sektorëve strategjikë (Banka e Kursimeve, Alb-Telekom), si dhe vetë liberalizimi i këtyre sektorëve.

Arsyet e moszbatimit dhe të mosfunksionimit të strukturave të parashikuara nga ligji “Për konkurrencën” lidhen jo më tepër me përmbajtjen e tij, sesa me mungesën e vullnetit të institucioneve përgjegjëse për respektimin e tij. Gjithsesi ky ligj do të përbënte gurin e parë të themelit për ngritjen dhe forcimin e asaj ndërtese që quhet “E drejta e konkurrencës”. Por ajo që duhet theksuar është fakti se kalimi i vendit tonë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë pas viteve ‘90, si dhe përpjekjet që u bënë për reformimin e legjislacionit në këtë fushë, pati edhe kosto.

Kështu, gjatë viteve të tranzicionit, procesi i nxituar i privatizimit, shpesh me çmime simbolike e here-herë gati qesharake, bëri të mundur që shumë ndërmarrje ish-pronë shtetërore të bien në duart e elementëve kriminalë vendas ose të huaj, nga vendet fqinje dhe të rajonit.

Procesi i licencimit, zhvillimi i tenderave që shpesh herë janë realizuar me prokurim të drejtpërdrejtë, ka bërë të mundur krijimin e situatave monopolistike dhe oligopolistike për grupe të caktuara të biznesit, duke u dhënë atyre mundësinë për superfitime të shpejta.

Nga ky rregull i dhimbshëm i tranzicionit nuk bën përjashtim asnjë vend, përfshirë edhe vendin tonë.

Ligji “Për konkurrencën” u bë mjeti e ri më i frytshëm për të rregulluar dukuritë negative që lindën nga procesi i privatizimit, por ky ligj nuk parashikonte mekanizmat e duhura për luftimin e këtyre dukurive.

Konstituimi i Drejtorisë së Konkurrencës Ekonomike, e cila do të bënte të mundur respektimin e ligjit, jo vetëm që do vononte në kohë (6 vjet mbas miratimit të ligjit “Për konkurrencën” më 2001), por edhe në momentin që ajo do të krijohej do ta kishte të pamundur të luftonte dukuritë e lindura, pasi

i mungonte autoriteti për të qenë një organ publik dhe i pavarur.

Gjithashtu, mosparashikimi i institucioneve të tjera përgjegjëse, të cilat do të garantonin zbatimin e ligjit “Për konkurrencën”, nga vetë përmbajtja e ligjit, përbënte një tjetër shkak thelbësor për mungesën e respektimit të tij.

Për rrjedhojë, monopolet private, jo pak të pranishme në ekonomitë e vendeve në tranzicion, ndjekin me egërsi politikën e maksimizimit të fitimeve në tregje të parregulluara mirë ose të rregulluara keq. Institucionet janë të paafta të zbatojnë ligjin, duke dëmtuar në këtë rast interesat dhe mirëqenien e konsumatorëve.

Ndërsa monopolet shtetërore (Albtelekom, KESH), në ndryshim nga monopolet private, pavarësisht se nuk ndjekin politikën e maksimizimit të fitimit, ashtu si monopolet private, e kanë më të pamundur të sigurojnë në sasi dhe cilësi shërbimet që kërkohen nga qytetarët.

Në tërësinë e ligjeve të miratuara gjatë kësaj periudhe, përfshirë dhe ligjin “Për konkurrencën”, sanksionohet mbrojtja dhe respektimi i pronës private, i ekonomisë së tregut, si dhe i lirisë së veprimtarisë ekonomike, por në këto ligje nuk sanksionoheshin strukturat dhe mekanizmat që do të garantonin zbatimin real të tyre.

Këto probleme bënë të domosdoshëm hartimin e një legjislacioni të ri në fushën e konkurrencës, legjislacioni i cili duhet të ishte i harmonizuar me atë europian.

Kjo kërkesë u bë edhe më e dukshme me hapjen e negociatave për procesin e stabilizim-asociimit, ku një vend të veçantë në këtë marrëveshje zë kapitulli i konkurrencës së lirë dhe efektive në nenet 71-72 të saj, si dhe përshtatja e legjislacionit tonë në këtë fushë me “*aquis communautaire*”¹.

Miratimi i ligjit nr.9121, datë 25.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” synon mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive midis sipërmarrjeve

¹ “*Aquis Communautaire*” E drejta komunitare ose e drejta e Bashkimit Europian.

vendase dhe të huaja, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në treg kufizojnë, cenojnë ose shtrembërojnë konkurrencën.

Në këtë kuptim, ky ligj është në mbështetje të atyre bizneseve që duan të konkurrojnë në mënyrë të ndershme dhe të lirë nga presionet shtrembëruese që lindin në treg, për shkak të praktikave të bashkërenduara, siç janë marrëveshjet e tipit “kartel”², abuzimi nga ana e bizneseve që zotërojnë një pozitë sunduese³ ose praktikave monopolistike⁴.

Sipas ligjit nr. 9121, datë 25.7.2004 “Për mbrojtjen e konkurrencës” konkurrenca nënkupton që:

- sipërmarrësi duhet të përpiqet të arrijë avantazhe mbi konkurrentët e tij nëpërmjet cilësisë më të mirë dhe çmimeve më të ulëta të mallrave dhe shërbimeve; dhe

- blerësi, veçanërisht konsumatori, duhet të ketë lirinë e zgjedhjes ndërmjet atyre që ofrojnë mallrat dhe shërbimet.

Konkurrenca mund të kufizohet në mënyra të ndryshme, si:

- nga marrëveshjet midis ndërmarrjeve që kanë të bëjnë me praktikant antikonkurrese, veçanërisht marrëveshjet që kanë si objekt ose si efekt fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregut sipas territorit dhe fiksimin e çmimeve ose volumit të shitjeve;

² Marrëveshje “kartel”, janë marrëveshjet horizontale ose vertikale midis dy ose më shumë firmave konkurruese, të cilat merren vesh për të ndarë tregjet, kufizuar prodhimin ose caktuar çmimet.

³ Ligji i ri, nr.9121, datë 25.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në ndryshim nga ligji “Për konkurrencën”, nuk ndëshkon më pozitën dominuese të firmave në treg, por abuzimin nga ana e firmave me pozitën e tyre dominuse në treg.

⁴ Praktikant monopolistike, janë praktikant që ndiqen nga firmat, të cilat zotërojnë monopolin në ofrimin e një malli ose shërbimi të caktuar te qytetarët (janë të vetme në treg), duke shtrembëruar në këtë rast ligjin e ofertës dhe të kërkesës, pasi janë vetëm ato të cilat vendosin se sa mallra dhe shërbime do ofrojnë në treg, si dhe çmimin e shitjes së këtyre mallrave ose shërbimeve tek qytetarët.

· nga praktikat antikonkurrese të ushtruara nga një ndërmarrje monopoliste ose si rezultat i krijimit ose fuqizimit të strukturës së tregut nga përqendrimit e ndërmarrjeve të pavarura (konkurrenteve).

Për të siguruar mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në ligj, janë parashikuar edhe mekanizmat që garantojnë respektimin e tij, ku barrën kryesore e mban Autoriteti i Konkurrencës, i cili përbëhet nga dy organe: *Komisioni*, i cili është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe *Sekretariati*, i cili është organi hetimor dhe ekzekutiv i tij.

Një rol jo më pak të rëndësishëm luan edhe Gjykata e Tiranës, e cila ka autoritetin për të konfirmuar, ndryshuar ose rrëzuar vendimet e Komisionit mbi bazën e ankimeve të subjekteve të interesuara.

Gjithashtu, me ligjin e ri “Për mbrojtjen e konkurrencës” personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të ngrënë drejtperdrejt padi civile në gjykatën e Tiranës, për të kërkuar respektimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar konform Kodit Civil, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndonjë procesi pranë Autoritetit të Konkurrencës.

E drejta e Gjykatës së Tiranës, për të shqyrtuar jo vetëm ankimet ndaj vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës, por edhe paditë civile që kanë për objekt të tyre moskufizimin e konkurrencës, është një mjet i ri i frytshëm në luftën për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, parashikuar nga ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Por ajo që duhet theksuar është fakti se problemet që lidhen me konkurrencën nuk janë thjesht probleme të një ose dy institucioneve të vetme, sado të fuqishme dhe me përbërje numerike të jenë ato.

Në Francë dhe në Britaninë e Madhe çështjet e krijimit të një mjedisi konkurrues trajtohen në mënyra të ndryshme dhe të bashkërenduara me njëra-tjetrën nga një numër i konsiderueshëm institucionesh.

Mbrojtja e konkurrencës nga një numër i konsiderueshëm institucionesh i përgjigjet më mirë thelbit të saj, pasi konkurrenca si koncept ka një kuptim më të gjerë se ajo që del nga përmbajtja e vetë ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Konkurrenca përbën një ndërtesë, e cila i shtrin themelet e saj jo vetëm në sferat e veprimtarisë tregtare, por në të gjitha fushat e jetës ekonomiko-politike dhe shoqërore të vendit.

Në fusha të caktuara të jetës ekonomike, politike dhe shoqërore mbrojtja e konkurrencës është rregulluar me ligje të posaçme, siç janë ligji “Për Bankën e Shqipërisë”, ligji “Për markat dhe patentat”, ligji “Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për radio-televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” etj.

Në këto ligje janë parashikuar jo vetëm rregullat e lojës ndaj subjekteve përkatëse, ndaj të cilave drejtohen dispozitat urdhëruese të këtyre ligjeve, por, mbi të gjitha, në to janë përcaktuar edhe entet rregullatore përkatëse, të cilat garantojnë mbrojtjen e konkurrencës në fushat përkatëse, siç janë Banka e Shqipërisë, KKRTSH, ERT, Albtelekom, Drejtoria e Markave dhe Patentave etj.

Që gjithsecili të marrë frytet e punës së tij në cilëndo fushë të jetës politike-ekonomike dhe shoqërore të vendit ku ai operon, duhet jo vetëm Autoriteti i Konkurrencës, i cili mban barrën kryesore, por edhe çdokush nga entet rregullatore përkatëse në fusha të caktuar të mbajnë përgjegjësinë dhe të luajnë rolin që i takon.

Për sa i takon qytetarëve, gjithsecili prej nesh duhet të bashkëpunojë me entet përkatëse dhe kryesisht me Autoritetin e Konkurrencës, për të atakuar të gjitha ato sjellje të firmave sipërmarrëse në treg, të cilat kufizojnë, shtrembërojnë ose cenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Për sa i takon përpjekjeve në fushën ndërkombëtare, do të veçonim anëtarësimin e vendit tonë në datë 8.9.2000 në O.B.T, nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh të tregtisë së lirë me vendet e rajonit tonë, si dhe hapja e negociatave më datë 31.1.2003, për nënshkrimin e MSA, të cilat përbëjnë disa nga arritjet për integrimin e vendit tonë në BE.

Për sa i takon efekteve pozitive lidhur me anëtarësimin e vendit tonë në

OBT, si dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit, do të përmendnim:

1. Shqipëria filloi të hapë tregjet e saj ndaj tregtisë botërore dhe investimeve të huaja, që, nga ana tjetër, kërkon domosdoshmërinë e sundimit të ligjit, me sigurinë që rregullat e lojës nuk do mund të ndryshojnë në mënyrë të shpejtë.

2. Aderimi në këtë Organizatë është shprehje e përpjekjeve të Shqipërisë për të përmbushur standardet ekonomike dhe për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në Komunitetin Europian. Ajo që vihet re është përmirësimi i legjisllacionit kombëtar, për ta ngritur në nivelin e standardeve ndërkombëtare, por ajo që është me e rëndësishme është zbatimi i këtij legjisllacioni.

3. Shqipërisë tashmë i duhet të krijojë besueshmëri për investitorët e huaj, se nuk do të ketë ndryshime të papritura në politikat ekonomike dhe tregtare. Në këtë mënyrë do të krijohet një mjedis biznesi që inkurajon tregtinë e mallrave dhe të shërbimeve, që siguron respektimin e konkurrencës së lirë dhe efektive midis bizneseve të vendeve të ndryshme që servirin këto mallra dhe shërbime.

4. Nëpërmjet sistemit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që ka krijuar kjo organizatë, Shqipëria mund të mbrojë investitorët, biznesmenët dhe mallrat shqiptare nga diskriminimi në tregjet botërore.

Duhet të theksojmë se pa mohuar efektet pozitive që ka anëtarësimi i vendit tonë në OBT, të cilat i përmendëm më lart, ky proces ka dhe kostot e tij, të cilat janë⁵:

1. Periudha gjatë së cilës u krye ky proces kompleks është tepër e shkurtër, për më tepër mungesa e përvojës krijon nevojën për përmirësime, sidomos në rastin e angazhimeve të marra në kuadrin e politikave bujqësore. Lidhur me politikën bujqësore do të ishte më e drejtë që angazhimet në këtë fushë të ishin më afatgjata dhe të përmbanin reforma të thella strukturore, në

⁵ Raporti vjetor i Ministrisë së Ekonomisë, procesi i integritimit ekonomik ndërkombëtar, kostot e procesit të anëtarësimit në OBT, faqe 77

mënyrë që fermerët tanë të kenë mundësi të konkurrojnë në kushte të barabarta me ata të huaj.

2. Industritë e reja, të sapo krijuara në vendin tonë, duhet të përballojnë konkurrencën intensive të partnerëve ndërkombëtarë më të zhvilluar. Në këtë kontekst, liberalizimi mund të ishte ndërmarrë me ritme më të ngadalta.

Po çfarë kërkohet nga ana e Shqipërisë në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në fushën e tregtisë?

Sigurimi i një konkurrence të lirë dhe efektive kërkon: ndërmarrje private, shoqata të biznesit, grupe të shoqërisë civile dhe agjenci qeveritare të afta:

- për të projektuar dhe zbatuar politika ekonomike dhe tregtare me qëllim sigurimin e një mjedisi të shëndoshë tregtar;
- për të prodhuar mallra dhe shërbime që plotësojnë kërkesat për cilësi, dizenjo dhe çmime të afta për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare;
- për të fokusuar dhe orientuar drejt nevojat në kuadrin e politikave tregtare të brendshme;
- për të monitoruar dhe analizuar mundësitë e tregjeve të huaja;
- për të rritur transparencën e proceseve të liberalizimit dhe integritetit të vendit;
- për të shoqëruar me luftën kundër korrupsionit dhe sigurimin e një rritjeje eficiente ekonomike.

Ajo që duhet theksuar është se hapja e tregjeve ose liberalizimi i tyre nuk është qëllim në vetvete.

Qëllimi është rritja dhe zhvillimi ekonomik, rritja e produktivitetit, e përmirësimit të shërbimeve që ofron shteti, rritja e konkurrencës dhe rrjedhimisht ulja e çmimeve për konsumatorin.

Një rëndësi të veçantë për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Europian, si dhe për zhvillimin ekonomik të tij ka hapja e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,

Një nga krerët kryesorë për nënshkrimin e MSA, zë ai për mbrojtjen e

konkurrencës dhe konkretisht nenet 72, 73 të kësaj marrëveshjeje, nene të cilat janë në koherencë dhe në pajtim të plotë me nenet 81-88 të versionit të ri në fuqi, i cili përmbledh traktatet e Bashkimit European⁶.

Një vit pas hapjes së negociatave me Bashkimin European, më datë 31.1.2003, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duket se rruga drejt tij nuk është aq e lehtë sa u mendua, dhe se përfundimi me sukses i kësaj rruge kërkon më tepër përgjegjësi dhe angazhim jo vetëm nga Qeveria, por edhe nga gjithsecili prej nesh, që dëshiron të bëhet qytetar i familjes së madhe europiane.

Dy raportet e fundit të Komisionit European, lidhur me implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përmbajnë nota kritike, të cilat godasin sektorë ose fusha të jetës politiko-ekonomike e shoqërore dhe institucionale të vendit, që duhen korrigjuar dhe përmirësuar.

Raporti i Komisionit European për vitin 2003, ndër problemet që duhen zgjidhur, përmend se:

- a) vetëm një pjesë e rekomandimeve të 2002 janë plotësuar;
- b) zbatimi i ligjit mbetet ende i dobët;
- c) stabiliteti politik në vend mbetet ende i brishtë;
- ç) administrata publike mbetet e dobët edhe pse janë bërë përpjekje për reformimin e saj;
- d) shoqëria civile mbetet e dobët;
- dh) Sistemi juridik vuan nga mungesa serioze dhe ka korrupsion;
- e) mbrojtja e pronës private është e garantuar ligjërisht, por nuk zbatohet;
- ë) Kriza e energjisë elektrike mbetet ende problem.

Të gjitha problemet e mësipërme ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e biznesit vendas, në thithjen e investimeve të huaja dhe mbi të gjitha në respektimin e konkurrencës së lirë midis sipërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto kushte, sepse:

⁶ Përmbledhje e traktateve të Bashkimit European, Versioni i ri në fuqi, maj 2000.

1. S'mund të kemi garanci të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, biznesmenëve ose tregtarëve në një shoqëri, kur zbatimi i ligjit mbetet ende i dobët.

2. Kur klima politike është e paqëndrueshme dhe shpesh e lidhur ose favorizuese e bizneseve të caktuara, duke cenuar konkurrencën e lirë dhe efektive në këtë mënyrë.

3. Kur punonjësit në organet publike nuk kanë kualifikimin e duhur, kur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të tyre, një pjesë e tregtarëve ndihen të favorizuar dhe një pjesë jo, dhe, për rrjedhojë, shmanget konkurrenca e lirë dhe efektive.

4. Kur shoqëria civile ende nuk është ngritur në nivelin për të kuptuar të drejtat që asaj i takojnë dhe rrugët demokratike që ajo duhet të ndjekë për mbrojtjen e tyre. Të gjithë jemi qytetarë, në radhë të parë, dhe konsumatorë në radhë të dytë dhe që të gjithë duhet të ngrihemi fuqishëm për të ezauruar të gjitha rrugët ligjore kur shkelen të drejtat tona si qytetarë ose si konsumatorë.

5. Një sistem juridik i korruptuar dhe që i është prishur peshorja, nuk mund të garantojë konkurrencë të lirë dhe efektive në zgjidhjen e konflikteve që do të paraqiteshin në këtë fushë.

6. Nuk mund të kemi nxitje dhe as zhvillim të biznesit vendas dhe atij të huaj në vendin tonë, pa garanci të pronës private, të infrastrukturës, të ujit dhe energjisë elektrike, dhe, për rrjedhojë, as zhvillimin e një konkurrence të lirë dhe efektive, e cila do t'i shërbente të gjithëve.

Raporti i Komisionit European i vitit 2004 vjen me nota edhe më kritike për disa fusha të caktuara, si :

a) reformë urgjente në luftën ndaj krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikeve;

b) reformë më të thellë për forcimin e sistemit gjyqësor dhe të administratës publike;

c) reformë në ekonomi, duke rritur më tepër të ardhurat fiskale nëpërmjet doganave eficente dhe administrimit të taksave;

ç) korrupsioni nuk lejon zbatimin e legjislacionit.

d) Qeveria të demonstrojë më tepër dëshirë politike dhe rezultate.

dh) Shqipëria përballet me vështirësi edhe me angazhimet e saj në Organizatën Botërore Tregtare.

Ndër problemet e mësipërme, dy probleme konsiderohen si shumë të rëndësishme: nxitja e zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht e biznesit të vogël dhe atij të mesëm (SME), dhe reduktimi i ekonomisë informale, domethënë, formalizimi i saj pa e dëmtuar atë.

Zgjidhja e këtyre problemeve lidhet ngushtë me mjedisin ose klimën e investimeve, me sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare, me kuadrin ligjor dhe zbatimin rigoroz të tij, me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar etj.

Po kaq i rëndësishëm mbetet edhe garantimi i suksesit në procesin e privatizimit të sektorëve strategjikë të ekonomisë, veçanërisht në shërbimet publike, siç janë uji, telekomunikacioni, energjia etj.

Duke qenë se tranzicioni në thelbin e vet është një proces investimesh intensive, kuptohet lehtë se sa e rëndësishme është prania e investimeve vendase dhe atyre të huaja, për të mundur zhvillimin e vendit në kuadrin e një konkurrencë të lirë dhe efektive, në kuptimin perëndimor të kësaj fjale.

Por, që të kemi investime të huaja dhe vendase, kërkohet domosdoshmërisht të marrin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata problemet e njohura ekonomike, si kriza energjetike, përmirësimi i shërbimeve publike, zgjerimi i rrjetit dhe shumëllojshmërisë së transportit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, si dhe sigurimi i një klime konkurruese të ndershme nga ana tjetër.

Problemet e mësipërme, të cilat ngrihen në dy raporte të fundit të Komisionit të Bashkimit Europian, përbëjnë shqetësim jo vetëm për zbatimin sa më të shpejtë dhe si duhet të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, si rrugë e vetme drejt Bashkimit Europian, por edhe për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.

Në fund të fundit, të gjitha ato probleme që renditen në dy raportet e Komisionit European, duhen zgjidhur jo vetëm se ato kërkohen prej tij, por se kërkohen edhe nga interesi i përgjithshëm i ekonomisë së vendit tonë, e cila nuk flet me fjalë, por me atë se çka ndodh realisht në jetën e përditshme të çdonjërit prej nesh.

Që problemet e mësipërme të shmangen dhe që ekonomia e vendit tonë të marrë trajtën e ekonomive të shteteve anëtare të Bashkimit European, kërkohet detyrimisht që roli i gjithësecilit prej nesh të mos ngelet në pozitën e viktimës, por në atë të aktorit, i cili duhet të kërkojë në mënyrë të fuqishme dhe të vazhdueshme respektimin dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në çdo fushë të jetës politiko-ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Përligjja filozofike dhe politike e “diskriminimit pozitiv” dhe e kutotave në përfaqësimin e grave në politike dhe vendimmarrje

Henri Çili
Gazetar

Në kohët tona është bërë zakon të flitet aq shumë për një koncept, për një term a një lëvizje politike, saqë nga përdorimi i tepërt, nga përdorimi vend e pa vend, vjen një moment që termi, koncepti kthehet përmes përsëritjes në një koncept pa vlerë dhe bosh. Këtu jemi në pragun e retorikës politike dhe publike që, siç e dimë, nuk e ndihmon përparimin e një çështjeje, por përkundrazi e lë atë në vend, e bën të bezdishme për publikun dhe aktorët e tjerë të shoqërisë. Ky është rasti i “feminizmit”, “diskriminimit pozitiv” ose “kuotave”.

Ndodh shpesh, pra, që ne përdorim “feminizmin” ose flasim për barazinë e aksesit të dy gjinive në jetën publike dhe politike dhe harrojmë origjinën e problemit. Për pasojë kjo ndikon në moskuptimin e problemit, gjë që ka pasoja në vetë zgjidhjen e tij.

Së pari, fjala “*feminizëm*” është një neologjizëm i shfaqur kryesisht në shekullin X, që fillimisht u përdor në një kuptim fyes, por me kalimin e kohës zuri vend si një koncept bazë në hapësirën politike, sidomos të vendeve perëndimore. Duke u bërë në shekullin XX një çështje politike që preku të gjithë aktorët e shoqërisë në një çështje të dorës së parë për grupe të ndryshme politike dhe shoqërore.

Pra, “*feminizmi*” nënkupton një lëvizje për rivendikimin e të drejtave të grave dhe të vendit të tyre në shoqëri, në raport me të drejtat politike dhe shoqërore.

Pak filozofë janë marrë me këtë çështje në kuptimin e drejtpërdrejtë të çështjes, por shumë më tepër të tjerë e kanë trajtuar problemin e barazisë së të drejtave të dy gjinive në kuadrin e çështjeve më të mëdha filozofike dhe politike, si: “*barazia dhe pabarazia*”, “*liria dhe kufizimi saj*” “*njëvlefshmëria e subjekteve humane përballë të drejtave dhe lirive politike*” etj. Pra, edhe nëse në mënyrë të drejtpërdrejtë të njëjtët filozofë nuk kanë folur për atë që ne sot e përkufizojnë thjesht si “*feminizmi*”, prapëseprapë ata kanë folur për thelbin e tij: “*barazinë*”, “*diferencën*” dhe koncepte të tjera afër këtij.

Nëse do të bënim një kalim të shpejtë nëpër mendimin politik dhe filozofik, që ka të bëjë, pra, me të drejtat politike të femrës, kemi mundësi t’ia nisim herët. Çështja është shtruar në mënyrë specifike që në demokracitë antike. Tjetër punë se në gjirin e “*polisit*”, pra, të “*qytetit*”, akordimi i të drejtave politike të grave nuk kishte ndodhur ende. Kështu *Aristoteli*, duke përshkruar *Kushtetutën e Athinës*, na jep një qasje biologjike dhe sociale të kësaj çështjeje. Ai vë re se “*fëmija, prindërit e të cilit pra, babai dhe nëna, janë qytetarë të lire të Athinës, pas dy vjetësh shërbimi ushtarak u takon të regjistrohen në listën e qytetarëve të lirë.*”

Po ashtu, në Qytetin e Spartës, i njohur për mbivlerësimin e anës ushtarake të qytetarëve të tij, *Ksenofoni* nënvizon se “*grate, të cilat janë të forta dhe të shëndetshme fizikisht, edhe pse nuk gëzojnë statusin e qytetarëve të lirë, kanë shans të lindin fëmijë të fortë, kandidatë për ushtarë të aftë për ushtrinë e Spartës.*”

Çështja e të drejtave të grave në gjirin e bashkësisë politike është shtruar me mprehtësi edhe në vazhdim përmes argumenteve të ndryshme, të cilat ngrihen të gjitha mbi një bazë minimale të padiskutueshme: *roli dhe funksioni i ndryshëm i dy gjinive në gjirin e shoqërive është i pamohueshëm.*

Spinoza, në kreun e fundit të veprës së tij “*Traktati politik*” pyet nëse “femrat janë nga natyra” (*ex-natura*), të afta për pushtet apo janë një “plotës” i pushtetit të burrave të tyre”. Të mos harrojmë, jemi në periudhën kur pushteti politik është kryesisht i natyrës monarkike, ku mbretëresha, princesha dhe tituj të tjerë të fisnikërisë gëzohen edhe nga gratë dhe roli i tyre është i madh në pushtetin politik, përfshi këtu faktin që ato trashëgonin pushtetin mbretëror kur ishin më të mëdhatë në moshë ose më afër linjës mbretërore të mbretit që vdiste ose vritej. Pra, Mesjeta dhe monarkia me “mbretëresha” nuk janë qaç të zeza sa i paraqesin sot teoritë marksiste dhe majtiste dhe vetë majtizmi. Nëse sot me “republikën” dhe “demokracinë” është shumë e rrallë të ndeshim një femër presidente ose kryeministre, në Mesjetë mbretëresha ndeshesh shpesh.

E thënë ndryshe, *Spinoza*, në shekullin XVII shtroi pyetjen themelore: “*Dominimi është pra një e dhënë nga natyra apo një krijim i përvojës njerëzore?*” Ai jep përgjigjen e tij në këtë mënyrë: “*Përderisa asgjekundi nuk gjejmë popuj ku gratë dhe burrat ndajnë pushtetin politik, ose popuj ku burrat qeverisen nga gratë, kjo na lejon të nxjerrim konkluzionin se gratë nuk gëzojnë në mënyrë të natyrshme të njëjtat të drejta politike si dhe burrat, pra ato janë nga natyra “ex-natura” inferiore.*”

Të tjerë filozofë si *Niçja*, për shembull, madje shumë më vonë se *Spinoza*, kanë shkuar më tej duke provokuar gjininë femërore, duke thënë se “*drejt një femre duhet shkuar me një lodër në dorë.*”

Kjo situatë në mendimin filozofik dhe politik ndryshoi rrenjësisht kur filozofia e lirive dhe e të drejtave themelore të njeriut u bë filozofi sunduese në kontinent me Revolucionin Francez, kurse në Angli pak më herët, me Kartën e të Drejtave dhe Lirive. Në Angli *Xhon Stjuart Mill* më 1869, me veprën e tij “*Shndërrimi i femrës në subjekt*” e rimori në tërësi problemin e femrës në hapësirën politike dhe duke thënë, pra, se ajo është një “*subjekt politik*” me gjithë të drejtat politike, që nënkupton të drejtën themelore, për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur.

Filozofia e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me *Deklaratën e Revolucionit Francez*, duket se zgjidhi me një goditje shumë probleme dhe debate të mëparshme. Edhe pse ky imponim i një “*standardi nga lart*”, që i ngjan një zgjidhjeje “*deux ex machina*”, provoi se në terren punët do të ishin shumë më të vështira dhe përparimi shumë më i ngadaltë.

Në kuadrin e kultit të ri të barazisë së subjekteve politike dhe shoqërore, përballë të drejtave, pavarësisht nga diversiteti që lidhet me origjinën, pasurinë, besimin fetar, shtresën shoqërore, ngjyrën, racën, etninë etj., problemi i barazisë gjinore u zgjidh dhe u inkuadrua në mënyrë të drejtpërdrejtë, si implikim i luftës dhe i mospranimit, që filozofia e të drejtave të njeriut i bëri “diferencës” dhe “pabarazisë” së çdo lloji.

Nga parimi i barazisë së subjekteve deri te “*feminizmi*” me “*diskriminim pozitiv*”, si mekanizëm për të përmbushur pikërisht këto objektiva të lëvizjes, ka një rrugë të gjatë. Është pikërisht kjo vetë çështja e feminizmit. Por, problemi i pabarazisë mes subjekteve politike në raport me gjininë vazhdon të shtrohet në mënyra të ndryshme. Dhe të dyshohet në mënyra po aq të ndryshme.

Në çastin që pak a shumë liritë dhe të drejtat themelore kanë fituar një lloj “*gjithëpranueshmërie*” dhe “*universaliteti*”, nuk mund të thuhet se “*favorizimi i aksesit*” të femrës në jetën politike ose i “*diskriminimit pozitiv*” ose “*kuotat*” nuk kanë të njëjtin konsensus si Deklarata e Lirive dhe e të Drejtave Themelore të Njeriut, ku parashikohet dhe barazia gjinore.

Do të përpiqemi të argumentojmë pse “*diskriminimi pozitiv*” ose “*kuotat*” në fakt janë një rrjedhojë logjike e drejtpërdrejtë dhe pikërisht e universalitetit të të drejtave.

Le të përpiqemi të ndjekim logjikën formale. Të gjithë pranojmë se femrat dhe meshkujt nuk kanë ndonjë diferencë në kapacitetin dhe aftësitë e tyre për të ushtruar funksione politike dhe publike. Nga ana tjetër, vërejmë që në terren situata është ndryshe. Numri i femrave në insitucionet dhe forumet politike të zgjedhuara ose të emëruara është tejet shpërpjesëtimor. Nëse do

të ishte vepruar me logjikën e parimit të mosdiferencës, domosdoshmërisht del se numri i meshkujve dhe femrave në jetën politike do të ishte përafërsisht i barabartë. Atëherë pse nuk ndodh kjo në realitet? Ka vetëm një përgjigje logjike. Edhe pse është pranuar parimi i barazisë së subjekteve, prapëseprapë mekanizmat politikë dhe shoqërorë që bëjnë të mundur seleksionimin e elitave politike dhe të shoqërisë funksionojnë në një logjikë tjetër nga ajo e barazisë. Sepse, nëse do të funksionojnë ndryshe, numri i femrave dhe meshkujve në elitën politike dhe shoqërore do të ishte pak a shumë njësoj.

Dikush mund të thotë se “dakord”, le ta lënë pas të shkuarën tani e tutje dhe le të vazhdojmë ndryshe. Edhe sikur kjo të ndodhë, prapëseprapë problemi nuk zgjidhet dhe pabarazitë e tanishme gëzojnë potencialin të përsëriten edhe në të ardhmen dhe, pse jo, të thellohen. Për shkak se starti nuk është më i njëjtë, atëherë lind nevoja e një mekanizmi korrektues. Dhe kjo është teknika e kuotave, e aftë që të korrigjojë menjëherë këtë problem.

Dikush i trembet problemit të cilësisë së forumeve dhe të institucioneve në rast të zbatimit të kuotave. Kjo është një frikë e papërligjur. Nëse pranojmë në parim se burrat dhe gratë nuk kanë ndonjë diferencë thelbësore, në lidhje me kapacitetet e tyre për të ushtruar përgjegjësi dhe detyra publike, atëherë logjikisht cilësia e forumeve nuk ka pse të bjerë në rast se ato do të ishin gjysmëpërgjysmë, aq sa propabiliteti hyjnor i Zotit ka ndarë përbërjen e përgjithshme të popullsisë.

Zbatimi i kuotave është jo vetëm plotësisht i përligjur nga pikëpamja politike, por ai ka një shtrat solid filozofik, nga ku mund të mbështetemi për të ndërtuar një hapësirë politike më të barazpeshuar dhe, pse jo, më të zbutur nga ashpërsia dhe konfliktualiteti që zakonisht shoqërizohet me gjininë mashkullore.

Nëse Kuvendi në zgjedhjet e ardhshme do të kishte 70 burra dhe 70 gra, me siguri ai do të funksiononte më mirë.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe nevoja për përmirësime të rëndësishme

Dr. Ylli Bufi

*Kryetar i Komisionit të Përhershëm
të Ekonomisë dhe Financës*

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është miratuar në vitin 1998. Ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe pasqyrohen edhe në veprimtarinë e Kuvendit, i cili është kthyer në institucionin më të rëndësishëm të zhvillimit të jetës politike të vendit. Veprimtaria legjislative është bërë motori i procesit të konsolidimit të institucioneve të shtetit dhe të procesit të integritetit euroatlantik. Tashmë Kuvendi ka krijuar përvojën e tij, që duhet të mbahet më mirë parasysh në përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij, natyrisht duke e ballafaquar edhe me praktikën e parlamenteve të vendeve të tjera. Është koha që Kuvendi të hedhë një hap tjetër të rëndësishëm në rrugën e tij të konsolidimit dhe modernizimit të mëtejshëm, duke bërë ndryshime të rëndësishme në Rregulloren e Kuvendit.

1. ORGANET DREJTUESE TË KUVENDIT

Në tekstet kushtetuese dhe në rregulloret e funksionimit të parlamenteve çështja e parë që rregullohet është ajo e organeve drejtuese të parlamentit. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kjo çështje rregullohet në nenin 75 dhe në nenin 76:

Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.

2. Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është sekretari i përgjithshëm.

3. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit kryhen nga nëpunës të tjerë, siç përcaktohet në rregulloren e brendshme

Neni 75, pika 2

2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

Në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, në « Kreu II Kryetari i Kuvendit » përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Kuvendit dhe si organe ndihmëse të Kryetarit përcaktohet Byroja e Kuvendit dhe Sekretaria.

Byroja e Kuvendit (neni 10 i Rregullores) përbëhet nga Kryetari, dy zëvendëskryetarët dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Ajo « *organizon mbledhje javore për veprimtarinë e Kuvendit dhe për probleme të tjera që mund të dalin* ». Në nenet 39,40, 42 përcaktohet që Byroja e Kuvendit harton programin e punimeve, kalendarin e punimeve dhe rendin e ditës. Ajo mblidhet, gjithashtu, për të përcaktuar rregulla procedurale për zhvillimin e debateve parlamentare. Byroja e Kuvendit nuk ushtron kompetencat që zakonisht kanë byrotë e parlamenteve në vendet e tjera.

Dispozitat kushtetuese, me sa duket, nuk përcaktojnë në mënyrë të plotë organet drejtuese të Kuvendit dhe me pikën 2 të nenit 75 i delegohet Rregullores së Kuvendit të përcaktojë mënyrën se si do të organizohet dhe do të funksionojë Kuvendi. Rregullorja e Kuvendit njeh si organ drejtues të vetëm Kryetarin, pasi kompetencat e Byrosë kufizohen kryesisht në programin dhe kalendarin e punimeve dhe në mbarëvajtjen e seancës plenare.

Çështjet që lidhen me drejtimin dhe funksionimin e Kuvendit janë shumë më tepër se ato që janë, sipas Rregullores, në kompetencën e Kryetarit, të Byrosë së Kuvendit apo të Sekretarit të Përgjithshëm.

Funksionimi i parlamenteve, në dallim nga funksionimi i strukturave të pushtetit ekzekutiv, kërkon ndërthurjen e një sërë kompetencash të drejtimit të strukturave legjislative parlamentare dhe të strukturave të shërbimeve. Ndarja e kompetencave të drejtimit të strukturave legjislative dhe të strukturave të shërbimit midis Kryetarit të Kuvendit dhe Sekretarit të Përgjithshëm ul efektivitetin e funksionimit në tërësi të vetë Kuvendit.

Në të drejtën parlamentare dhe në përvojën e parlamenteve të shumë vendeve, pavarësisht nga specifikat e tyre, është e gjithëpranuar që drejtimi i veprimtarisë dhe funksionimi i parlamenteve, përveç *Kryetarit të parlamentit*, realizohet nga një organ kolegji i përbërë nga vetë parlamentarët, që, në përgjithësi, quhet *byroja e parlamentit*. Organi që merret me përcaktimin e programit dhe të kalendarit të punimeve në përgjithësi është një organ i veçantë që quhet *mbledhja (konferenca) e kryetarëve* të grupeve parlamentare.

Në përgjithësi, byroja e parlamentit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët, kuestorët (të ngarkuar për çështjet e administrimit dhe të buxhetit të vetë parlamentit) dhe sekretarët (të ngarkuar me kujdesin për mbarëvajtjen e procedurave të funksionimit të parlamentit). Anëtarët e byrosë propozohen nga grupet politike dhe zgjidhen në seancën plenare. Me propozimin e grupeve parlamentare anëtarët mund të rinovohen çdo vit në fillim të sesionit. Përbërja e byrosë duhet të jetë sa më afër konfiguracionit politik të parlamentit.

Pra, byroja është ajo që mban kompetencën e përgjithshme të drejtimit të parlamentit, interpreton dhe kërkon zbatimin e rregullores, zgjidh incidentet që ndodhin në seancë plenare, siguron barazinë e trajtimit të deputetëve dhe të grupeve parlamentare, rregullon organizimin e shërbimeve dhe statusin e personelit. Byroja miraton vetë ose i propozon seancës plenare për miratim

buxhetin vjetor të parlamentit. Me propozim të kryetarit të parlamentit, byroja emëron sekretarin e përgjithshëm.

Për të gjitha kompetencat e saj ajo merr vendime dhe miraton rregullore të brendshme. Për të përgatitur vendimet dhe rregulloret e brendshme, si dhe për të mbikëqyrur zbatimin e tyre, byroja formon sekretariate të përhershme, të përbëra nga deputetë. Çështjet, të cilat trajtohen nga sekretariatet, ndryshojnë sipas problematikës dhe përvojës së parlamenteve të ndryshme. Ato, në përgjithësi, trajtojnë çështje të tilla, si ato të buxhetit të parlamentit, të statusit të deputetit, të veprimtarive ndërkombëtare parlamentare, të shërbimeve parlamentare, si dhe ato të bibliotekave, dokumentacionit, të kërkimit dhe të botimeve parlamentare, të marrëdhënieve me median etj.

Konkluzioni i parë :

Ndryshimet që duhet të bëhen në Rregulloren e Kuvendit duhet të marrin parasysh krijimin e një organi kolegjal parlamentar të drejtimit të Kuvendit, të quajtur Byroja e Kuvendit. Byroja aktuale të rikonceptohet në formën e Mbledhjes së Kryetarëve të Grupeve. Pranë Byrosë së Kuvendit të ngrihen Sekretariate për çështje të veçanta të funksionimit të Kuvendit.

2. KOMISIONET PARLAMENTARE

Në teorinë dhe praktikën parlamentare tashmë është e pranuar nga të gjithë se komisionet parlamentare përbëjnë shtyllën kryesore të veprimtarisë parlamentare, sepse kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në ushtrimin e funksioneve të parlamentit:

- ▶ Në funksionin legjislativ,
- ▶ Në funksionin e kontrollit të pushtetit ekzekutiv,
- ▶ Në transparencën e qeverisjes dhe të proceseve politike.

Komisionet parlamentare janë instanca studimi dhe propozimi që, pa marrë asnjë vendim përfundimtar, nëpërmjet raporteve të tyre, përgatisin dhe angazhojnë përfundimisht seancën plenare. Kjo është arsyeja që, në çdo vend, debatet për rivlerësimin e rolit të parlamenteve tradicionalisht nisnin me çështjen e strukturës dhe të kompetencave të komisioneve parlamentare.

Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në praktikatat parlamentare të vendeve të ndryshme komisionet parlamentare organizohen si:

- ▶ komisione të përhershme,
- ▶ komisione të posaçme,
- ▶ komisione hetimi.

Komisionet e përhershme dhe komisionet e posaçme, kur këto merren me shqyrtimin e projektligjeve, konsiderohen *komisione parlamentare legjislative*. Në përgjithësi këto komisione mbulojnë fusha të përcaktuara, nga marrin dhe emërtimin e tyre.

Në praktikatat parlamentare të shumë vendeve njihen dhe struktura të tjera parlamentare të përhershme që kryejnë kryesisht funksione të vlerësimit ose të dhënies së mendimit për çështje legjislative apo të procedurave, të cilat lidhen me funksionimin dhe vendimmarrjen e vetë parlamentit. Duke pasur parasysh funksionet që kryejnë, ato konsiderohen si *komisione të përhershme jolegjislative*. Këto funksione nuk u jepen komisioneve të përhershme, në mënyrë që asnjë nga komisionet e përhershme të mos ketë status të veçantë kundrejt të tjerëve, për çështje që lidhen me procedurat dhe vendimmarrjen. Komisionet jolegjislative ndryshojnë nga komisionet legjislative për nga detyrat, përbërja dhe metodat e punës. Kështu, përbërja e deputetëve në komisionet jolegjislative është e harmonizuar midis maxhorancës dhe opozitës.

Për t'u dalluar nga komisionet e përhershme parlamentare, këto komisione zakonisht emërtohen ndryshe, sipas funksioneve dhe përvojave të veçanta.

Kështu, në Parlamentin Italian funksionojnë: Këshilli i Rregullores, Këshilli Legjislativ, Këshilli i Zgjedhjeve dhe Mandateve, Këshilli i Imunitetit Parlamentar, (quhen *giunta*, “këshill”). Në Parlamentin gjerman funksionojnë komisione studimi, si Komisioni për Zgjedhjen e Gjyqtarëve, Komisioni për Mediatimin, Komisioni për Kontrollin e Shërbimeve Inteligjente etj. Në Parlamentin spanjoll: Komisioni për Rregulloren, Komisioni për Mandatet, Komisioni për Peticionet etj.

Konkluzioni i dytë:

Në Kuvendin e Shqipërisë është e nevojshme ngritja e komisioneve të quajtura këshilla parlamentare. Konkretisht mund të ngrihen:

- ▶ Këshilli Parlamentar i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit;
- ▶ Këshilli Parlamentar Legjislativ.

Këshilli Parlamentar i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit të ketë praktikisht të njëjtin objekt pune që ka aktualisht Komisioni përkatës. Ai duhet të drejtohet nga Kryetari i Kuvendit, të përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare, të ketë numër të barabartë deputetësh midis maxhorancës dhe opozitës.

Këshilli Parlamentar Legjislativ bën vlerësimin e projektligjeve që hyjnë në procesin legjislativ, nëse ato janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe jep vlerësime për çështje të veçanta që kërkohen nga Kryetari i Kuvendit apo nga komisionet parlamentare. Ky Këshill mund të drejtohet nga Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe përbëhet nga deputetë me formim jurist ose me përvojë të gjatë legjislative. Në përbërjen e Këshillit përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare si dhe duhet të ketë numër të barabartë deputetësh midis maxhorancës dhe opozitës.

Këshillat Parlamentare mund të paraqesin raportet e tyre edhe në seancën plenare. Në funksionimin e tyre të dy këshillat parlamentare asistohen nga shërbimi juridik i Kuvendit.

Në praktikat parlamentare është e pranuar nga të gjithë sentenca se *formimi i shumë komisioneve dhe i komisioneve shumë të fuqishme janë dy dukuri të papajtueshme me regjimin parlamentar*. Kjo është arsyeja që madhësia, numri dhe objekti i punës së komisioneve parlamentare janë në ndryshim të vazhdueshëm në të gjitha parlamentet.

Sigurimi i zhvillimit normal të mbledhjeve të komisioneve parlamentare të përhershme dhe efektiviteti i punës së tyre kushtëzohen kryesisht nga madhësia e komisionit, d.m.th. e numrit të deputetëve, anëtarë të një komisioni. Numri mesatar i deputetëve, anëtarë të një komisioni, për disa parlamente është si më poshtë:

Parlamenti	Nr. i deputetëve	Nr. i komisioneve	Nr. mesatar
Gjermania	669	23	29
Franca	577	6	96
Italia	630	14	45
Spanja	350	9	39
Suedia	349	16	22
Finlanda	200	14	15
Portugalia	230	14	16
Shqipëria	140	13	10

Një numër shumë i madh deputetësh në një komision, p.sh. mbi 90, si në rastin e Parlamentit Francez, ku numri i komisioneve të përhershme është vetëm 6, është po aq i papërshtatshëm sa dhe një numër tepër i vogël deputetësh, p.sh. 7 deri 10, si në rastin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në shumicën e parlamenteve me numër mesatar të deputetëve, numri i deputetëve, anëtarë të komisioneve parlamentare lëviz 20 deri 40, kurse në parlamentet me numër të madh deputetësh ky numër është 30 deri 60. Rasti i Parlamentit Francez konsiderohet një përjashtim, pasi numri i komisioneve parlamentare atje kufizohet nga Kushtetuta.

Nga këto vlerësime duket se në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë numri i deputetëve në komisione është mjaft i ulët, gjë që ndikon negativisht në rigorozitetin dhe seriozitetin e procedurave të zhvilluara dhe në angazhimin e pamjaftueshëm të deputetëve në punët përgatitore që bëhen në komisione për shqyrtimin e projektligjeve. Numri tepër i kufizuar i deputetëve në komisione e bën praktikisht të pamundur zbatimin e mjaft normave dhe të praktikave parlamentare të njohura në parlamentet e vendeve të tjera.

Konkluzioni i tretë

Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është e dukshme nevoja për zvogëlimin e numrit të komisioneve të përhershme parlamentare nëpërmjet ristrukturimit të tyre. Mund të propozohen disa variante, por këtu po propozojmë një variant të mundshëm ku numri i komisioneve ulet nga 13 në 7:

1. Komisioni për Çështjet Kushtetuese, Pushtetin Gjyqësor, Administratën Publike, Pushtetin Vendor dhe të Drejtat e Njeriut,
2. Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Integrimin Europian
3. Komisioni për Ekonominë, Financat dhe Buxhetin
4. Komisioni i Sigurisë Kombëtare (Mbrojtjes, Rendit, SHISH-it)
5. Komisioni për Industrinë, Bujqësinë, Transportin, Rregullimin e Territorit, Tregtinë
6. Komisioni për Arsimin, Kulturën, Mediat, Shkencën dhe Sportin
7. Komisioni i Punës, Problemeve Sociale, Shëndetësisë dhe Mjedisit

Në këtë mënyrë, numri mesatar i deputetëve në një komision do të jetë 20.

Zvogëlimi i numrit të komisioneve të përhershme, veç përmirësimeve të rëndësishme që lidhen me funksionimin më të mirë të mbledhjeve të komisioneve, bën të mundur që të fuqizohen shërbimet ndihmëse me sekretarë dhe këshilltarë për çdo komision, si dhe të përmirësohet më shpejt infrastruktura e mjedisëve (sallave) të zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve.

3. ROLI I KOMISIONIT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Në nenin 28, pika a të Rregullores së Kuvendit thuhet se komisionet e përhershme shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet që i paraqiten për miratim Kuvendit, *“duke i parashtruar me raport të shkruar pranimin, mospranimin ose ndryshimin e tyre”*.

Në nenin 60 thuhet: *“Kur komisioni i përhershëm duhet të paraqesë një raport në mbledhje të Kuvendit, relatori zgjidhet nga vetë komisioni me propozimin e kryesisë së tij. Në raport duhet të pasqyrohen edhe qëndrimet e ndryshme për problemin që ngrihet, si dhe shumica me të cilën është marrë vendimi përkatës.”*

Në praktikën e Kuvendit tashmë përgatitja e raporteve nga ana e komisioneve të përhershme në përfundim të shqyrtimit të një projektligji dhe paraqitja e tij në seancën plenare është bërë një normë që zbatohet me rigorozitet. Projektligji nuk shqyrtohet në seancë plenare nëse komisioni përkatës nuk ka përgatitur dhe shpërndarë 2 ditë para seancës raportin e tij për projektligjin. Ajo që nuk zbatohet është caktimi i relatorit për përgatitjen e raportit në emër të komisionit. Zakonisht raporti hartohet në fund të mbledhjes së komisionit nga këshilltari dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit. Në përgjithësi raportet nuk bëjnë analizë dhe vlerësim të plotë të projektligjit që shqyrtohet dhe përqendrohen kryesisht në amendamentet e bëra nga anëtarët e komisionit. Vlerësimi i veprimtarisë legjislative të komisioneve të përhershme duhet të bëhet sidomos në bazë të sasisë dhe cilësisë së raporteve të përgatitura.

Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me numër relativisht të madh komisionesh, për shqyrtimin e një projektligji, nëpërmjet një procedure të paqartë, caktohen disa komisione (zakonisht 2 deri 3). Paraqitja e disa raporteve me konkluzione dhe amendime të ndryshme, disa herë edhe kontradiktore me njëra - tjetrën, vështirëson së tepërmi punën në seancë plenare. Kur qëndrimet e komisioneve që kanë shqyrtuar projektin janë të ndryshme, seanca plenare e ka të vështirë të marrë vendime të sakta.

Gjithashtu praktika e përdorur gjatë shqyrtimit nen për nen të projektit që «*neni miratohet me të gjitha vërejtjet (amendamentet) e paraqitura nga të gjitha komisionet*» nuk është korrekte, vështirëson punën për zbardhjen e tekstit të miratuar, duke lënë mjaft hapësirë për gabime dhe subjektivizma gjatë korrektimit të tekstit.

Caktimi i komisionit të përhershëm për shqyrtimin e projektligjit është një çështje e rëndësishme në procedurat parlamentare. Përvojat e parlamenteve të vendeve të ndryshme tregojnë se shqyrtimi i projektligjeve në seancë plenare bëhet vetëm duke u bazuar në një raport bazë. Për këtë qëllim puna përgatitore për shqyrtimin e një projektligji i besohet një komisioni të vetëm, të quajtur *komisioni kompetent* (përgjegjës). Zgjidhja më e mirë do të ishte që për shqyrtimin e projektligjit të caktohet një *komision kompetent* dhe, sipas rastit, *një ose dy komisione ndihmës*. Komisioni kompetent bën shqyrtimin bazë të projektligjit, duke paraqitur një raport tërësor të përgatitur nga relatori, kurse komisionet ndihmëse bëjnë vlerësime për nene te veçanta të projektit, ose japin opinione për çështje të caktuara. Vlerësimet e komisioneve ndihmëse i paraqiten komisionit kompetent dhe shënohen në rendin e ditës së seancës plenare. Deputetët, që duan të bëjnë amendamentet në seancë plenare, duhet t'i dorëzojnë ato më parë në sekretarinë e seancës dhe të shënohen në rendin e ditës. Është e nevojshme që procedurat për këtë qëllim të përcaktohen qartë në Rregulloren e Kuvendit.

Përcaktimi i komisionit kompetent dhe i komisioneve ndihmëse bëhet në programin dhe kalendarin e punimeve nga Kryetari i Kuvendit sipas sugjerimeve të shërbimeve juridike. Nëse ka vërejtje për caktimin e komisionit kompetent atëherë kjo diskutohet në mbledhjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve. Zvogëlimi i numrit të komisioneve të përhershme dhe ristrukturimi i tyre, sipas propozimit të mësipërm, ndihmon në adaptimin e procedurave të caktimit të komisionit kompetent dhe të komisionit ndihmës.

Përcaktimi i komisionit kompetent, qysh në programin e punimeve, i jep më shumë kohë në dispozicion komisionit të përhershëm në zgjedhjen e relatorit

dhe përgatitjen prej tij të raportit për projektligjin. Kushti për përcaktimin e një relatori dhe përgatitja prej tij e raportit duhet të mbetet vetëm për komisionin kompetent.

Momenti i parë i futjes së komisionit kompetent në procesin legjislativ (shqyrtimi i projektit) është ai i grumbullimit të elementeve të informacionit nga relatori. Relatori, pasi caktohet nga komisioni dhe asistohet nga stafi i tij, merr kontakt me përfaqësuesit e Qeverisë dhe të ministrisë së angazhuar në përgatitjen e projektligjit, kontakton përfaqësues të mjediseve socioprofesionale të interesuara, mbledh një dokumentacion sa më të gjerë të mundur dhe pikëpamjet e ndryshme politike rreth çështjeve kryesore që përmban projekti apo sfidave të reformës që ai propozon. Në rast nevojë, ai mund t'i kërkojë komisionit përfshirjen e personaliteteve të nevojshme në hartimin e raportit, në përputhje edhe me mundësitë financiare të komisionit. Teksti i raportit duhet të përmbajë elementet e informimit, të shpjegimit, të analizës, të krahasimit me kuadrin ligjor ekzistues dhe me normat europiane, si dhe me amendamentet e propozuara.

Momenti i dytë i angazhimit të komisionit kompetent është shqyrtimi i raportit të përgatitur prej relatorit, kopja e të cilit u është shpërndarë deputetëve. Fillimisht në mbledhjen e këtij komisioni zakonisht dëgjohet ministri ose përfaqësuesi i tij, i cili paraqet para komisionit pikëpamjen e tij dhe i përgjigjet pyetjeve të deputetëve. Pastaj relatori bën paraqitjen e tij dhe vazhdohet me një debat të përgjithshëm. Pas debatit fillon shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga relatori, nga deputetët e komisionit dhe nga deputetë të komisioneve të tjera. Në fund, me votim, komisioni miraton raportin dhe amendamentet e propozuara.

Teksti i raportit, shpesh voluminoz, përmban përgjithësisht një analizë globale të projektit, vendin e tij në legjisllacionin që ndryshohet, krahasimet ndërkombëtare, si dhe një gjykim politik në tërësi. Ai vazhdon me një analizë të pëmbajtjes së çdo neni dhe diskutimet e bëra rreth tyre. Ai përfundon me paraqitjen e amendamenteve të pranuar nga komisioni, duke i krahasuar

me tekstin e projektit fillestar. Raporti me nënshkrimin e relatorit dhe të kryetarit të komisionit i paraqitet seancës plenare.

Zakonisht në Rregullore përcaktohet një afat i paraqitjes së raportit para ditës së seancës plenare në mënyrë që edhe deputetë të tjerë të mund të paraqesin amendamente të tyre.

Në seancë plenare relatori paraqet shkurt idetë kryesore të raportit të tij pas fjalës së ministrit. Relatori dhe kryetari i komisionit kompetent gjatë debatit e marrin fjalën sa herë që e kërkojnë. Për amendamentet e bëra nga deputetët në seancë plenare, kryetari i komisionit kompetent mund të kërkojë mbledhjen e komisionit, gjykimi i të cilit vlerësohet si përparësor.

Konkluzioni i katërt :

Duhet të ndërpritet praktika e shqyrtimit të projektligjit nga disa komisione dhe të zbatohet procedura e caktimit të komisionit kompetent. Nevoja e përmirësimit dhe e plotësimit në Rregulloren e Kuvendit të procedurës legjislativë nëpërmjet caktimit të komisionit kompetent, të caktimit të relatorit dhe të paraqitjes së një raporti të plotë prej tij në komisionin kompetent dhe në seancë plenare.

4. SHËRBIMET E KUVENDIT (STRUKTURA E PERSONELIT)

Çështja e funksionimit të shërbimeve të Kuvendit nuk trajtohet në Rregulloren e Kuvendit. Ajo bëhet me një rregullore të brendshme të miratuar vetëm nga Kryetari i Kuvendit. Nisur nga kjo, mendojmë se në organizimin e shërbimeve të Kuvendit ose të stafit të Kuvendit (siç quhet në Rregulloren aktuale) ka mangësi parimore.

Së pari, duhet të theksohet se organizimi i strukturës së stafit të Kuvendit duhet të bëhet duke pasur parasysh realizimin e funksioneve të strukturës parlamentare të Kuvendit. Kjo është arsyeja që në praktikat e parlamenteve të ndryshme struktura e stafit (personelit) quhet përgjithësisht nga të gjithë *struktura e shërbimeve*. Kjo përbën një veçori dalluese të strukturave të

institucioneve të ekzekutivit nga ato të legjislativit (parlamentit). Përgjithësisht shërbimet në parlamente organizohen sipas tri funksioneve themelore :

- ▶ Shërbime legjislative
- ▶ Shërbime parlamentare (të përgjithshme)
- ▶ Shërbime administrative

Shërbime legjislative janë ato që asistojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë strukturat parlamentare (seanca, byroja, komisionet) në realizimin e detyrave të tyre në procesin legjislativ. Shërbimet parlamentare ose të përgjithshme janë ato që ndihmojnë deputetët për të kryer funksionet e tyre në strukturat parlamentare (shërbimi i kërkimit dhe ai bibliotekar, shërbimi i teknologjisë së informacionit dhe i marrëdhënieve me publikun, shërbimi i botimeve parlamentare etj. Në disa parlamente shërbimet parlamentare i përfshijnë brenda shërbimeve legjislative. Shërbimet administrative, ashtu si dhe të gjitha institucionet lidhen me çështjet ekonomike - financiare, të burimeve njerëzore, të mirëmbajtjes, të transportit etj.

Konkluzioni i pestë:

Struktura e stafit (personelit) në Kuvend duhet të riorganizohet në formën e shërbimeve të Kuvendit sipas funksioneve kryesore (legjislative, parlamentare, administrative) dhe që ato të jenë në përputhje me strukturën parlamentare.

Së dyti, aktualisht ndjehet një shkëputje midis veprimtarisë së shërbimeve të Kuvendit dhe veprimtarisë së strukturave parlamentare dhe të vetë deputetëve. Megjithëse struktura e shërbimeve drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, Rregullorja e Kuvendit duhet të sigurojë që disa kompetenca që lidhen me mënyrën e organizimit dhe mbikqyrjen e punës së shërbimeve duhet të jenë në vartësi të strukturave parlamentare, të Byrosë së Kuvendit dhe të sekretariateve parlamentare. Në Kuvend mund të ngrihen :

- ▶ Sekretariati për votimin dhe procedurat
- ▶ Sekretariati për buxhetin e Kuvendit
- ▶ Sekretariati për shërbimin e kërkimit, të bibliotekës, arkivit dhe botimeve parlamentare
- ▶ Sekretariati për marrëdhëniet me jashtë të Kuvendit
- ▶ Sekretariati për statusin e deputetit

Është shumë e rëndësishme që vetë deputetët të ndjekin, të jenë të informuar dhe të mbikqyrin efektivitetin e shërbimeve të Kuvendit, çka është drejtpërdrejt e lidhur me synimin për rritjen e rolit dhe të efektivitetit të veprimtarisë së Kuvendit. Kjo është arsyeja që në Rregulloren e Kuvendit duhet të trajtohen çështjet e organizimit në tërësi të shërbimeve sipas funksioneve kryesore (legjislative, parlamentare, administrative) dhe kompetencat që duhet të ketë Byroja e Kuvendit dhe sekretariatet për organizimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së shërbimeve të Kuvendit. Struktura e shërbimeve duhet të jetë pjesë e Rregullosës së Kuvendit. Çështjet që lidhen me funksionimin e vet shërbimeve duhet të jenë objekt i rregulloreve të brëndshme, të miratuara nga Byroja e Kuvendit.

Konkluzioni i gjashtë :

Struktura e Shërbimeve duhet të përfshihet në Rregulloren e Kuvendit. Deputetët nëpërmjet Byrosë së Kuvendit dhe sekretariateve, duhet të kenë kompetenca që lidhen me mënyrën e organizimit dhe mbikqyrjen e shërbimeve të Kuvendit, të caktuara në Rregullore.

Së treti, mjeti më i mirë dhe i drejtpërdrejtë që deputetët të angazhohen në mirëfunksionimin e Kuvendit ëshë pjesëmarrja e tyre në hartimin, mbikqyrjen dhe transparencën e buxhetit të Kuvendit. Në praktikën e shumë parlamenteve, në byronë parlamentare zgjidhen 3 kuestorë, të cilët përgjigjen, së bashku me sekretarin e përgjithshëm dhe drejtorët e shërbimeve përkatëse, për hartimin dhe mbikqyrjen e buxhetit të vet parlamentit. Sekretariati i buxhetit

të Kuvendit, i drejtuar nga kuestorët dhe i përbërë edhe nga deputetë tjerë përfaqësues të grupeve kryesore parlamentare, harton buxhetin e Kuvendit të detajuar sipas shërbimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve buxhetore, ku përfshihen edhe shpenzimet e bëra nga deputetët sipas statusit të tyre. Buxheti i detajuar i paraqitet për miratim seancës plenare ose Byrosë së Kuvendit në fillim të vitit.

Pas miratimit të buxhetit të Kuvendit, ky Sekretariat programon punën për mbikqyrjen e shpenzimeve të planifikuara. Drejtorët e përgjithshëm të shërbimeve të Kuvendit përgjigjen për administrimin e fondeve të planifikuara, të kontrolluar nga shërbimi i financave të Kuvendit. Në Raportin vjetor të Kuvendit, krahas paraqitjes së treguesve kryesorë të punës së Kuvendit, botohen dhe shpenzimet financiare të realizuara sipas zërave të detajuar në buxhet.

Konkluzioni i shtatë:

Kuvendi duhet të miratojë buxhetin e tij vjetor të detajuar sipas shërbimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve, përfshirë shpenzimet e bëra nga deputetët në përputhje me statusin e tyre. Një sekretariat i përbërë prej deputetësh harton buxhetin dhe mbikqyr zbatimin e tij. Në Raportin Vjetor të Kuvendit paraqiten shpenzimet e kryera, detajuar sipas zërave të miratuar.

5. PROCEDURA E DISKUTIMIT DHE E MIRATIMIT TË PROJEKTLIGJIT TË BUXHETIT TË SHTETIT

Ligji për Buxhetin e Shtetit përbën dokumentin më të rëndësishëm të miratuar nga parlamenti. Pavarësisht nga veçoritë e përvojave dhe të procedurave që zbatohen në vende të ndryshme, qeveritë kanë monopolin e përgatitjes së projektbuxhetit dhe të zbatimit të buxhetit, ndërsa parlamentet kanë funksionin e rëndësishëm të shqyrtimit, të ndryshimit, të miratimit të buxhetit dhe të kontrollit të zbatimit të tij. Procedurat e përgatitjes së buxhetit nga qeveria dhe procedurat e shqyrtimit, të miratimit dhe të kontrollit të

zbatimit të buxhetit të shtetit nga parlamenti përcaktohen në ligjin organik të buxhetit të shtetit. Megjithatë, për shkak të të qenurit unik të dokumentit të buxhetit dhe për shkak të kompleksitetit të procedurave, në rregulloret e funksionimit të parlamenteve procedurat parlamentare të shqyrtimit të projektbuxhetit zënë një vend të veçantë.

Në Rregulloren e Kuvendit këto procedura nuk trajtohen në mënyrë të veçantë. Megjithëse është krijuar një përvojë në shqyrtimin e projektbuxhetit, ndihet mungesa e rregullimit të procedurave që duhet të zbatohen.

Duke pasur parasysh përvojën e deritanishme të shqyrtimit të paketës fiskale dhe të projektbuxhetit, si dhe praktikat parlamentare të disa vendeve, në Rregulloren e Kuvendit duhet të përcaktohet procedura e diskutimit dhe miratimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit si më poshtë :

- Paketa fiskale dhe projektbuxheti paraqiten nga Qeveria në afatin e parashikuar nga ligji organik i Buxhetit.

- Projektbuxheti shqyrtohet nga të gjitha komisionet e përhershme, komisioni i përhershëm i ekonomisë dhe financave ka atributet e komisionit kompetent. Komisionet e përhershme i paraqesin raportet e tyre në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave, i cili paraqet një raport të vetëm në seancë plenare.

- Për shqyrtimin e projektit Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë e Financës përcakton relatorin kryesor dhe relatorët e veçantë. Funksioni i relatorit kryesor zakonisht i caktohet në mënyrë të përhershme një deputeti. Relatori kryesor drejton të gjithë punën për përgatitjen e raportit të projektbuxhetit. Relatorët e veçantë trajtojnë çështje të veçanta të raportit. Relatorët e veçantë mund të jenë edhe deputetë të komisioneve të tjera të përhershme, në përputhje me çështjet që do të trajtohen.

- Çështjet për të cilat mund të përgatitet një raport i veçantë mund të jenë :

1. Treguesit makroekonomik, treguesit kryesorë të projektbuxhetit
2. Paketa fiskale dhe të ardhurat
3. Sektorët socialë dhe sigurimet shoqërore
4. Pushteti gjyqsor, institucionet e pavarura, pushteti vendor
5. Shpenzimet administrative, institucionet qendrore
6. Investimet

· Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim me relatorin kryesor përcakton programin punës së shqyrtimit të projektbuxhetit dhe të paketës fiskale. Programi i punës miratohet në Mbledhjen e Kryetarëve. Në këtë mbledhje bëhet prezantimi i parë i projektbuxhetit dhe paketës fiskale nga Ministri i Financave.

· Sipas programit të punës zhvillohen mbledhjet e komisioneve të përhershme. Në këto mbledhje thëriten, sipas përkatësisë, ministrat dhe relatori kryesor ose relatorët e veçantë, të cilët bëjnë paraqitjen e tyre dhe japin shpjegimet e kërkuara. Komisionet adaptojnë raportet e tyre, që i dërgojnë në Komisionin e përhershëm të Ekonomisë dhe Financave. Çdo komision mund të dërgojë 1 ose 2 deputetë me votë konsultative në këtë Komision.

· Shqyrtimi i projektbuxhetit dhe i paketës fiskale në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave fillon me dëgjimin e Ministrisë të Financave dhe të relatorit kryesor dhe procedon me debatin e përgjithshëm.

· Pas përfundimit të mbledhjeve të komisioneve dhe të debatit në parim në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave bëhet në seancë plenare debati i përgjithshëm për paketën fiskale dhe projektbuxhetin.

· Pas përfundimit të debatit të përgjithshëm në seancë plenare, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe i Financave fillon diskutimin për çështjet e veçanta sipas raporteve të relatorëve përkatës. Gjatë diskutimit të çështjeve të veçanta bëhet dhe paraqitja e amendamenteve nga relatori dhe deputetët.

· Pas diskutimeve të amendamenteve në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave bëhet votimi i tyre sipas kësaj radhe : votohen

amendamentet e paketës fiskale, amendamentet për të ardhurat, amendamentet për shpenzimet dhe projektligji nen për nen dhe në tërësi.

· Diskutimi dhe votimi i amendamenteve në seancë plenare zhvillohet sipas të njëjtës radhë. Për çdo amendament shprehet mendimi i relatorit kryesor dhe vendimi i Komisionit dhe pastaj votohet. Pas përfundimit të votimit të amendamenteve bëhet votimi në parim, nen për nen dhe në tërësi i projektligjit të Buxhetit të Shtetit.

Një çështje e rëndësishme që lidhet me një nga funksionet kryesore të Kuvendit është mbikqyrja dhe kontrolli parlamentar në procesin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit. Për ushtrimin e kontrollit parlamentar në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave është ngritur një nënkomision i veçantë, por veprimtaria e tij e deritanishme ka qenë e pandjeshme. Analiza e kësaj mangësie lidhet me disa faktorë, por në mënyrë të veçantë lidhet me :

Së pari, nevojën e pasjes së një ligji të ri organik të Buxhetit, ku në mënyrë të plotë të përcaktohen mënyrat e informimit në afate të caktuara të Kuvendit nga Qeveria dhe Ministri i Financave,

Së dyti, me mungesën e kapaciteteve profesionale në shërbimet parlamentare (mungesa e stafit). Për këtë qëllim, në strukturën e shërbimeve parlamentare këtë vit është ngritur Shërbimi i Mbikqyrjes së Politikave dhe Financave Publike. Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është të ndihmojë komisionet parlamentare, në veçanti Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe të Financave me informacionin dhe vlerësimet e nevojshme për të ushtruar më mirë funksionin e tij të kontrollit.

Procedurat parlamentare të kontrollit të financave publike dhe detyrat e Shërbimit të Mbikqyrjes së Politikave dhe Financave Publike duhet të përfshihen në Rregulloren e Kuvendit.

Konkluzioni i tetë

Në Rregulloren e Kuvendit në formën e një kreu të veçantë të formulohet

procedura parlamentare e shqyrtimit dhe miratimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të kontrollit të zbatimit të tij.

9. NEVOJA E RISHKRIMIT TË TEKSTIT TË PLOTË TË RREGULLORES SË KUVENDIT

Për të reflektuar të gjitha propozimet e mësipërme, si dhe nevojën e përmirësimeve të tjera që duhen bërë për saktësimin e procedurave të ndryshme, është e domosdoshme që teksti i plotë i Rregullores së Kuvendit të rishkruhet. Në procesin e rishkrimit duhet të përmirësohen edhe formulimi i disa neneve ekzistuese teknikisht të pasakta ose të shmangen përsëritjet e panevojshme. Të synohet që trajtimi i procedural i shumë çështjeve të përfshihet brenda një neni, çka do ta bënte më të thjeshtë përdorimin e Rregullores.

Kundër neorealizmit juridik. Për një debat mbi interpretimin e ligjit*

OTTO PFERSMANN**

Përktheu: Diana ESTREFI

A është e mundur të analizohen normat që përbëjnë një sistem të tërë juridik dhe në mënyrë të veçantë ato të së drejtës kushtetuese? Kjo pyetje e shtruar dhe e debatuar nga partizanët e analizimit të së drejtës, i cili do të bëhej sipas parimeve të një pune shkencore moderne: racionalitet, objektivitet,

* Ky studim është vazhdim i disa mendimeve të dhëna mbi konceptet dhe metodat e teorisë të së drejtës dhe në mënyrë të veçantë i teorisë konstitucionaliste franceze, etapat kryesore të së cilës kanë qenë: 1) koncepti për “vlefshmërinë”: “Për një tipologji të klasifikimit të vlefshmërisë normative”, në Jean-Luc Petit, Grindja për normat – Homazh George Henrik von Wright-it, Fletore e filozofisë politike dhe juridike e Universitetit të Caen-it, nr.27 (1995), f.69-113; 2) përcaktimi i përkohshëm i normave: “Përkohshmëria dhe kushtëzimi i sistemeve juridike”, në Revista e kërkimeve juridike, XIX, (1994), f.221-243; 3) çështja e hierarkisë së normave: “Katrori i Malbergut dhe “hierarkia e normave””, në po këtë Revistë, nr.31, (1997), f.481-509; 4) argumentimi juridik: “Ontologjia e normave juridike dhe argumentimi”, në Otto Pfersmann e Gerard Timsit, Arsytimi dhe interpretimi juridik, publikim i Sorbonës, f.11-34, 5) koncepti i teorisë së “Shteti i së drejtës”, në Olivier Jouanjan, Figurat e shtetit të së drejtës, Rahjshtagu në historinë intelektuale dhe konstitucionale të Gjermanisë, Presses Universitaires de Strasbourg 2001, f.53-78; 6) funksioni juridiksional: “Koncepti “qeveria e gjyqtarëve””, (përgjigje dhënë Michel Troper-it) në Severine Brondel, Nobert Foulquier, Luc Heuchling, Qeveria e gjyqtarëve dhe demokracia, Botime të Sorbonës, Paris, 2001, f.37-52; 7) e drejta e krahasuar: “E drejta e krahasuar si interpretim dhe teori e së drejtës”, në Revue internationale de Droit comparé, 2001, f.275-288.

** Oto Pfersmann është profesor në Universitetin e Parisit I Panteon-Sorbonë, profesor i ftuar në Universitetin e Oksfordit.

neutralitet, mbrojtje e hipotezave nga një metodologji e rreptë dhe e hapur njëkohësisht, duket se ka shkaktuar sot mes teoricienëve të shumtë, si dhe juristëve francezë, një reagim rrënjësisht negativ. Ky pozicion nuk është mbështetur aq shumë nga përkrahësit e së drejtës natyrore dhe varianteve të sotme të saj dhe në mënyrë paradoksale as nga një shkollë e regjistruar vendosmërisht në lëvizjen shkencore empirike. Për “teorinë realiste të interpretimit” (*TRI*) shprehjet lidhur me “kushtetutën”, “ligjet”, “rregulloret” ose kategori të tjera normash të përgjithshme ose të veçanta, nuk mund të fitojnë kurrë as edhe vlerën më të vogël shkencore, shumë-shumë ato mund të formojnë objektin e një shkence *dogmatike juridike* si fjalim ideologjik, në një kohë që shkenca e së drejtës ngrihet në radhë të parë mbi vendimet që zgjidhin përfundimisht një çështje në një rast të dhënë. Fjala është, pra, të kuptohet ky pozicion skeptik, të diskutohet ai dhe t’i nënshtrohet një kritike të vetvetishme. Ajo lind nga një problematikë e përbashkët për gjithë sistemet juridike, sulmohet në çështjet kryesore të teorisë të së drejtës, propozon zgjidhje rrënjësore dhe të rafinuara, mbështetet në premisa kontradiktore, duke mos lejuar të dilet në rezultatin e dëshiruar. Këtë do mundohemi të tregojmë këtu.

Në të gjitha rendet juridike pak të zhvilluara hasen dy dukuri, të cilat një teorie të së drejtës do i duhet t’i shpjegojë: ekzistojnë tekste që shprehin rregulla të përgjithshme ose të veçanta¹, si edhe vendime të dhëna nga

¹ Sipas terminologjisë së përdorur këtu, fjalët “rregull” dhe “normë” janë sinonime dhe cilësojnë të dyja detyrimet, lejimet ose ndalimet e dhëna në një rend juridik. Zakonisht veçohet përdorimi i “rregull” për norma, duke iu drejtuar një grupi që ka krakteristika të përgjithshme. Kjo mund të duket e dobishme, por nuk do të thotë se i ka hequr të drejtën “normës” të përcaktojë këtë grup në cilësinë e vet si normë. “Parimet” nuk janë gjë tjetër, veçse një lloj normash me përcaktim dhe përgjithësim më të fortë, natyrisht të pajisura me një funksion strukturor dhe një status hierarkik shumë të lartë. Këtu nuk kemi të bëjmë me diçka që qëndron jashtë rregullave ose që mund t’u kundërvihet atyre. Parimet, si lloj i rastësishëm normash, sigurisht që duhen dalluar nga parimet e *TRI*-së (“Teoria realiste e interpretimit”), për të cilat do flitet më poshtë.

organet juridiksionale që kanë të bëjnë me raste konkrete.² Shpeshherë është mjaft e vështirë të ndërtohet një raport të çfarëdoshëm mes rregullit dhe rastit, i cili pretendon të jetë “zbatimi” i tij. Ajo që dihet është se në këto sisteme, vendimet e juridiksioneve të instancave ose kompetencave ekskluzive imponohen për rastin, por ndonjëherë duket se këto gjykime ushtrojnë një fuqi normative që e tejkalon çështjen konkrete të cilën ata mendojnë të zgjidhin. Kështu pra, ato vetë kthehen në norma të përgjithshme e të veçanta, ndërkohë që kanë arritur “të zbatojnë” të tjera norma të përgjithshme apo të veçanta.³ Mirëpo në qoftë se nuk mund të provohet se zbatimi ndodhet në një raport varësie me atë që mendohet se po zbatohet, atëherë do të përballemi me një dilemë. Ose normat e përgjithshme e ato të veçanta nuk janë norma në kuptimin juridik, por shumë-shumë disa tregues ose mjete që përdoren nga secili sipas mënyrës së tij, ose vendimet juridiksionale janë disa akte, në

² Një vendim është konkret në kuptimin që organi juridiksional vendos për një çështje (ose një grup çështjesh) që fare qartë i është shtruar atij për zgjidhje, i çfarëdolloj shkalle, të përgjithshme ose të veçantë, qoftë vetë çështja.

³ Ekzistojnë sisteme që u japin në mënyrë të qartë kompetenca normative të përgjithshme organeve juridiksionale. Problemi që na intereson ne mund të duket (në fakt ai duket) i shkëputur nga kjo e dhënë, që nga momenti që në një rend juridik ekzistojnë të tjera organe të prodhimit të normave. Cilado qoftë fuqia e rregullit të precedentit në sistemin e common law përcaktimi mes asaj që është ultra dhe asaj që është infra vires mbetet një problem themelor dhe i pazgjidhur. Protagonistët e konceptit klasik pohojnë epërsinë e Parlamentit (në Mbretërinë e Bashkuar) ose të Kushtetutës (në SHBA) dhe i konsiderojnë si të pafuqishme dhe, si rrjedhojë, të pavlefshme ato vendime juridiksionale që nuk do respektonin këtë parim; partizanët e pozicionit të kundërt mendojnë se kjo teori nuk merr parasysh realitetin, sipas të cilit duhet të njihet përherë një kompetencë, të paktën konkurruese, midis ligjvënësit parlamentar dhe atij juridiksional. Të dyja hipotezat ndeshen me të njëjtat vështirësi: ose nuk kuptohet se ç’ndodh kur një akt është efektivisht ultra vires, por mbetet mirë e bukur i integruar në sistemin juridik, ose dhënia e kompetencave bëhet indecidable. Ligjvënësi parlamentar në çdo moment mund të shkarkojë ligjvënësin juridiksional, i cili mund ta sanksionojë ligjvënësin parlamentar etj. Shih: për shqyrtimin mes dy shkollave, John Forsyth (bot.), *Judicial Review and the Constitution*, Hart Publishers London, 2000.

mos haptazi fare revolucionare, të paktën qartazi në kontradiktë me rregullat, të cilat ua kufizojnë atyre kuadrin, pra akte të mbushura me mangësira, por që, megjithatë përpunojnë evolucionin e sistemeve. Propozohen atëherë tre tipe zgjidhjesh, disa janë politike ose „praktike”, të tjerat janë teorike.

Zgjidhjet “praktike” mbështeten, nga njëra anë, në idenë që është më mirë të vërtetosh se juridiksionet bëjnë atë që personat, të cilët i kanë bërë vetë rregullat e përgjithshme e do ta kenë harruar, ndoshta nuk do kenë mundur ta parashikojnë ose nuk do kenë kurajën ta parashikojnë dhe, nga ana tjetër, ato mbështeten në bindjen morale se këto zgjidhje janë diçka e mirë, dhe nuk mund të jetë ndryshe, pasi e drejta është “pranë jetës së përditshme”, ajo “është krijuar nga njerëzit për njerëzit” dhe i përgjigjet “zhvillimit të shoqërisë”. Natyrisht që është e vështirë të pranohet ky shpjegim, përderisa ai mbështetet në një përzjerje të dyfishtë të së drejtës me moralin dhe të së drejtës me faktualitetin. Ai nuk shpjegon absolutisht asgjë, sepse nuk kuptohet fare se cili do të ishte atëherë funksioni i normave të përgjithshme dhe, nëse ato nuk kanë një të tillë, përse duhet shpenzuar gjithë ajo energji për t’ua imponuar kuadrin legjitimor organeve juridiksionale, në vend që fare thjesht mund të kënaqeshim vetëm me ngritjen e këtyre organeve. Gjithashtu, nuk është kuptuar drejt se si një konceptim i tillë mund të futej në pranimin e një demokracie si sistem juridik – një element i rëndësishëm i së cilës është, të paktën, prodhimi i normave të përgjithshme nga qytetarët ose përfaqësues të tyre – dhe të shtetit të së drejtës – që supozon se zbatimi i rregullave të së drejtës të bëhet ashtu si duhet dhe jo në mënyrë krejt të paparashikueshme – në një kohë që ajo në përgjithësi qahet për këto parime. Së fundi, militantizmi i atyre që duartrokasën me eufemizëm atë që cilësohet “aktivizëm” juridiksional, e sheh fatin e vet të lidhur me atë të jurisprudencës, të cilën e brohorasin ose për të cilën edhe zhgënjehen kur e shohin të kalojë në sensin e kundërt, pa mundur, megjithatë, ta kritikojnë ashtu si duhet. Përveç kësaj, ky entuziazëm vihet përballë kundërshtimit të të gjithë atyre, të cilët për arsye të paktën formalisht të njëjta, do t’u referohen

parimeve të kundërta dhe do të shpallin se këto vendime nuk bëjnë gjë tjetër veçse nxit “padrejtësinë”.

Zgjidhjet teorike mbështeten në përpjekjen për një shpjegim ngushtësisht intrajuridik, por ato marrin dy rrugë krejtësisht të kundërta. Disa formulojnë një përgjigje “realiste”, të tjerat një përgjigje “normativiste”. Ndërsa të parat e mohojnë karakterin juridik të normave të përgjithshme, të vendosura si të tilla, të cilat do të kenë si pasojë vetëm emrin dhe i shikojnë normat vetëm në jurisprudencë, të tjerat vërejnë se këto vendime fare mirë janë dukuri juridikisht të varura dhe, si rrjedhim, është mirë të përcaktohen qartë parametrat e kësaj varësie, sipas të dhënave të veçanta të çdo sistemi. Për ata që pranojnë këtë shpjegim të fundit, pyetja fillestare nuk është gjë tjetër veçse një variant i problemit më të përgjithshëm të “normave të pavlefshme” (si të shpjegohen ndarjet midis kushteve të prodhimit dhe normave efektivisht të prodhuara?), pyetje kjo që shfaqet që me ekzistencën e shumë formave normative në një rend juridik (është tepër e vështirë të konceptohet që një rend i tillë të njohë vetëm një formë ose kategori) dhe që njëra prej tyre shpreh kushtet e prodhimit të tjetrës.

Çdo pozicion ka përparësitë dhe të metët e veta. Realizmi ka meritën se lidhet me analizën e akteve që rregullojnë përfundimisht konfliktet, por ai e bën të pakuptueshëm dhe të paanalizueshëm justifikimin e tyre intrajuridik⁴, të cilin normativizmi e bën të kuptueshëm, por me kusht që të tregojë të paktën disa zgjidhje të miratuara si të vlefshme dhe njëkohësisht me gabime.

Një nga detyrat parësore dhe sfidat e teorisë të së drejtës mbetet shpjegimi i evoluimit të rrethave juridike nëpërmjet konkretizimit dhe historisë së tyre.

⁴ Sigurisht që kjo vlen për sa i përket kuadrin rreptësisht realist. Teoria e të kundërtave argumentuese sigurisht që kërkon të tregojë se këto justifikime dalin nga kundërshtime strategjike, funksionimin e të cilave ajo përpiket ta sqarojë, por thotë se justifikimet s’janë veçse të dhëna të jashtme, të cilat lidhen me qëllimet politike që ndjekin aktorët.

Në peizazhin teorik francez bashkëkohor, mendimi që shfaqet më tepër është ai që vetëcilësohet si *teoria realiste e së drejtës (TRI)*^{5,6,7}

⁵. TRI e quan veten një teori “realiste”. Teoria realiste pohon ekzistencën e disa kategori objektivitetesh, pavarësinë e këtyre objekteve dhe marrëdhëniet e mundshme midis tyre në krahasim me njohuritë e tjera njerëzore, si dhe mundësinë që disa nga këto objekte mund të jenë njohur, të paktën në një farë shkalle, me metoda të përshtatshme. TRI-ja është një teori që është shprehur qartë si antirealiste për sa i përket fushës me objekt “të drejtës”, është një teori realiste e nënkuptuar dhe e pashpjeguar për sa i përket fushës me objekt “interpretimin” dhe asaj në të cilën ajo bën pjesë, “teorisë empirike”. Terminologjia që ajo përdor, sigurisht që është e përhapur gjerësisht midis teoricienëve të së drejtës, të cilët i japin kësaj shprehjeje një përdorim më afër letërsisë ose artit plastik sesa traditës filozofike, madje edhe asaj më të fundit. Sipas TRI-së tregohen vetëm disa të dhëna, si më të përshtatshmet, ndërsa gjithë të tjerat varen nga veprime të ndryshme njohëse ose nga dëshira, që s’kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me të vetmin objekt për të cilin bëhet fjalë e që duhet analizuar. Nga kjo pikëpamje, kemi të bëjmë me një koncept thellësisht antirealist, përderisa kjo teori mohon pikërisht ekzistencën e objekteve juridike të veçanta. Objekte të tilla nuk do të kenë asnjë mbështetje ontologjike dhe, si rrjedhim, nuk mund të bëhen objekt i ndonjë njohurie të çfarëdoshme. Nga ana tjetër, TRI-ja mbështetet, të paktën kështu lë të nënkuptohet, në tezën ontologjike të ekzistencës së pavarur të atyre objekteve që mund të hyjnë në orbitën e eksperiencës („interpretimet”), e madje, edhe në tezën epistemologjike që këto objekte edhe mund të njihen, madje dhe shkencërisht. Në këtë kuptim bëhet fjalë për një teori realiste, por ky realizëm thjesht pranohet, pa u diskutuar si i tillë ose pa u futur në kontekstin e debatit bashkëkohor për realizmin. Ky realizëm empirist i pateorizuar i shërben si mbështetje antirealizmit normativ, i cili çon, nisur nga antirealizmi semantik, në kufij nganjëherë të papërcaktuar. Kështu, do të ishte më e saktë të flitej për “antirealizëm juridik”, kështu emërtimi “TRI” do të quhej vetëm për komoditet, por me të gjitha rezervat e treguara. Në qoftë se TRI-ja mbështet fare qartë një koncept skeptik mbi mundësinë e interpretimit juridik doktrinar, është më pak e qartë se në ç’masë ajo pranon ose kundërshton ekzistencën e normave të përgjithshme dhe të mundësisë së njohjes së tyre. Në këtë kuptim, p.sh. TJE, f.89: “...duhet të pohojmë se ai [interpretimi autentik] është prodhues jo i normave individuale, por i atyre të përgjithshme”, por mospërcaktimi i shprehjeve që formulojnë normat e përgjithshme duket se sugjeron të kundërtën. Ky skepticizëm ndaj rregullave mund t’i afrohet pozicionit të Kripkes, në Wittgenstein, në Saul A. Kripke, Wittgenstein, *On Rules and Private Language* {Wittgenstein, *Des Règles et du Langage Privé*—Për rregullat dhe gjuhën private}, Oxford University Press 1982. Për një debat të shkaktuar kohët e fundit nga kjo vepër, Gary Ebbs, *Rule Following and Realism*, Harvard University Press, 1997.

Si një sintezë origjinale e leximit empirist të traditës kelseniane, si dhe i traditave të ndryshme të „realizmit” juridik, ajo afirmon *mosekzistencën e*

⁶ TRI-ja paraqet një aspekt shumë të rëndësishëm institucional, që sigurisht nuk do të studiohet në këtë shkrim, mirëpo impakti i saj nuk na lejon ta kalojmë në heshtje. Duke qenë e lidhur me punimet e Qendrës së Teorisë të së Drejtës, sot e asocuar në CNRS të Universitetit të Parisit X-Nanterre, ajo mbështetet fort nga një DEA e teorisë së të drejtës, duke lejuar edhe përfshirjen e kërkuesve të rinj. Një numër i rëndësishëm tezash të saj janë mbështetur dhe diskutuar nëpër seminare ose kolokiume të organizuara rregullisht. Po regjistrohet një numër gjithnjë në rritje dhe gjithnjë e më i qartë tezash, artikujsh, kontributesh e të tjera që lidhen me këtë ndikim. Nga kjo pikëpamje, aktualisht duket se TRI-ja është i vetmi koncept teorik institucionalisht i organizuar, i cili është në gjendje të lidhë këto katër epërsi: 1) duke grumbulluar në vazhden e vet një numër në rritje punimesh dhe njerëzish, ajo është bërë një shkollë e vërtetë; 2) ushtron një tërheqje reale të atyre juristëve kërkues, të cilët duke u interesuar për çështje teorike gjejnë aty një kuadër mendimesh teorike, me një përmbajtje kritike të fortë e me linja të drejtuara fuqimisht kundër doktrinave tradicionale; 3) shumë nga punimt e bëra tregojnë lidhjen midis çështjeve të së drejtës pozitive dhe bazës teorike që drejton analizën e saj; 4) nëpërmjet orientimit të saj empirik ajo bën të shikohet lidhja e fortë midis dukurive juridike dhe atyre politike.

⁷ Pikësëpari TRI-ja konsiston në veprën e Michel Troper-it, profesor në Universitetin Paris X-Nanterre, duke hedhur bazat e saj fillimisht në tezën e tij të doktoraturës (Ndarja e pushteteve dhe historia kushtetuese franceze, Paris, LGD, 1980), të cilën e zbatoi dhe e përshtati më pas në një numër temash problematike të së drejtës publike bashkëkohore. Ajo do të marrë si objekt kryesor TRI-në, në atë formën që ky autor i ka dhënë në veprat që përmbledhin artikujt kryesorë të tij: Për një teori juridike të shtetit, Paris, 1994, (koleksioni Leviathan); Teoria e së drejtës, e drejta, shteti, PUF, 2001. Nuk do të bëhet aluzion për variantet e futura nga nxënësit e tij ose përfaqësues të tjerë të kësaj teorie, të cilat do t’i jenë bashkuar asaj në rrugë të ndryshme (shih pikërisht punimet e Olivier Cayla, Nocioni i “kuptimit” në drejtësi, tezë, Paris, 1992; “E drejta” në Monique Canto-Sperber Fjalor i etikës dhe i filozofisë morale, PUF, 1996, f.439-446 etj. TRI-ja ka shumë ngjashmëri me shkollën realiste të Gjenovës, prej së cilës dallohet, megjithatë, nga radikalizmi i skepticismit të vet normativ. Bibliografia e kësaj shkolle është shumë e pasur. Një nga shkrimet me bazë duket të ketë qenë „La semantica del neustico. Osservazioni sulla „parte descrittiva” degli enunciati precettivi”, në nga i njëjti autor Diritto, enunciati, usi. Studi di teoria e metateoria del diritto, Bologna il Molino, 1974 etj.

së drejtës si objekt normativ, dhe, si rrjedhim, *pamundësinë e çdo doktrine juridike*. Me fjalë të tjera, sipas njërës prej koncepteve më të zhvilluara e më me ndikim mes juristëve publicistë francezë, nuk ekziston *asnjë* veprimtari shkencore e veçantë *juridike*, as *a fortiori* e fushës disiplinore. Natyrisht që ekziston një objekt disiplinor, por ai të çon në një objekt tjetër: një objekt i radhës së parë, vendimet dhe interpretimet autentike dhe një i radhës së dytë, dogmatika.

TRI-ja ndan me të tjera koncepte objektivin për t'i dhënë sistemit juridik një vizion krejtësisht të ndryshëm nga ai që shpërndan doktrina tradicionale, në mënyrë të veçantë formave të ndryshme të kthimit të jusnatyralizmit progresist ose konservator. Originaliteti i saj i madh qëndron në atë që ajo i kundërvihet po aq fuqishëm *Teorisë së pastër të së drejtës (TPD)* (disa elementë të së cilës një numër i madh publicistësh, të paktën për një periudhë të caktuar, i kanë pranuar si baza të konceptit të tyre), gjithë duke pohuar ruajtjen e thelbit të trashëgimit kritik të saj. Gjithashtu, ajo u shkëput nga teoritë „realiste” skandinave⁸ ose amerikane. Për disa aspekte ajo bashkohet me mendimet e teorisë së filozofisë analitike, kur bëhet fjalë për të vetmet të dhëna të përshtatshme, që për të janë „interpretimet”, domethënë, aktet e përcaktimit të kuptimit. Nga pikëpamja tematike, kërkimet e bëra në emër

⁸ Veçanërisht Alf Ross, *Toucards a realistic Jurisprudence*, Kopenhagë, 1946; *On Law and Justice*, Stevens and Sons London, 1958; *Directives and Norms*, Stevens and Sons London, 1968. Vepra e Ross u bë objekt i shumë punimeve, e pikërisht objekt i një kritike mjaft të thellë në *On Law and Justice*, nga Hans Kelsen: “Eine “Realistische” und die Reine Rechtslehre”, në *Osterreichische Zeitschrift fur Offentliches recht*, 1959 (X), f.1-25 (tani i pranuar edhe në France dhe i përkthyer në Dossier, *Teorie realiste du droit*, Presses Universitaire de Strasbourg, 2000, f.15-42, ashtu si edhe nga kritikja H.L.A.Hart “Scandinavian Realism”, në *Cambridge Law Journal*, 1959, vep. e cit.,f.233-240 (në frëngjisht në Jouanjan, f.45-50; shih gjithashtu edhe hyrjen nga Eric Millard, vep. e cit., f. 9-14. Për diskutime më të fundit shih: Neil Duxbury, *Patterns of American Jurisprudence*, Oxford University Press, 1995; Duncan Kennedy, *A Critique of Adjudication*, Harvard University Press, 1997; Michael Martin *Legal Realism: American and Scandinavian*, Lang, Nju Jork, 1997.

të saj janë hasur me problemet më aktuale dhe më të vështira të evolucionit të demokracive kushtetuese bashkëkohore dhe, në mënyrë të veçantë, me rëndësinë gjithnjë në rritje të drejtësisë kushtetuese, të „të drejtave të njeriut” dhe të dukurive të integritimit supranacional.

TRI-ja ka merita të rëndësishme. Në radhë të parë, ajo rivë në diskutim çdo formë të idealizmit juridik, si edhe i kundërvihet nje testi empirik me pohim doktrinar: “Cilat janë të dhënat e vëzhgueshme që mbështesin këtë pohim? Cili është akti i fundit që zgjidh efektivisht një çështje të lënë pezull?” Më tej ajo është një teori që ka përdorur në mënyrën më ofensive analizën e gjuhës kundër dogmatizmit doktrinar. *TRI*-ja është, përveç kësaj, një kritikë e brendshme dhe tepër e fuqishme e *TPD*-së, e cila denoncon dobësitë argumentuese të saj, duke i kundërvënë asaj konkluzionet që dalin nga një rindërtim i vetvetishëm. Kështu, ajo kontribuon në mënyrë paradoksale në një reflektim tepër produktiv në trashëgiminë kelseniane në Francë dhe, në mënyrë më të përgjithshme, në debatin rreth epistemologjisë analitike të së drejtës.

Në qoftë se *TRI*-ja funksionon, ajo çon në evidencimin e pasojave mjaft të rëndësishme, përderisa ajo mbështetet kryesisht në kritikën e disa tezave konstitutive të *TPD*-së. Pra, ashtu si *TRI*-ja kuptohet si një tejkallim kritik i *TPD*-së, ndërsa kjo e fundit kritikon doktrinën tradicionale, ajo nuk mund ta rehabilitojë më këtë doktrinë tradicionale. Megjithatë, *TRI*-ja shfaqet fare mirë si një teori e “së drejtës”. Si rrjedhim, ajo duhet të propozojë një koncept shpjegues alternativ, domethënë t’i japë një përgjigje bindëse pyetjes që kërkon të dijë, nga njëra anë, për çfarë bëhet fjalë kur trajtohet si objekt “e drejta”, dhe, nga ana tjetër, si do jetë e mundur të zgjidhen problemet që kanë lidhje me këtë objekt, ose të paktën si do të mund të pranohet që të zhvillohen të tjera teori, sigurisht ato që mund ta lejonin një gjë të tillë.

Kërkohet shumë kujdes. Nuk bëhet fjalë për trajtimin e të gjitha varianteve të realizmit të ashtuquajtur interpretativ, por vetëm të *TRI*-së, në kuptimin ku ajo është shfaqur dhe është shpërndarë në Francë, dhe si është ekspozuar

dhe mbështetur nga përfaqësuesi i saj kryesor. Nga ana tjetër, nuk do të llogariten si të tilla edhe dy teori të tjera që s'janë gjë tjetër veçse shtojca të TRI-së: “teoria e detyrimeve argumentuese” (TCA)⁹ dhe “teoria juridike e shtetit” (TJE). Kjo e fundit ka të bëjë me lidhjen mes sistemit të parimeve dhe koncepteve “e cila formon atë që zakonisht quhet teoria e përgjithshme e shtetit”¹⁰ nga njëra anë dhe strukturën e përgjithshme të sistemit juridik nga ana tjetër¹¹; ndërsa teoria e parë analizon si “detyrim specifikisht juridik [atë çfarë ndodh], në një kohë që për të arritur një qëllim të caktuar ekziston vetëm një mjet, ose të paktën një mjet që shfaqet si më i miri dhe është i lidhur me formën e argumentimit juridik. Fare mirë mund të ndodhë që një agjent të mos mbledhë një detyrim dhe të mos përdorë këtë mënyrë, por në këtë rast ai nuk ia arrin qëllimit”¹². Sigurisht që këto koncepte duken të lidhura fort me njëra tjetrën.¹³ Ato mbështeten mbi emergjencën dhe funksionin e koncepteve, si edhe mbi argumentet e përdorura me qëllim justifikimin e disa pohimeve nëpër ligjërata, të cilat cilësohen si “juridike” ose me qëllim justifikimin e normave juridike apo morale. Ndoshta TJE, përveç kësaj, s'është veçse një zbatim i teorisë së të kundërtave

⁹ Përveç shkollave skandinave, amerikane dhe italiane tashmë të cituara, ekzistojnë edhe një numër shumë i madh variantesh, ndonjëherë të përafërta me TRI-në. Shih, p.sh. Laurenc M. Friedman “On the interpretation of laws” *Ratio Juris*, 1988, f.252-262; Urszula Mos, “Sawa Frydman: A Polish Legal Realist”, *Ratio Juris*, 1991, f.72-78.

¹⁰ Duhet të dallojmë TCA-në, objekt i së cilës është mënyra e krijimit të kufizimeve të përzgjedhjeve në dispozicion, kur një interpretues autentik përdor formën e “argumentimit juridik” të atyre detyrimeve që janë rezultate të faktit se çdo interpretim autentik është integruar në një rrjet detyrimesh faktike të pushtetit, në TJE, f. 314.

¹¹ TJE, 20.

¹² TJE, 22.

¹³ Micel Troper, « Detyrimet argumentuese », dorëshkrim, botuar në aktet e bashkëbisedimeve ndërkombëtare kushtuar detyrimeve juridike në Paris, tetor 2000. Shih edhe një diskutim të këtij koncepti dhe të lidhjeve që krijon ai me TRI-në, Otto Pfersmann, “Kritika e teorisë së detyrimeve juridike” botuar në po këtë vëllim.

argumentuese, por ky problem nuk do të trajtohet këtu. Në fakt të dyja supozojnë *TRI*-në si teori realiste e së “drejtës”, domethënë e objektit në të cilin shfaqen disa koncepte ose argumentime të kundërta, ose i objektit të cilit i referohen diskutimet me analizën e të cilave merren këto teori.

Përzgjedhja e shprehjeve bëhet e tillë që të japë sa më qartë që të jetë e mundur projektin shpjegues të teorisë. Ky kufizim sjell në mënyrë të pashmangshme rrezikun e një arbitrariteti në përjashtimin e ndonjë argumenti apo elementi, i cili do ta plotësonte konceptin në tërësi. Mirëpo, interesi i një diskutim të tillë qëndron pikërisht në atë që ai lejon të bëhen të qarta, të diskutueshme dhe të rishikueshme premisat, metodat dhe rezultatet e propozuara.

Rindërtimi i teorisë do të lejonte nënshtrimin e saj ndaj një kritike të vetvetishme.¹⁴ Nuk mjafton vetëm të parashtrohet që, nëse pranohen këto koncepte, kjo e bën të pamundur zhvillimin e çdo shkence të së drejtës, me të vetmin përjashtim të një varianti të sociologjisë politike. Kjo sepse objektivi i *TRI*-së është pikërisht të tregojë se çdo përpjekje tjetër do të varej thjesht nga ideologjia. Vetë ajo kërkon të mos synojë, me asnjë lloj hipoteze, konceptin e „së drejtës”, por sociologjinë e bindjes.¹⁵

¹⁴ Shih TDDE, f. IX.

¹⁵ Është e habitshme kur shohim se *TRI*-ja ka qenë objekt i shumë pak punimeve kritike. Mund të shënojmë kryesisht: Riccardo Guastini, “Michel Topper dhe interpretimi i kushtetutës”, në P. Comanducci, R. Guastini *L'analisi del ragionamento giuridico*, Torino, 1989, f.249-265 (shënon kufizimin e *TRI*-së vetëm në fushën e vendimeve juridiksionale); Charles Leben “Parimi i barazisë para ligjit dhe teoria e interpretimit gjyqësor”, në Gui Haascher Chaim Perelman et la pensée contemporain, Bruylant, Bruksel 1993, f.215-235 (kritikon kufizimin artificial të realizimit në sistemet e case-law ngritur nga juridiksionet); Denis de Bechillon “Radha e hierarkisë së normave dhe teoria realiste e interpretimit – mendime kritike”, në *Revue de la Recherche juridique*, 1994, f.246 (replika e Michel Troper: po ajo revistë, f.267). Gerard Timsit “Kundër thënies së re”, në *Le nouveau constitutionalisme*, Përmbledhje për nder të Gerard Conac nga Jean-Claude Colliard e Yves Jegouzo, *Economica*, 2001, f.31-48. Gjithashtu, duhet thënë se shumë punime kërkimore të pabotuara, pikërisht kujtime të DEA-s,

Përveç disa vërejtjeve të shkurtra, do të rezervohemi për ta futur problemin e zhvilluar këtu në grupin e diskutimeve filozofike dhe juridike bashkëkohore. Ky diskutim është kufizuar në studimin e një teorie të veçantë, në arkitekturën e saj, koherencën e brendshme, përdorimin e saj nga një teori tjetër, në kontrast me të (TPD-në).¹⁶

Këtu nuk do të diskutohet, as nuk do të skicohet, ndonjë teori alternative dhe as që bëhet fjalë për të mbrojtur konceptet që sulmon *TRI*-ja. Ky studim i kushtohet analizës së një teorie të së drejtës dhe kritikës së saj të brendshme. Ai nuk ka si objekt të zëvendësojë një projekt konkurrues, shumë-shumë mund të konsiderojë konkluzionet si udhëzime me qëllim zhvillimin e një programi të tillë. Për arsye kuptueshmërie, do të bëjmë, megjithatë, një përjashtim të vogël për disa çështje për të cilat *TRI*-ja mbështetet në kritikën e *TPD*-së. Por nuk do të tregojmë apo thjesht nuk do pohojmë se kjo teori do të ketë sukses aty ku *TRI*-ja ka dështuar. Ky problem, përkundrazi, është lënë krejtësisht i hapur. Këtu vetëm do të kemi të bëjmë me ndërtimin e kontekstit të debatit, dhe si rrjedhim, do të tregojmë se ku interpretimi i *TPD*-së kundërshtohet, pasi kjo lejon të kuptohet mirë ndërtimi i projektit realist.

Gjithashtu, do japim edhe strukturën e përgjithshme të *TRI*-së: I) Mënyra se si ajo distancohet nga disa teza të huazuara nga Kelseni; II) Shfaqja e disa vështirësive që detyrojnë të mbash vetëm një version të amenduar nga realizmi; III) së fundi, të tregojë se ky version nuk lejon plotësimin e objektivave të veta.

i janë kushtuar këtij problemi, për shembull: Raphael Paour, "Statusi normativ i jurisprudencës kushtetuese", Aix-Marseille, 2000.

¹⁶ Tezat që përbëjnë *TRI*-në janë në mënyrë të dukshme në qendër të diskutimeve të një numri të madh debatesh filozofike, si dhe të diskutimeve të shumta mbi teorinë e së drejtës. Çështja e interpretimit nuk do të niste seriozisht pa marrë parasysh të dhënat e tij. Objekti i këtij punimi është tepër modest, përderisa bëhet fjalë vetëm për të ngritur projektin e një teorie dhe për të shqyrtuar koherencën e saj. Nuk është, pra, vendi për një diskutim të çëshjeve të nisura tek ajo vetë, kështu që nuk do të japim bibliografi, ku edhe një shembull i thjeshtë do t'i kalonte shumë kufijtë e arsytimit.

I – NDËRTIMI I TEORISË

Edhe pse e cilëson veten si “teoria realiste e interpretimit”, fillimisht ajo është teori e përgjithshme e së drejtës dhe e vendimit, ndërsa teori e interpretimit bëhet në momentin kur këtë koncept ua rezervon veprimeve që nuk janë një analizë semantike, çka ajo e konsideron të pamundur në fushën juridike, por që janë përcaktime të njoftimeve që jepen nga “organet zbatuese”. *TRI*-ja rezulton si një kombinim i rafinuar i tri pozicioneve: *Empirizmi*, i cili ka si përvojë të vetme kriterin e njohjes dhe të një efekti të dukshëm të aktit; *voluntarizmi*, i cili lidh çdo prodhim normativ me përzgjedhjen e një objektivi në fuqi, duke u nisur nga njohja e jashtme; *parimi i përcaktimit*, i cili kërkon që çdo normë të ketë një objektiv të qartë dhe një veprim saktësisht të kufizuar. Si sistem, *TRI*-ja përbën një grup propozimesh ku janë hedhur mendimet bazë. Disa janë dhënë pa prova, si elemente primitive, të tjerë kanë hyrë nëpërmjet rrugës së rrjedhimit. Mirëpo, dallimi mes të dhënave të para dhe propozimeve derivate nuk është bërë gjithmonë në mënyrë të qartë e sistematike. Madje ai ka sjellë, jo rrallë, edhe probleme të koherencës. Para se të tregojmë të gjitha implikimet e teorisë, është mirë të pranojmë fillimisht një ndarje midis këtyre të dhënave. Do të konsiderohen si rrjedhoja ato që e kanë të qartë këtë status, ndërsa të tjerat do të pranohen fillimisht si premisa. Do t’u kthehemi më vonë, kur të flasim mbi të dhënat që kanë si qëllim dallimin qartë të bazave të elementeve derivate.

A – FUSHA E SË DREJTËS

Po ta shohim *TRI*-në në tërësinë e vet, dallojmë se:

- 1) ekziston një realitet empirik i dukshëm (*empirizmi i përgjithshëm*)¹⁷;
- 2) ekzistojnë disa kuptime që shprehen nga fjalë që janë të dhëna gjuhësore të dukshme (*empirizmi semantik*);

¹⁷ Fjalët me kursive shërbejnë vetëm për identifikim të shpejtë të tezave.

3) norma është një “shprehje vullneti”, e cila urdhëron (lejon, ndalon) një grup veprimesh (*voluntarizmi semantiko-normativ*)¹⁸;

4) *Ontologjia e së drejtës*

a) Norma juridike është një normë e caktuar që përligj në mënyrë adekuate në një shoqëri të caktuar¹⁹.

b) Urdhri juridik është një sistem normash juridike, domethënë një sistem përligjjes²⁰.

5) a) Interpretimi është dhënia kuptim një grupi shprehjesh (*teza e interpretimit të efektshëm*).

b) TRI-ja ka të bëjë vetëm me interpretimin e së drejtës (*parimi i specifikës*)²¹.

c) Disa interpretime prodhojnë efekte në rendin juridik (*parimi i efektit interpretativ*). Ky është *interpretimi autentik*.

d) Interpretimi i përdorur nga vëzhgues të rendit juridik, pa patur efekte në këtë rend, është *interpretimi doktrinar*²².

¹⁸ TJE, f.64,82,140:”Duhet pra ... të vijmë në një përkufizim të normës si treguese e një akti ose një fakti”.

¹⁹ TJE, f.174: “Karakterit detyrues ose vlefshmëria nuk është asnjëherë një cilësi objektive e normës, as mënyrë e saj e ekzistencës. As lidhja nuk është objektive, por vetëm një vendosje në lidhje, nga autori i shprehjeve. Nëse kjo lidhje gjykohet adekuate për një shoqëri të caktuar, çka është çështje fakti, vendimi konsiderohet i justifikuar dhe mund të thuhet se ai merr karakterin e një norme. Sistemi juridik atëherë nuk është gjë tjetër veçse një sistem justifikimesh”. Këtë e vëmë ne në dukje.

²⁰ Shih shënimin e mësipërm.

²¹ Kështu gjejmë dallimin mes, nga njëra anë, objektit të TRI-së: përshkrimi i disa qëndrimeve interpretative si fakte dhe, nga ana tjetër, objektit të TCA-së: mënyra me të cilën aktorët justifikojnë strategjitë që kanë huazuar formën e argumentimit, duke e paraqitur si “juridike”.

²² Dallimi ndërmjet “doktrinės” ose “dogmës juridike” dhe “shkencës të së drejtës” është futur në “Shkenca e së drejtës dhe dogmatika juridike”, në TDDE, f.3-18. Shkenca e së drejtës do të ishte objektive, asnjënjë, vërtet funksionale dhe do kishte për objekt qëndrimet e prodhimit të normave prej interpretimit ose kundërshtimet e argumentuara ndaj veprës së

e) Përshkrimi i akteve të interpretimit autentik përbën shkencën e së drejtës.

6) Tekstet normative janë të papërcaktuara (*parimi i mospërcaktimit në tekste*)²³.

7) Një shprehje e parashkruar ka kuptim vetëm atëherë kur është e “përcaktuar” (*parimi i përcaktimit normativ*).²⁴

hartimit të një interpretimi; doktrina ose dogma juridike është një veprim vlerësues me pikësnyime praktike, ajo nuk është asnjëse dhe fjalët që e përbëjnë atë nuk mund të verifikohen ose falsifikohen.

²³ “Një teori realiste e interpretimit”, në Dossiers. Teori realiste e së drejtës, (përmbledhje tekstesh nga Olivier Jouanjan), Presses Universitaires de Strasbourg, 2000, f.54. “Në realitet nuk ka nëpër tekste asnjë kuptim për të zbuluar”, f.55: “Nëse teksti nuk paraekziston dhe interpretimi është veçse një prodhim...”, f.56: “Teksti duhet të ketë gjithmonë një objekt interpretimi, dhe jo vetëm kur ai është i paqartë”. TJE, f.82: “Dhe është e rëndësishme të nënvizohet që çdo tekst, sido që të jetë, sado i qartë që mund të duket, duhet të interpretohet”. F.304 e vazhdim: “Ajo që është objekt i një interpretimi, nuk është norma, por teksti, të cilit kërkohet t’i përcaktohet norma që mund t’i përshtatet. Të thuash që një tekst mund të përmbajë shumë kuptime, do të thotë që ai përmban shumë norma, ndër të cilat organi zbatues duhet të zgjedhë atë që do të zbatohet. Para se të bëhet kjo përzgjedhje, nuk ka norma për t’u zbatuar, por ka vetëm një tekst.”

Kjo tezë, krejtësisht thelbësore për ndërtimin e teorisë nxjerr në pah çështjet më të vështira të filozofisë së gjuhës. Është e domosdoshme të theksojmë se ky pohim nuk është diskutuar asnjëherë seriozisht nga TRI-ja, në kuptimin e kërkimit filozofik bashkëkohor. Shih: Crispin Wright, *Realism, Meaning and truth*, Bot. i dytë, Oxford University Press, 1993; Scott Soames, “Skepticism about Meaning: Indeterminacy, Normativity, and the Rule-Following Paradox”, në Ali Kazmi (botues), *Meaning and reference: Supplementary*, vëll.23, *Canadian Journal of Philosophy*, 1998, f.211-249; mbi teorinë e së drejtës: Michael Thaler, *Mehrdeutigkeit und juristische Auslegung. Forschungen aus Staat und Recht*, vëll.59, Vjenë – Nju Jork, 1982; Ken Kress, “Legal Indeterminacy”, në *California Law Review*, 1989, f.283; Brian Bix, *Law, Language, and Legal Determinacy*, Oxford University Press, 1993; Jules Coleman, Brian Leiter, “Determinacy, Objectivity, and Authority”, në Andrei Marmor (bot.), *Law and Interpretation*, Oxford University Press, 1995, f.203-278; Timothy Endicott, *Vagueness in Law*, Oxford University Press, 2000.

²⁴ Shih: TJE, f.305: “...Para se të bëhet kjo përzgjedhje nuk ka norma për t’u zbatuar, por veçse tekst”. (Bëhet zgjedhja e një kuptimi).

8) a) Doktrina nuk mund të interpretojë tekstet normative “juridike”.

b) Nuk ekziston interpretimi doktrinal (*skepticizmi doktrinar*).

9) a) Interpretimi është një akt vullneti (dhe jo akt njohurie) (*voluntarizmi interpretativ*)²⁵.

b) Çdo interpretim është i vlerësueshëm.

c) Normat rezultojnë ekskluzivisht të interpretimit (autentike) (*realizmi interpretativ*).

10) “Organet zbatuese” më të larta përcaktojnë përfundimisht kuptimin e teksteve të ligjeve (*parimi i interpretimit autentik organik*)²⁶.

11) Vendimet e dhëna nga organet më të larta u imponohen atyre që u adresohen (*efikasiteti vendimtar*)²⁷.

12) Normat janë fakte (*thjeshhtëzimi i përpiktë*).

13) E drejta dhe politika (strukturat e pushtetit) janë rreptësisht identike.

Me qëllim që të kuptohet mirë funksioni i brendshëm, është mirë të rishikohen këto elemente të ndryshme në perspektivën e TRI-së.

Si empirizmi i përgjithshëm, ashtu edhe ai semantik, përbëjnë bazat e teorisë së pranimit pa argumenta. Empirizmi i përgjithshëm nuk është as i zhvilluar, as i specifikuar nga ana metodologjike; nëse raportohen ngjarjet, paraqitja e tyre nuk bëhet problematike. Kemi të bëjmë me një teori empiriste,

²⁵ TJE, f.99: “Kështu, dhe shumë autorë kanë treguar këtë, interpretimi nuk është akt njohje, por vullneti”.

²⁶ TJE, f.90. “Por ama duhet konsideruar si autentik vetëm ai interpretim i dhënë nga gjykata e instancës më të fundit, pasi ajo është krijuesja e një norme të përgjithshme, që është domethënia e ligjit që duhet zbatuar.”

²⁷ P.sh.: “Një teori realiste interpretimi”, op. i cituar, f.53: “Efekti i interpretimit autentik është se ai imponohet, sido që të jetë përmbajtja e tij”, TJE, f.90: “Kjo është aq e vërtetë, sa gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe subjektet juridike pajtohen me to, duke rrezikuar të parat anulimin e vendimeve të marra dhe të dytat sanksionimin e qëndrimeve të tyre”. “Kjo normë e përgjithshme [interpretimi që jepet nga gjykata më e lartë] është e detyrueshme për gjykatat e ulëta dhe për individë ose autoritete që i nënshtrohen juridiksionit të asaj gjykate.”

e cila nuk jep asnjë udhëzim lidhur me identifikimin konkret të të dhënave të asaj përvoje. Kështu, të paktën përkohësisht, do të pranohet se ngjarjet janë treguar sipas metodave të përshtatjes. Ky empirizëm lidhet mjaft lehtë me pozicionin e realizmit shkencor në filozofi, por vetëm në këtë kuptim *TRI*-ja përbën efektivisht realizëm në kuptimin filozofik të fjalës.

Empirizmi semantik, gjithashtu, është pranuar si i tillë. Edhe për të nuk është saktësuar se cila është teoria me të cilën lidhet. Të paktën duhen pranuar se ekzistojnë të dhëna me natyrë gjuhësore, të cilat mund të vëzhgohen. Dhe, gjithashtu duhet të pranohet se është e mundur t’i jepet një domethënie këtyre të dhënave, pa i dhënë rëndësi faktit se si mund të arrihet aty. Identifikimi si objekt gjuhësor duhet të bëhet në mënyrë të pavarur nga ai kuptimor, por nëse ekzistojnë objekte të tilla, sigurisht që ato e kanë një kuptim. Bashkë me *TRI*-në, duhet të pranohet, gjithashtu, edhe se për një numër të caktuar formulimesh, kuptimi është i papërcaktuar dhe për disa të tjera ai nuk jepet ose jepet i përgjysmuar. Rezulton se mund të jetë e mundur të njehsohen këto *kuptime-për-sa-kohë-ato-kanë-një-shkallë-të-caktuar-përkufizimi*.

Voluntarizmi normativ rrjedh nga empirizmi i përgjithshëm. Një normë, kur ajo ekziston, nuk është gjë tjetër veçse një fakt mes të gjithë atyre fakteve të drejta, të cilat *TRI*-ja, në rrymën e *TPD*-ja i quan “akte të vullnetit”. Mirëpo, se në çfarë konsistojnë këto akte me saktësi, kjo nuk është shpjegur kurrë, as për njërin, as për tjetrën teori.²⁸ Pa dyshim, që duhet të pranojmë se “vullneti” çon në të dhëna psikologjike të atilla, që disa akte mendore të kenë për objektiv realizimin e disa veprimeve dhe, atëherë mund të thuhej se ajo që shpreh këtë gjendje mendore është një “normë”. Si rrjedhim, ekziston një koncept jashtëgjuhësor i “normës” pranë atij gjuhësor që është dhënë në pikën (3). Në raport me *TPD*-në, *TRI*-ja ka përparësinë e dukshme që lidh

²⁸ Otto, Pfersmann, “Statuti i vullnetit në përcaktimin pozitivist të normës juridike”, në *Droit*, 28 (1999), f.83-98.

shumë qartë normën me të dhënat gjuhësore sesa me ato psikologjike.²⁹ Nuk dihen me saktësi raportet mes këtyre dy të dhënave. Dhe, gjithashtu, nuk dihet as edhe si përcaktohen me saktësi dukuritë gjuhësore domethënia e të cilave do të ishte që disa veprime janë të detyruara, të lejuara ose të ndaluara. Nëse pranohet “semantizmi”, kjo do të thotë që për çdo formulim E, duke u nisur nga metodat e duhura (për të cilat ne nuk dimë asgjë, por që ne i pranojmë megjithatë për nevojat e çështjes), ne mund të themi, ose: E është një normë, ose: E nuk është normë.

Edhe pse nuk e dimë me saktësi *cila* është kjo normë, ne dimë që ajo është ose nuk është norma. Pra, është gjithmonë e mundur të thuhet ku konsiston ai aspekt i kuptimit të një formulimi të caktuar.

Për ta thjeshtuar pak këtë, marrim aktin e përcaktimit të kuptimit të një grupi formulimesh mbi “interpretimin” (4). Nga njëra anë, bëhet fjalë për përkufizim; një kategori aktesh është e pajisur me një emër. Kjo nuk thotë asgjë për natyrën e këtij akti. TRI-ja atëherë është, ashtu siç e tregon edhe emir, një teori, objekti i së cilës është të përcaktojë këtë natyrë. Mirëpo, pa pretenduar të raportojë për fusha të tjera, ajo i përket vetëm fushës të së drejtës, gjë e cila kërkon futjen e parimit të specifikes.

Nga ana tjetër, bëhet fjalë për një element të *teorisë të të kuptuarit*. Ajo që ka rëndësi këtu është, sipas këtij koncepti, kuptimi i *rezultatit të një akti* dhe jo një e dhënë e parë dhe e shfrytëzueshme drejtpërsëdrejti me metodat e duhura. Ajo duhet të përcaktohet në kuptimin se ku një ngjarje mund të

²⁹ Fillimisht Kelsen e pati kritikuar ashpër psikologjizmin në përcaktimin e normës (shih O. Pfersmann, op. i cit.), por nëse vullneti nuk ishte një e dhënë psikologjike në Teorinë e pastër të së drejtës, teoria do të shembej, sepse bëhej fjalë fare mirë për të identifikuar domethënien e disa akteve (për shembull, fakti që disa persona ulen në parlament si konstitutivë për miratimin e një ligji), pra të dukurive empirike. Sigurisht që do të jetë tepër e vështirë të shpjegohet me saktësi nëse konsiston vullneti për secilin rast, por gjithnjë bëhet fjalë për akte të vullnetit në kuptimin psikologjik të fjalës, me një domethënie që i tejkalon të dhënat psikologjike.

ndërhyjë për të prodhuar një ndryshim në konstituimin e një objekti. Si në kuptimin logjik, ashtu edhe në atë kohor, ka një *para* dhe *pas*, ka objekt *O pa* dhe objekt *O me* një kuptim. Ky objekt pa kuptim të veçantë quhet nga *TRI*-ja “ligj”. Ky aspekt i semantikës së *TRI*-së do të cilësohet këtu si “teza e interpretimit eficient”, me qëllim që të theksohet se kuptimi përbën fare mirë *efektin e një akti*.

Si rrjedhim, elementi thelbësor i paraqitjes së kësaj hipoteze konsiston në përcaktimin e natyrës së interpretimit. Po quajmë “tekst” një grup të çfarëdoshëm formulimesh, me një përmbajtje të çfarëdoshme. Sipas parimit të mospërcaktimit fjalë për fjalë, çdo tekst është i papërcaktuar, domethënë që ai, *si i tillë*, nuk zotëron asnjë domethënie. Në favor të kësaj mund të lindin arsye nga më të ndryshme. Në radhë të parë, ai që përbën një fakt në një rend juridik është gjithmonë ai akt, i cili, duke u nisur nga teksti, bën zgjedhjen e kuptimit. Para kësaj zgjedhjeje nuk ekzistonte asnjë kuptim. Në radhë të dytë, nuk është e mundur kurrë të gjesh qëllimin e atij që do të ketë bërë tekstin, sepse për këtë do duhej të njihej gjendja mendore e të gjithë atyre që kanë kontribuar në hartimin e tij, gjë e cila nxjerr vështirësi praktikisht të pazgjidhshme, me një rezultat që do të ishte inkohorent, pavarësisht nga ndërhyrjet. Pra, midis kuptimeve të ndryshme që mund të gjendeshin jashtë qëllimit, do duhej gjithmonë të veprohej për një zgjedhje që nuk është dhënë në vetë tekstin.

Sipas parimit të mospërcaktimit të tekstit, asnjë ushtrim shkencor, sado i rafinuar qoftë ai, nuk mund ta heqë tekstin. Madje dy arsye më shumë mund ta lejojnë hartimin e tij. E para vjen si rezultat i përkufizimit të vetë interpretimit në fushën e së drejtës. Një përpjekje e tillë, në fakt, nuk do kishte asnjë efekt në rendin juridik. Por, së dyti, ajo është e pamundur, sipas vetë kritereve shkencore: interpretimi doktrinar do të përballet gjithmonë me mospërcaktimin e tekstit pa qenë e mundur gjetja tek vetë ai e arsyeve që do t’i lejonin të vendoste në favor të njëres zgjedhje. Pikërisht kjo zgjedhje është veçori e interpretimit me efekt në rendin juridik, domethënë e interpretimit autentik.

Parimi i mospërcaktimit është, si rrjedhojë, ekuivalent i skepticizmit doktrinar.

Po të shohim një normë, ajo duhet të jetë gjithmonë e përcaktuar, domethënë ajo duhet të thotë se në çfarë konsistojnë gjithë aktet e detyrueshme, të lejuara ose të ndaluara. Dhe është kjo që dallon ligjin nga norma: ligji është gjithmonë i papërcaktuar, norma është e përcaktuar, të paktën në kuptimin që ajo do të ketë "... efekte në rendin juridik"³⁰. Pra, meqenëse interpretimi si përcaktim nuk mund të jetë rezultat i një akti njohjeje, ai do të jetë rezultat i vullnetit, i cili krijon edhe voluntarizmin normativ. Dhe, nëse çdo interpretim konsiston në efektin e vullnetit, i cili, nga ana e vet ka të bëjë me zgjedhjen e vetëm njëres preferencë mes shumë alternativash, mund të themi gjithashtu se "çdo interpretim kërkon një vlerësim".

Kur themi se interpretimi është rezultat i aktit të vullnetit, atëherë ata, të cilëve u vishet ai, do të quhen "organe". *TRI*-ja i cilëson në mënyrë më specifike si "organe zbatuese", në kuptimin që aktet e dekretuara prej tyre i japin kuptim një ligji deri tani të papërcaktuar. Që nga ky moment zbatimi i ligjit është efektivisht prodhimi i vërtetë i normës, domethënë i përcaktimit të kuptimit normativ. Mirëpo, jo të gjitha organet kanë të njëjtin status. Disa e zgjidhin përfundimisht një çështje, të tjerat jo. Interpretimi është organik (ose autentik), sepse janë organet (zbatuese) ato të cilat përcaktojnë domethënien e ligjit, por janë vetëm organet e larta ato që japin një përcaktim strikt, për derisa përzgjedhja që ato bëjnë është, si rregull, e pakontestueshme. Kjo pikërisht është arsyeja për të cilën këta interpretues imponohen, ndërsa ato janë akte që prodhojnë efekte në rendin juridik dhe kjo bëhet në mënyrë përfundimtare.

³⁰ "Një teori realiste e interpretimit", f.53.

B – SHTOJCA SKEPTIKE

Pasojat e TRI-së prekin të gjitha fushat që i interesojnë një juristi dhe e detyrojnë atë të rimarrë plotësisht në konsideratë natyrën e objekteve të tij: 1) rendin juridik; 2) doktrinën; 3) teorinë e së drejtës.

1 – Faktualiteti i rendit juridik

Po të pranohet se, për nevojat e çështjes, mund të demonstrohen elemente thelbësore të TRI-së, po kështu edhe mund të shmangen disa propozime që partizanëve të koncepteve të tjera do t'u dukeshin tepër të çuditshme. Parimi i mospërcaktimit fare lehtë pranon të provosh se Kushtetuta (ligji i cili mban këtë emër ose një të përafërt me të në një rend juridik të caktuar) nuk mund të konstitujë një normë (ose grup normash), pasi nuk bëhet fjalë saktësisht për një ligj. Ose pastaj, duhet të konsiderojmë që kjo Kushtetutë nuk është kushtetutë (normë ose grup normash). Kjo rezulton në fakt nga *interpretimi* i tekstit “Kushtetutë” dhe se çdo interpretim është organik.³¹ Ashtu si mund të ketë shumë organe të larta, mund të quhet eventualisht “kushtetutë” sistemi i formuar nga këto organe.³² Gjithashtu, rezulton se hierarkia e normave, siç jemi mësuar ta dëgjojmë shpesh, ashtu si një piramidë ku kushtetuta është në majë dhe aktet që ajo rregullon janë në katet më poshtë, është një iluzion i qartë. Në fakt nuk mund të ketë hierarki ndërmjet *ligjeve*, por vetëm ndërmjet normave, dhe normat rezultojnë si akte të interpretimit organik. Që këtë rrjedh se nuk ekziston hierarki normash përveçse si të përcaktuara brenda dhe prej interpretimit.³³ Ai është refleksi i hierarkisë së pushteteve.³⁴

³¹ TJE, f. 305.

³² TJE, f. 306. Kushtetuta “.nuk është një trup rregullash; ajo është një “organizim”, një sistem organesh”.

³³ “Një teori realiste e interpretimit”, f. 63.

³⁴ “Një teori realiste e interpretimit”, vep.e cit.f. 63: “Me fjalë të tjera, sipas teorisë realiste, hierarkia e normave reflekton atë të pushteteve”.

Meqenëse ligjet janë të papërcaktuara dhe kuptimi normativ rezulton vetëm nga interpretimi organik i tyre, si dhe meqë interpretimi, për shkak të normës paraprake nuk mund të jetë *i lidhur*, rrjedh, në një mënyrë *banale*, që interpretimi është një akt juridikisht i lirë, i cili mund të marrë çfarëdolloj përmbajtjeje. Nuk ekziston asnjë lidhje mes mospërcaktimit të ligjit dhe përcaktimit interpretativ, i cili nuk është fare i përfshirë në një grup zgjidhjesh të mundshme. E drejta nuk mund ta kundërshtojë interpretimin, meqenëse është vetë interpretimi ai që bën normën dhe, si rrjedhim pra, edhe të drejtën. Të vetmet kufizime që rëndojnë mbi pushtetin e interpretimit janë ato që rëndojnë mbi çdo pushtet: ato janë detyrimet faktike të ushtruara nga pushtetet e tjera.³⁵ Dhe nëse interpretuesi është juridikisht i lirë, në kuptimin që nuk ekziston *asnjë* normë që do të mund t'i impononte atij një përzgjedhje mes shumë zgjidhjesh të pranueshme para aktit të interpretimit, nga kjo rrjedh që interpretuesi nuk përcakton vetëm normën, por në të njëjtën kohë ai krijon atë që i jep atij kompetencën të procedojë me interpretimin që ai adopton. Liria e interpretuesit nuk vjen si rezultat i shkathtësisë që të jep një kompetencë, por përkundrazi, vetë akti i interpretimit është konstituim i kompetencës dhe i ushtrimit të saj.

Pra, me sa duket ndodhemi në një univers normash. Por pasoja më e çuditshme dhe më radikale bie pikërisht mbi statusin modal të vetë normës. TPD-ja u përpoq shumë për të nxjerrë të gjitha pasojat e dallimit midis faktikes e normative dhe pamundësinë e një prejardhjeje thëniesh të natyrës parashkruese, nisur vetëm nga thënie përshkruese dhe anasjelltas. Mirëpo

³⁵ Ndodh që vetë interpretuesit të shtrengohen kur miratojnë disa arsyetime ose kur përdorin në një farë mënyre format juridike. Studimi i këtyre dukurive nuk është më kompetencë e TRI-së, e cila harton vetëm lirinë juridike të interpretuesit dhe jo mekanizmat faktikë të brendshëm të prodhimit të akteve normative ose të qëndrimeve juridikisht të përshtatshme (si për shembull, një dorëheqje), dhe as mënyrën me të cilën këto mekanizma kufizojnë mundësitë për zgjedhje të aktorëve. Ky studim vjen nga TCA-ja (shih shën.13).

kushtetuta dhe zbatimi i saj janë një fakt, edhe akti i interpretimit është i tillë, gjithashtu. E drejta nuk ka *asgjë* tjetër: ajo është grumbulli i fakteve, konstituimi i të cilave bëhet nëpërmjet akteve interpretuese të atyre që ushtrojnë *kështu* një pushtet.

2 – Natyra empirike e shkencës të së drejtës

Po të pranohet arsyetimi i *TRI*-së, pasojat që rrjedhin prej tij lidhur me një njohje shkencore të së drejtës janë një tmerr: ajo nuk ekziston fare. Ose nuk është një shkencë, ose nuk ka të bëjë me të drejtën.

Duhet të kombinohet empirizmi me parimin e përcaktimit. Shkencërisht mund të përshkruhet vetëm ajo që është dhënë nga përvoja, dhe vetëm ajo që është përcaktuar apo vendosur mund të konstitujë objektin e përvojës; ajo që nuk është e përcaktuar mund të jetë objekt vetëm i një zgjedhjeje përcaktuese, domethënë i një vlerësimi. Rezultati i vlerësimit mund të analizohet, vlerësimi vetë nuk rezulton si një akt njohjeje, por si akt vullneti.³⁶

Ajo që *TRI*-ja e cilëson si “dogmatikë juridike” ose “interpretim doktrinar” është pasojë e një përzgjedhjeje vlerësuese pa vlera normative objektivist

³⁶ “Kështu, ose shkenca e së drejtës së Kelsenit përmban vlerësime dhe nuk është shkencë ose ajo është shkencë, por jo një shkencë juridike” (TDDE, f.7). Këtu nuk do shqyrtojmë nëse kjo fjali karakterizon efektivistisht pozicionin e Kelsenit. Le ta lëmë thjesht si një dyshim. Përkundrazi, ajo na duket se cilëson shumë mirë konceptin e *TRI*-së në versionin e saj radikal. Në fakt, një shkencë nuk mund të përmbajë vlerësime dhe, sipas *TRI*-së, çdo interpretim doktrinar përmban vlerësime. Por gjithçka varet nëse është e mundur të njësohen kriteret e veçantisë së interpretimeve autentike në raport me qëndrimet e tjera, të cilat kanë për qëllim marrjen ose mbajtjen e një pushteti pa iu drejtuar elementeve semantike. Nëse nuk ka mundësi, siç do të mundohemi ta tregojmë më poshtë, (II), versioni radikal imponohet. Po të pranohet se do të jetë e mundur të njësohen “normat juridike të vlefshme” sipas *TRI*-së, dhe kjo të bëhet pa qenë nevoja të jepen vlerësime, atëherë mund të parashikojmë një shkencë të interpretimeve autentike. Pozicioni i *TRI*-së është trajtuar veçanërisht në “Shkenca e të drejtës dhe dogmatika juridike” (Science du droit et dogmatique juridique), në TDDE, f.3-18.

juridike. Por më shumë se rezultat i një vlerësimi përzgjedhës, ajo është shprehje parapëlqimesh subjektive të interpretimit doktrinar. Nëse zgjedhje të tilla subjektive bëhen të pranishme, si të bëhej fjalë për të dhëna objektive të hartuara shkencërisht, atëherë do kemi të bëjmë me një ideologji. Kështu, autorët e doktrinës pretendojnë të japin fare mirë një imazh objektiv të së drejtës, pra ata prodhojnë një ligjërim ideologjik.

Ky konkluzion mund të kuptohet në dy mënyra. Në një farë mënyre mund të themi që ky ose ai autor nuk kënaqet së përshkruari shkencërisht të drejtën, por përfshin edhe parapëlqime subjektive në një ligjëratë të paraqitur si objektive. Në këtë rast do të cilësoheshin si ideologjike ato fjalime ku mbahet një qëndrim i tillë dhe kritika do të përpiquej të njësonte rrethana të tilla. Por, gjithashtu, mund të shkohej edhe më larg dhe të pohohej se çdo përpjekje për një paraqitje objektive të së drejtës, jashtë përshkrimit empirik të interpretimeve autentike, është qenësisht ideologjike. Kjo është teza e *TRI*-së, e cila del nga karakteri qenësisht vlerësues i interpretimit.

Asnjë doktrinë ose dogmë nuk mund të ekzistojë, pra si shkencë, sepse ajo çfarë ekziston me këtë emër nuk është veçse një fjalim mbi ligjet, që, edhe pse mund të përdorë çfarëdo mënyrash, nuk mund t'ua heqë atyre dykuptimësinë. Duke mos pasur asnjë efekt në rendin juridik, ajo s'është gjë tjetër veçse një iluzion i përcaktimit të kuptimit. Disiplina që kërkon të marrë emrin "shkencë", apo edhe ndonjë emër më pak ambicioz (padyshim më të djallëzuar) si "doktrinë" ose thjesht "e drejtë" si metonimi të objektit të një pune analize, është vetëm një veprim politik, i cili synon të marrë një status organik me mënyra të tjera që janë mashtrimet intelektuale.

Nuk mund të ketë, gjithashtu, shkencë të së drejtës që analizon sistemet e normave, ashtu si thotë *TPD*-ja, përderisa normat janë fakte dhe analiza e tyre del si rrjedhojë e shkencave empirike *stricto sensu*. *TRI*-ja nuk është vetëm një teori skeptike, në kuptimin që kërkon të provojë kotësinë e një ndërmarrjeje shkencore ose më thjesht përshkruese, por ajo është edhe teori kritike e ideologjive, e cila demaskon natyrën e vërtetë ose të

rreme të çdo analize e të çdo prezantimi të së drejtës pozitive.

Përsëri shohim se kemi dy pasoja. E para lidhet me problemet e shkencës së të drejtës. Meqenëse nuk mund të ketë shkencë të së drejtës në kuptimin që do jetë e mundur të interpretohen (në mënyrë joautentike) shprehjet normative juridike, është e qartë se nuk mund të zgjidhen problemet e së drejtës, domethënë nuk mund t'u përgjigjesh pyetjeve të tipit: “Nëse një ngjarje ndodh, cili veprim është i detyrueshëm, i lejueshëm ose i ndaluar në kuadrin e sistemit juridik të konsideruar?” Çdo përgjigje dhënë pyetjes së këtij lloji është ose një gënjeshtër, ose një hipotezë empirike false, që ka të bëjë me aktin e interpretimit të rastit.

Pasoja e dytë lidhet me natyrën e shkencës së të drejtës – në kuptimin e *TRI-së*: ajo nuk mund të jetë veçse një shkencë pikë për pikë empirike që mund të ketë për objekt vetëm aktet e interpretimit si elemente të strukturës së pushtetit. Rrjedh pra, që shkenca e së drejtës në kuptimin e *TRI-së* nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një degë e shkencës politike, sigurisht për aq sa vetë shkenca politike merret si shkencë pikë për pike empirike.³⁷

Si rrjedhim, shkenca e së drejtës në kuptimin e *TRI-së* nuk është një shkencë e së drejtës, nëse me këtë kuptojmë shkencën e ligjeve përshkruese në kuptimin e *TRI-së*. Sipas një varianti më radikal, nuk do të ekzistojë, pra, asnjë shkencë e së drejtës në kuptimin e *TRI-së*, përderisa ajo njeh vetëm një shkencë empirike të të dhënave sociale. Sipas një varianti tjetër, më konstruktiv, shkenca e së drejtës në kuptimin e *TRI-së* do të ishte ajo e interpretimeve autentike si ngjarje të vëzhgueshme në mënyrë empirike.

³⁷ Për shembull, TJE, f.314: “...ndarja e shkencës të së drejtës kushtetuese dhe sociologjisë politike nuk justifikohet më në qoftë se kushtetuta është bërë. “Shkenca e të drejtës “trajton normat si fakt empirik”. Sipas një koncepti, atribuar pjesërisht Kelsenit, përshkrimi i këtyre fakteve empirike është një shkencë sociale si të tjerat, ajo nuk ka objekt të veçantë dhe nuk është, pra, një shkencë e së drejtës: “Kështu, ose shkenca e së drejtës e Kelsenit përmban vlerësime dhe nuk është shkencë, ose ajo është shkencë, por jo shkencë juridike” (TDDE, f.7).

Sipas një varianti të tretë, mund të kemi të bëjmë me atë shkencë që është në zbatim atëherë kur një interpretues autentik justifikon zgjedhjen, duke huazuar formën e “arsyetimit juridik”. Ky veprim i fundit është objekt i *TCA*-së dhe jo më i *TRI*-së së mirëfilltë.

Në qoftë se ka shkenca vetëm për ngjarjet e vëzhgueshme në mënyrë empirike, problemi i vetëm do të jetë identifikimi i atyre që cilësohen juridikisht krejt të përshtatshme. Nëse kjo gjë është e mundur, do të mund të zhvillohet shkenca e interpretimeve autentike, nëse është e pamundur, atëherë do të ekzistojë vetëm shkenca e raporteve të pushtetit.³⁸

³⁸ TJE, f.315: “Atëherë i takon shkencës kushtetuese, që të mos përshkruajë të ashtuquajturat norma kushtetuese, as edhe të vërejë shkeljet e tyre, por të vërë në dukje strukturën e sistemit dhe të shpjegojë shkaqet e transformimeve të tij”.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën maj 2004

Përgatiti: Alma Kondakçiu

1. Projektligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”

Ky projektligj synon të realizojë decentralizimin e administrimit dhe të manaxhimit të strehimit, duke u dhënë organeve të qeverisjes vendore disa kompetenca në fushën e strehimit, si dhe të krijojë mundësinë për hartimin e programeve sociale të strehimit. Projektligji mbështetet në tri tipe programesh sociale të strehimit, që janë programet e banesave sociale me qira, programet e banesave me kosto të ulët dhe programet e pajisjes së tokës me infrastrukturë dhe përcakton procedurat për secilin program. Në të parashikohen edhe rastet e subvencionimit të qirasë ose të interesave të kredive nga shteti.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, deputetët e miratuan atë në parim, duke theksuar se miratimi i një ligji të tillë i hap rrugën Qeverisë dhe organeve të pushtetit vendor që, në varësi të burimeve financiare, të ndërmarrin hapa për zbutjen graduale të problemit të strehimit, i cili është bërë shqetësues, veçanërisht në qytete, ku ka përqendrim më të madh të popullsisë.

Deputetët shfaqën mendime për ndryshimin ose riformulimin e disa neneve të projektligjit, për ta përmirësuar përmbajtjen e tij.

Një nga nenet që u debatua është neni 25 i projektligjit, i cili bën fjalë për subvencionimin nga shteti të interesave të kredive. Sipas projektligjit, familjet

që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese, nga një institucion financiar që ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave. Kushtet e dhënies së kredisë nga bankat përcaktohen nga Ministria e Financave, ministria që mbulon fushën e strehimit dhe institucioni që jep dhe manaxhon kredinë.

Disa deputetë shprehën mendimin se kushtet e dhënies së kredisë duhet t'i përcaktojë institucioni që ka dhënë kredinë, pra banka, jo Ministria e Financave. Disa deputetë të tjerë u shprehën që të drejtën e marrjes së kredisë në bankë duhet ta ketë personi i interesuar dhe jo shteti. Sipas tyre, në bazë të kontratës që personi i interesuar lidh me bankën kur merr kredinë, shteti duhet të subvencionojë interesat e kredisë.

Kundërshtuesit e këtij mendimi theksuan se shteti subvencionon interesat e kredive për një pjesë të familjeve, jo për të gjitha, prandaj procedura e dhënies së kredisë nuk mund të jetë direkte, bankë me familje. Për këtë shteti harton programe sociale, duke i dhënë të drejtë Ministrisë së Financave të lidhë marrëveshje me bankat për të marrë kredi, të cilën do ta përdorë për programet sociale të strehimit. Për këtë arsye, theksuan ata, kushtet e dhënies së kredisë përcaktohen nga Ministria e Financave, në marrëveshje me ministrinë që mbulon fushën e strehimit dhe me bankën.

Me këto argumente, Kuvendi miratoi formulimin e projektligjit për këtë çështje.

Një çështje tjetër, për të cilën u debatua ka të bëjë me nenin 30 të projektligjit, i cili parashikon burimet e financimit të programeve sociale të strehimit. Disa deputetë ngritën shqetësimin se në këtë nen nuk është parashikuar si burim financimi kredia që shteti ka të drejtë të marrë në banka, e cila, sipas tyre e bën ligjin deklarativ dhe të pazbatueshëm. Ky mendim u kundërshtua nga specialistët dhe u mbështet nga shumica e deputetëve, të cilët u shprehën se ky burim financimi është përfshirë në pikën "b" të këtij neni.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi formulimin e projektligjit për këtë çështje.

Kuvendi miratoi ndryshimin e nenit të 20 të projektligjit, i cili vendos disa kufizime ndaj familjeve që kanë përfituar banesë me kosto të ulët. Sipas projektligjit, familja që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer atë me pagesë të menjëhershme, duke u bërë pronare e saj, detyrohet të mos e shesë banesën për një periudhë 10-vjeçare. Ndryshimi konsiston në afatin, brenda të cilit familja nuk lejohet ta shesë banesën, i cili nga 10 vjet bëhet 15 vjet dhe në kushtin që pagesa të jetë shlyer, jo domosdoshmërisht në mënyrë të menjëhershme.

Kuvendi miratoi edhe një sërë ndryshimesh të tjera në formulimin e neneve të projektligjit.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës”

Projektligji parashikon ratifikimin nga Kuvendi të dy marrëveshjeve koncesionare midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Shoqërisë Italiane “La Petrolifera Italo Rumena SPA”. Marrëveshja e koncesionit e formës “BOO” ka si objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, ndërsa marrëveshja e koncesionit e formës “BOT” ka si objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të këtij terminali bregdetar. Afati i koncesionit parashikohet të jetë 30 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, disa komisione të përhershme të Kuvendit, u shprehën në parim dakord me miratimin e tij. Sipas tyre, ratifikimi i këtyre marrëveshjeve do të sjellë rritje të konkurrencës dhe ulje të çmimit të naftës dhe të gazit të lëngshëm në treg dhe do ta shndërrojë Vlorën në një nyje të

rëndësishme energjetike rajonale. Gjithashtu, ata vlerësuan efektet pozitive të këtyre marrëveshjeve në uljen dhe minimizimin e faktorëve ndotës të mjedisit.

Krahas vlerësimit të mësipërm, për këtë projektligj pati edhe një vlerësim tjetër nga Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, ku deputetët ngritën shqetësimin se disa formulime në tekstin e marrëveshjes lenë shkas për keqkuptime dhe cenim të parimeve të konkurrencës së lirë.

Kështu, në nenin 8 të Marrëveshjes thuhet që terminali dhe zona e koncesionit portual të jetë i vetmi terminal dhe e vetmja infrastrukturë portuale për depozitim dhe transportimin (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) e naftës, produkteve të naftës, produkteve të gazeve të lëngshëm dhe të produkteve të tjera të lëngshme në Gjirin e Vlorës, si dhe një sërë të drejtash të tjera ekskluzive për përdorimin e infrastrukturës ekzistuese, duke kushtëzuar që të mos ndërtohet asnjë infrastrukturë e re tjetër, përveç asaj që do të ndërtohet nga koncesionari. Gjithashtu, koncesionarit i bëhen një sërë lehtësirash fiskale.

Komisioni i Ekonomisë kërkoi nga përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave që, së bashku me koncesionarin, të korrigjojnë marrëveshjen, duke hequr nga teksti i saj të drejtën ekskluzive të koncesionarit për transportin e naftës dhe të nënprodukteve të saj dhe duke i ndaluar atij veprimtarinë e tregtimit të karburanteve.

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të ndryshimeve të mësipërme në tekstin e marrëveshjes, Komisioni i Ekonomisë e miratoi projektligjin për të kaluar në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare deputetët e opozitës e kundërshtuan atë, për shkak të së drejtës ekskluzive që i jepet një subjekti të vetëm për këtë objekt koncesioni, ndërkohë që, sipas tyre, për të kanë shprehur interes edhe subjekte të tjera. Kjo e drejtë, sipas tyre, dëmton konkurrencën e lirë në treg.

Deputetët e maxhoranës e kundërshtuan këtë qëndrim të opozitës, duke

vlerësuar Shoqërinë Italiane “La Petrolifera Italo Rumena SPA” si një kompani prestigjioze dhe me reputacion ndërkombëtar në këtë fushë. Ata theksuan se Këshilli i Ministrave ka dërguar zyrtarisht tekstin e marrëveshjes të korigjuar sipas propozimeve të Komisionit të Ekonomisë.

Në përfundim, deputetët e opozitës u larguan nga salla dhe projektligji u miratua, duke përfshirë ndryshimet në tekstin e marrëveshjes, sipas propozimeve të Komisionit të Ekonomisë.

Raport i Këshillit të Ministrave për Shërbimin Civil 2003

Në Raport theksohet se gjatë vitit 2003 është forcuar dhe përmirësuar puna për zbatimin e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, si dhe është përmirësuar manaxhimi i shërbimit civil. Gjatë këtij viti janë bërë disa përmirësime në aktet ligjore ekzistuese, plotësime të bazës ligjore në disa fusha të parregulluara më parë dhe është shtrirë fusha e veprimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e tjera të administratës publike. Më tej, Raporti ndalet në zbatimin e ligjit nr.8549 dhe theksohet se ka përmirësime në procedurat e pranimit në shërbimin civil, gjë që duket në faktin e uljes së numrit të ankimeve ndaj procedurave të konkurimit, si dhe në uljen e procedurave të ankimit të anuluar. Më tej, vihen në dukje disa dobësi në procesin e pranimit në punë. Në analizën që i bëhet reformës në fushën e pagave vihet në dukje zbatimi i sistemit të ri të pagave për disa kategori të nëpunësve dhe rishikimi i sistemit të pagave në disa sisteme prioritare. Nga analiza e sistemit aktual të pagave, rezulton se ka disa mangësi në procedurat ligjore për caktimin e pagave të institucioneve të pavarura, ku kompetenca për caktimin e tyre është e shpërndarë në disa institucione ose përcaktohet në ligjin e organizimit dhe funksionimit të tyre. Në përfundim, Raporti pasqyron rezultatet e punës së Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

Gjatë diskutimit për Raportin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, deputetët e maxhorancës e vlerësuan atë dhe e konsideruan zbatimin e ligjit “Për

statusin e nëpunësit civil” të suksesshëm”. Ata theksuan se shtrirja e fushës së veprimit të rregullave të manaxhimit të shërbimit civil në sistemin e rekrutimit ka sjellë rritjen e transparencës së procedurave, shpejtimin dhe lehtësimin e tyre, uljen e mundësisë së subjektivizmit në të gjitha hallkat e përzgjedhjes. Ata përmendën edhe drejtimit kryesore ku do të përqëndrohet puna në të ardhmen si rritja e profesionalizmit të nëpunësve, nëpërmjet zbatimit të drejtë të kriterëve ligjore, përmirësimi i procesit të konkurimit dhe vendosja e tij mbi baza transparente, profesionale e të merituar, rritja e qëndrueshmërisë së administratës, përsosja e sistemit të trajnimit dhe vlerësimit, si dhe zbatimi i ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” edhe në njësitë e qeverisjes vendore.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan Raportin dhe vunë në dukje mangësitë në zbatimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”. Ata përmendën ndërhyrjen politike në administratën publike dhe nepotizmin që e karakterizon atë, mohimin e të drejtave të qytetarëve të aftë për të zënë një vend të merituar në administratën shtetërore, korrupsionin, ndryshimet e shpeshta të personelit, paragjykimet në procesin e konkurimit, të cilat e kthejnë atë në një proces formal, pamjaftueshmërinë e kuadrit ligjor për administratën publike, mangësitë në procedurat e marrjes në punë, sistemin e karrierës, emërimet subjektive etj.

P/ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave”

Kuvendi shqyrtoi në seancë plenare dy nisma ligjvënëse, njëren të paraqitur nga deputetët Maksim Begeja dhe Alfred Çako dhe tjetrën të paraqitur nga një grup deputetësh mbi bazën e projektligjit të hartuar nga një grup pune nën asistencën e ekspertëve të OSCE-së.

Nismëtarët e projektligjit Begeja dhe Çako argumentuan domosdoshmërinë e projektligjit të paraqitur prej tyre, i cili sipas tyre, zgjidh përfundimisht problemin e kthimit të pronave pronarëve të ligjshëm, duke parashikuar kompensim fizik apo monetar vetëm në rastet e shpronësimeve për nevoja publike. Ata theksuan se ky koncept është në përputhje të plotë me nenin 41 të Kushtetutës dhe me dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat

dhe liritë themelore të njeriut. Sipas tyre, ky projektligj synon të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi ligjore midis pronarëve të ligjshëm dhe personave të tretë që ndodhen në pronën e tyre që, me ndërmjetësinë e shtetit, të shpërblejnë reciprokisht njeri-tjetrin pa rënduar buxhetin e shtetit. Pra, sipas tyre, fatura financiare duhet të ndahet në tri pjesë, midis pronarëve të vjetër, pronarëve të rinj dhe shtetit. Ata vlerësuan projektligjin e paraqitur prej tyre si variantin më të mirë, për faktin se ai shoqërohet me faturë financiare të vogël dhe të përballeshme nga Buxheti i Shtetit.

Varianti i paraqitur nga deputetët Mediu dhe Çako nuk u miratua nga shumica e deputetëve, të cilët mbështetën variantin e paraqitur nga grupi i deputetëve nën asistencën e OSCE-së. Ky variant u kundërshtua në parim nga një pjesë e deputetëve për tri çështje themelore:

- Ai mban në fuqi ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe disa ligje të tjera që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat, sipas tyre, bien në kundërshtim me Kushtetutën;

- Nuk parashikon kthimin fizik tek pronarët të trojeve të zëna me ndërtime të paligjshme gjatë dekadës së fundit;

- Varianti i miratuar nga shumica e deputetëve nuk përfshin kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme.

Shumica e deputetëve mbështetën në parim variantin e projektligjit të paraqitur nga një grup deputetësh nën asistencën e OSCE-së. Pas miratimit në parim, Kuvendi filloi shqyrtimin e këtij projektligji nen për nen, duke marrë parasysh vërejtjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit për riformulime e ndryshime në to.

Krahas vërejtjeve të Komisioneve, Kuvendi shqyrtoi edhe disa amendamente për ndryshime ose riformulime në disa nene të projektligjit, të paraqitura nga grupe parlamentare dhe deputetë. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit vazhdon në seancat plenare vijuese.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Kjo rubrikë synon dhënien e një informacioni mbi legjislacionin e miratuar rishtazi, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëhere kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Në të njëjtën kohë, synohet t'i vihet në ndihmë subjekteve publike dhe private që “konsumojnë” ligje, për një kuptim të shpejtë dhe objektiv të legjislacionit të miratuar rishtazi në Kuvend.

Ligj nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ky ligj synon të sigurojë vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis. Gjithashtu, synon të sigurojë një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve jofitimprurëse për mjedisin, të propozuesit të projektit dhe të personave fizikë dhe juridikë të specializuar në këtë fushë. Ligji përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat

për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit ose veprimtarisë në mjedisin ku do të zbatohen, për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti të propozuar në variante të tjera të mundshme. Vlen të theksohet fakti se në një nen të veçantë rregullohen problemet që lindin nga pjesëmarrja e publikut në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligjit i bashkëlidhen 3 shtojca. Në shtojcën e parë tregohen veprimtaritë që i nënshtrohen procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në shtojcën e dytë tregohen veprimtaritë që i nënshtrohen procesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe në shtojcën e tretë flitet për kriteret e përzgjedhjes. Ligji ka 34 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5 të vitit 2003, faqe 135.

Ligj nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën””, ndryshuar me vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese dhe me ligjet nr.8453, datë 4.2.1999, nr.8501, datë 16.6.1999 dhe nr.8682, datë 7.11.2000. Sikurse shihet nga titulli, ligjit “Për urbanistikën” i janë bërë disa herë shtesa e ndryshime. Me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003 shtohen 6 nene, ndryshohen 6 nene, zëvendësohet 1 nen dhe shfuqizohen 3 nene. Shfuqizimet bëhen për nenet 23, 26 dhe 27. Shtesat u referohen neneve që do të përmendim më poshtë, duke përkrahur shkurtimisht edhe llojin e shtesës. Në nenin 1 shtohen disa përkufizime, si për shembull çfarë kuptojmë me termat “plan strategjik”, “zonë urbane” etj. Në nenin 15 numërohen qytetet e kategorisë së parë. Në këtë kategori, tash e mbrapa shtohen edhe Kukësi, Peshkopia e Laçi. Shtesa në nenin 22/1 ka të bëjë me përcaktimin e kompetencave të njësisë së urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në bashkitë e kategorisë së parë, bashkitë e tjera dhe komuna. Në nenin 25 shtesa flet për detyrat që ka Këshilli teknik i njësisë urbanistike në bashki e komuna. Ndryshimet kanë të bëjnë me përcaktimin se cilat janë organizatat e specializuara për urbanistikën pranë njësisë të qeverisjes vendore (neni 14), me përcaktimin e anëtarëve të KRRT-së së qarkut (neni 18), me kompetencat

e KRRT-së së qarkut (neni 20) në përcaktimin e kompetencave të seksionit urbanistik të qarkut (neni 22), me përbërjen e strukturës-tip të njësishë së urbanistikës, si dhe me disa ndryshime të tjera më pak të rëndësishme. Ligji ka 15 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5 të vitit 2003, faqe 152.

Ligji nr. 8992, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin e Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave””. Sipas këtij Protokollit, aplikimi për regjistrimin ndërkombëtar depozitohet pranë Byrosë Ndërkombëtare përmes ndërmjetësisë së zyrës pranë të cilës është depozituar aplikimi bazë ose nga e cila është bërë regjistrimi bazë, sipas rastit. Aplikimi duhet të tregojë mallrat dhe shërbimet, në lidhje me të cilat pretendohet mbrojtja dhe, gjithashtu, në qoftë se është e mundur, klasën ose klasat korresponduese sipas klasifikimit. Markat e regjistruara në regjistrin ndërkombëtar publikohen në një gazetë periodike që e nxjerr Byroja Ndërkombëtare, sipas hollësive që përmban aplikimi. Për të publikuar markat e regjistruara në Regjistrin Ndërkombëtar, çdo zyrë merr nga Byroja Ndërkombëtare një numër gazetash falas. Në Protokoll Marrëveshje janë parashikuar edhe zgjidhja e problemeve lidhur me shtrirjen territoriale të mbrojtjes, mbrojtja që sigurohet përmes regjistrimit ndërkombëtar, periudha e vlefshmërisë e regjistrimit ndërkombëtar, varësia dhe pavarësia e regjistrimit ndërkombëtar, tarifat për aplikimin dhe regjistrimin ndërkombëtar etj. Në pjesën e dytë të Protokoll-Marrëveshjes trajtohen probleme të organizimit të punës, të organeve të ndryshme të kësaj Marrëveshjeje siç është Asambleja, Byroja Ndërkombëtare, Financat etj., si dhe rregullat e pranimit e të denoncimit të Protokollit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2003, faqe 183. Ligji i bashkëlidhet edhe Protokoll-Marrëveshja.

Ligj nr.8993, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e organizatës botërore të pronësisë intelektuale””. Konventa është nënshkruar në Stokholm

më 14 korrik 1967 dhe është amenduar më 28 shtator 1979. Palët kontraktuese të Koventës kanë synuar që të kontribuojnë për një mirëkuptim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet shteteve për përfitimin e tyre të ndërsjellë mbi bazën e respektit për sovranitetin dhe barazinë e tyre, për nxitjen e veprimtarisë krijuese dhe për të nxitur mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën. Nxitja dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale në të gjithë botën, si një nga objektivat më kryesore të Organizatës do të bëhet nëpërmjet bashkëpunimit midis shteteve dhe, kur është e përshtatshme, në bashkëpunim me çdo organizatë tjetër ndërkombëtare. Shtetet palë në këtë Konventë do të kenë një Asamble të Përgjithshme, e cila përveç zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm ka një shumicë detyrash të përcaktuara në mënyrë taksative. Gjithashtu, shtetet palë do të kenë edhe Konferencën, e cila diskuton çështje të interesit të përgjithshëm në fushën e pronësisë intelektuale dhe mund të adoptojë rekomandime në lidhje me çështje të tilla. Shtetet që mendojnë të aderojnë në këtë Konventë, nuk u lejohej të kenë asnjë rezervë ndaj saj. Selia e Organizatës është në Gjenevë, Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.6 të vitit 2003, faqe 197. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

Ligji nr. 8994, datë 30.1.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Italisë për veprimtarinë e bashkëpunimit dhe të asistencës, për ristrukturimin e zonës në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe atë të pistës së fluturimit në Pishë-Poro””. Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve të ndërsjella që palët marrin përsipër për vënien në zbatim të veprimtarive të filluara që me Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane “Lidhur me aktivitetin e bashkëpunimit dhe të asistencës për ristrukturimin e infrastrukturës logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në

Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro”, të nënshkruar në Romë më 7 maj 2002 dhe në Tiranë më 4 qershor 2002 dhe në bazë të secilës kjo Marrëveshje është një vazhdim dhe një plotësim i natyrshëm. Sipas Marrëveshjes, pala italiane merr përsipër të ofrojë konsulencë dhe asistencë teknike si në fazën projektuese, ashtu edhe në fazën ekzekutive të punimeve, të sigurojë furnizimin me materiale të nevojshme për realizimin dhe kryerjen e punimeve, të cilat do të jenë sipas normativave projektuese kombëtare italiane. Gjithashtu, sipas Marrëveshjes, pala italiane do të japë projektues, konsulentë punimesh, asistencë, krah pune, materiale për ndërtim e pajisje dhe do të sigurojë mbështetjen e plotë logjistike. Pala shqiptare angazhohet të garantojë hyrjen e mjeteve të transportit tokësor dhe ajror ushtarak italian, vënien në dispozicion të zonave të përshtatshme, që do të përdoren gjatë punimeve dhe do të garantojë, gjithashtu, edhe ndihmën e policisë ushtarake për ruajtjen e personelit dhe të kantierëve. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2003, faqe 209. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 8995, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për privilegjet dhe imunitetet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike”. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si një agjenci që ka hyrë në lidhje me Kombet e Bashkuara, ka edhe imunitetin dhe privilegjet e agjencive të specializuara. Pra, kjo Agjenci është person juridik që ka pasuritë dhe asetet e saj kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, dhe ato gëzojnë imunitet nga çdo formë e procedurave ligjore. Agjencia mund të mbajë fonde, ar ose monedha të çdo lloji. Të gjitha pasuritë e saj përjashtohen nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta e detyrimet doganore. Në Marrëveshje parashikohet që Agjencia do të ketë lehtësira komunikimi në territorin e çdo shteti pjesëmarrës në këtë Konventë. Gjithashtu, parashikohen edhe privilegje ndaj përfaqësuesve të shteteve kur ato thirren në takime nga Agjencia gjatë

kryerjes së funksionit të tyre. Të njëjtat privilegje gëzojnë edhe ekspertët që shërbejnë në komitetet e Agjencisë për kryerjen e misionëve të saj, kurse shtetet pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje janë të detyruara të njohin dhe të pranojnë lejet e kalimit të Kombeve të Bashkuara, që u lëshohen zyrtarëve të Agjencisë si dokumente të vlefshme udhëtimi. Në Marrëveshje trajtohen edhe probleme të abuzimit me privilegjet, të interpretimit të kushteve të saj, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2003, faqe 213. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë). Ky ligj vendos rregullat për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e metrologjisë për përdorimin e Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve (SI), si dhe kontrollin e mjeteve matëse. Në ligj jepen njësitë ligjore të matjes në Republikën e Shqipërisë dhe njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (ST). Në një kre të veçantë flitet për organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, ku jepen në mënyrë analitike detyrat e të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme, mënyrën e emërtimit dhe të shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm, për organet këshillimore të saj, për të ardhurat e shpenzimet etj. Problemet që kanë të bëjnë me kontrollin e mjeteve matëse trajtohen në 7 nene (nga neni 10 deri në neni 16) të kreut IV. Gjithashtu, ligji ka përcaktuar edhe kundërvajtjet administrative dhe sanksionet për shkeljet që bëhen gjatë zbatimit të këtij ligji. Në dispozitat e fundit ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 dhe 6 të këtij ligji. Ligji ka 22 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.10 të vitit 2003, faqe 275. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji nr.7625, datë 20.10.1992 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”.

Ligji nr. 8997, datë 30.1.2003 “Për një shtesë në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të

dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 7660, datë 14.1.1993, ligjin nr.7719, datë 8.6.1993 dhe ligjin nr.7772, datë 7.12.1993”. Ligji nr. 8997, datë 30.1.2003 është ligji i katërt që bën shtesa ose ndryshime në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Ligji nr. 7772, datë 7.12.1993 ka bërë shtesa në nenin 5 të ligjit bazë, duke njohur si kohë përndjekjeje edhe kohën e kaluar në kampet e internimit në Radostimë, Levan e Kuç deri më 31.12.1958 dhe të internuarve në kampin e Zvërnecit, deri më 31.12.1961. Me ligjin nr. 8997, datë 30.1.2003, në nenin 5, në fund të paragrafit të parë të shkronjës ç/1 të nenit 1 të ligjit nr. 7772, datë 7.12.1993, pas fjalëve “të internuarit në kampin e Zvërnecit deri më 31.12.1961, shtohen fjalët “si dhe të internuarit në Kurbnesh të Mirditës deri më datën 31.12.1966”. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi, më 11.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, të vitit 2003, faqe 264.

Ligj nr.8998, datë 30.1.2003 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 24.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit””. Në nenin 3 të ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit” parashikohej që shtetasit deri në moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 5 vjet, ndërsa ata mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 10 vjet. Në të gjitha rastet, vlefshmëria e pasaportës mund të zgjatej vetëm një herë, për një periudhë njëvjeçare. Në nenin 14 po të ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 parashikohej që pajisja me pasaportë të re, sipas këtij ligji, do të bëhej pas përfundimit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese. Me aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 24.12.2002 të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshime në nenin 14 të ligjit nr.8668, datë 23.10.2000. Sipas ndryshimeve, neni 3 i ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 zbatohet pas datës 31.12.2005. Deri në këtë datë, shtetasit e

moshës mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të modelit ekzistues, e vlefshme për 5 vjet, me të drejtë përtëritjeje deri në 3 vjet, ndërsa të miturit e moshës deri 16 vjeç pajisen pranë organit të policisë me leje kalimi të modelit ekzistues, të vlefshme për 6 muaj dhe vetëm për një udhëtim. Akti normativ me fuqinë e ligjit, i përmendur më lart, është miratuar me ligjin nr.8998, datë 30.1.2003. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8 të vitit 2003, faqe 265.

Ligji nr. 8999, datë 30.1.2003 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8473, datë 14.4.1999”. Ky ligj rregullon problemin e “Duty free shops” (dyqane të çliruara nga taksat). Kështu, pika 4 e nenit 199 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 (Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë) ndryshohet dhe ky ndryshim qëndron në faktin që vetëm Ministri i Financave mund të autorizojë hapjen e “Duty free shops” në aeroporte që ndodhen në zonën doganore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për shitjen e produkteve, me përjashtim nga detyrimet e importit. Po me këtë ligj, në nenin 2 parashikohet që autorizimet që janë dhënë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji (data 11.3.2003) për regjimin e magazinës doganore për hapjen e “Duty free shops” në zonat doganore tokësore kufitare dhe në portet detare, me përjashtim të atyre të aeroporteve, revokohen pas 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas kësaj date, mallrave gjendje u jepet njëri nga destinacionet doganore, të parashikuara në dispozitat e Kodit, ndërsa të gjitha “Duty free shops” me përjashtim të atyre në aeroporte, mbyllen. Ligji ka katër nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8 të vitit 2003, faqe 265.

Ligj nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit,

të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore që nxjerrin këto organe. Me këtë ligj parashikohen edhe disa kompetenca të Kryeministrit, përveç atyre që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje të tjera. Gjithashtu, përcakton edhe strukturën e përbërjen e Kryeministrit. Kështu, Kryeministria përfshin aparatin e Këshillit të Ministrave, Kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit. Përcaktohen edhe disa kompetenca të Zëvendëskryeministrit dhe ministrive, përveç atyre që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje të veçanta. Në mënyrë të detajuar janë përcaktuar kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm. Gjithashtu, jepen shpjegime se çfarë janë institucionet qendrore, komitetet ndërministrorë e grupet e punës me ekspertë, si krijohen ato, cila është varësia e tyre, çfarë kompetencash kanë etj. Në një kre të veçantë trajtohet funksionimi i Këshillit të Ministrave dhe më në hollësi flitet për mbledhjet e Këshillit të Ministrave, mbledhjet e jashtëzakonshme, për rendin e ditës, për shfaqjen e mendimit, shqyrtimin e projekteve, vendimmarrjen, hartimin e projekteve, bashkërendimin etj. Trajtohen probleme që kanë të bëjnë me llojet e akteve, hyrjen në fuqi të tyre, marrëdhëniet me të tretët etj. Ligji ka 33 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.10 të vitit 2003, faqe 281.

Ligj nr. 9001, datë 6.2.2003 “Për ratifikimin e “Programit të veprimit rajonal “CARDS 2002” ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian””. Nga Programi i Veprimit Rajonal “CARDS 2002” do të përfitojnë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM). Programi, sipas projektit, do të japë asistencë teknike dhe studime për të ndihmuar të pesë vendet e interesuara për të siguruar që strategjitë kombëtare të manaxhimit të integruar të kufijve janë bashkërenduar efektivisht dhe duke u plotësuar me mbledhje

rajonale të zyrtarëve përgjegjës dhe dhënien e këshillave teknike, nëpërmjet studimeve. Projektet do të nxisin integrimin e pesë vendeve në rrjetin më të gjerë të infrastrukturës europiane “nëpërmjet studimeve dhe asistencës teknike, ku përfshihet siguria në aviacion dhe aspekte të kontrollit të trafikimit ajror”. Modeli i bashkëpunimit rajonal, sikurse del nga Programi, është tërësisht një zgjerim i vetë filozofisë së BE-së, se bashkëpunimi më i thellë me vendet fqinje është një rrugë drejt stabilitetit kombëtar, rajonal e rritjes dhe se ky lloj bashkëpunimi i shërben interesave të përbashkëta të vendeve të përfshira. Programet do të financohen nëpërmjet një granti nga komuniteti, me vlerë 43, 300, 000 Euro dhe përfshijnë fusha që kanë të bëjnë me manaxhimin e integruar të kufijve, ndërtimin e institucioneve, stabilitetin demokratik, infrastrukturën rajonale etj. Programit i janë bashkëlidhur tabelat analitike të diskutimeve, Aneksi A për gjendjen e asistencës rajonale dhe Aneksi B që tregon Asistencën e Komisionit European për vendet e Ballkanit Perëndimor, në periudhën 1991-2001. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.13 të vitit 2003, faqe 369.

Ligjin nr.9002, datë 6.2.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit European, në kuadër të Programit “CARDS 2002””. Si një pjesë e programit të ndihmës, Komuniteti European do të kontribuojë në formë granti në një maksimum prej 44.9 milionë Euro, me kushtet që parashikohen në anekset e kësaj Marrëveshjeje, anekse të cilat do të konsideron si një pjesë integrale e saj. Aneksi “A” parashikon kushtet e përgjithshme në lidhje me marrëveshjet financiare, si për shembull vlefshmëria e grantit të KE-së, disbursimi, dhënia e lehtësirave, privilegjet e përgjithshme, importet dhe shkëmbimi i kontrollit, taksat dhe doganat, realizimi i kontratave, bashkëpunimi ndërmjet komisionit dhe përfituesit, inspektimi dhe kontrolli etj. Aneksi “B” rregullon mosmarrëveshjet dhe përshkruan procedurat për zgjidhjen e tyre. Kur palët nuk do të mundin t’i zgjidhin

mosmarrëveshjet midis tyre me mirëkuptim, ato mund t'i drejtohen një tribunali arbitrazhi. Aneksi "C" trajton objektivat specifike të programit. Objektivi i përgjithshëm i asistencës së KE-së është përcaktuar brenda kuadrit të procesit të stabilizim-asociimit (SAP) dhe përfshin konsolidimin e shtetit të së drejtës, stabilizimin demokratik, zhvillimin ekonomik dhe social dhe mbështetjen për mjedisin. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.13 të vitit 2003, faqe 388.

Ligj nr.9003, datë 13.2.2003 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin "Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – Zona e Manskurisë"". Në bisedimet ndërqeveritare shqiptaro - gjermane më 5 dhjetor 2001 është rënë dakord që Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë t'i japë mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main, një hua me vlerë deri në 2 045 167 Euro për projektin "Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – zona e Manskurisë. Përdorimi i shumave, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si edhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet palëve. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në Euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve, në bazë të kontratave që do të përfundohen. Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron huadhënësin nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.13 të vitit 2003, faqe 399. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.9004, datë 13.2.2003, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së

